

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS  
TË MBAJTUR MË 1 dhe 2 QERSHOR 2006

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA  
ODRŽANE 1. i 2. JUNA 2006.

---

QERSHOR – JUNI 2006

## **RENDI I DITËS**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 11 dhe 12 e 15 maj 2006,
3. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Operën, Baletin dhe Filarmoninë e Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera,
5. Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat,
6. Shqyrtimi i parë i projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht të gjirit të nënës,
7. Shqyrtimi i parë i projektligjit për hulumtimet gjeologjike,
8. Shqyrtimi i propozimit për emërimi e z. Altay Suroy, zëvendësministër të Drejtësisë
9. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për buxhetin e vitit 2005.

## **DNEVNI RED**

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica održanih 11 i 12-15 maja 2006.
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Operi, Baletu i Filharmoniji Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zastiti od elementarnih i drugih nepogoda,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni zakona o arhivskoj građi i arhivima,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o podsticanju, zastiti i promovisanju dojenja majcinim mlekom,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o geoloskim istrazivanjima,
8. Razmatranje predloga o imenovanju g. Altay Suroy za zamenika ministra pravde,
9. Razmatranje završnog izvestaja o budzetu za 2005. godinu.

**Seancën e kryesoi Kolë Berisha, kryetari i Kuvendit të Kosovës.**

**Seanca u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës dhe filloi në orën 10,00**

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Të nderuar kolegë deputetë, anëtarë të Kabinetit Qeveritar, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Gjithashtu ju njoftoj se rendi i ditës i propozuar nga Kryesia e Kuvendit, së bashku me materialet e nevojshme, u janë shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve, andaj propozoj miratimin e rendit të ditës.

Para se të votojmë për rendin e ditës propozoj një ndryshim.

I propozoj edhe dy pika shtesë të rendit të ditës.

1. Propozimi i vendimit për rritjen e numrit të anëtarëve të komisioneve funksionale sipas kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim.
2. Propozimi i reformave për funksionalizimin e punës së Kuvendit që ndërlidhet me disa ndryshime në Rregulloren e punës së Kuvendit.

Pika e dytë propozoj të jetë pikë e parë e rendit të ditës për këtë seancë.-. Propozimi i reformave për funksionalizimin e punës së Kuvendit ndërlidhet me disa ndryshime në Rregulloren e punës së Kuvendit.

A pajtoheni? Po. Ju faleminderit.

Kundër nuk ka. Fjalën e kërkon z. Koci

**DEPUTETI GANI KOCI** - Mua më duket se propozimi për ndryshimin e Rregullores sikur shpejt po futet në këtë seancë dhe pa shqyrtimin tonë. E dimë se kemi pasur një komision për rregullore që ka punuar dhe këto ndryshime ose propozime për ndryshime duhet të kalonin nëpër këtë komision, në mënyrë që të mos na afroreshin këtu në këtë formë si vendim i Kryesisë.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Propozova të jetë pikë e parë e rendit të ditës, diskutojmë për atë dhe ta kesh seancën për atë që e ke ndërmend të thuash.

Natyrisht se kjo pikë ka kaluar nëpër Kryesi dhe të shefat e grupeve parlamentare.

Të nderuar kolegë deputetë, shumë shqetësime të arsyeshme janë shprehur lidhur me funksionimin e transparencës si komponent elementar i demokracisë parlamentare lidhur me procedurat e aplikuara deri më tani.

Më 10 mars të këtij viti, kur më zgjidhet kryetar të Kuvendit të Kosovës ju pata premtuar se me tërë qenien time fizike, psikike, morale dhe intelektuale, do të

angazhohem që nga kjo shtëpi të dalin akte që përcaktojnë, rregullojnë e sanksionojnë sistemin politik, ekonomik, juridik e fushat e tjera të jetës në shtetin e nesërm të Kosovës së pavarur dhe sovranë, që të jetë vërtetë tempull i fjalës së lirë të deputetit, të jetë zë i fuqishëm i opozitës dhe pozitës, i shumicës dhe i pakicës, që deputeti të ndiejë se është me të vërtetë zot i kësaj shtëpie. Si kryetar i këtij Kuvendi jam i vendosur të merrem me këto shqetësime dhe që Kuvendin e Kosovës ta sjellim më afër standardeve dhe praktikave parlamentare të vendeve të përparuara. Se sa ia kam arritur në përmbushjen e këtij premtimi po e lë ta vlerësoni ju. Nëse në këtë aspekt është bërë ndonjë hap pozitiv, e që sipas Grupit të Kontaktit, Uashingtonit, Brukselit dhe qendrave të tjera të vendosjes ndërkombëtare vërtetë është bërë shumë, atëherë kjo është rezultati i asaj që nga dita e parë e punës sime në këtë post kam mbajtur konsultime nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme, në radhë të parë me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, pastaj me shefat e grupeve parlamentare, me kryetarët e komisioneve, me liderët partiakë, me një pjesë të madhe tuajën, zotërinj deputetë, me pjesën administrative, juridike dhe teknike të Kuvendit, me këshilltarët e mi të cilët err e terr kanë qenë dhe janë të angazhuar në kryerjen e pjesës më të madhe të punëve.

Pastaj me liderët ndërkombëtarë të pranishëm në Kosovë: siç janë ENDI-a etj. Me këtë rast të gjithëve do t'ua adresojë falënderimin tim të veçantë për ndihmën konkrete dhe përkrahjen e pa rezervë si dhe mbështetjen e sigurtë morale që ma keni afruar. Si rezultat i këtyre konsultimeve dhe angazhimeve të përbashkëta të të gjithë atyre që u cekën më lartë duke kërkuar forma më të avancuara drejtë formimit, reformimit dhe demokratizimit të punës së Kuvendit, për ta rreshtuar përkrah parlamenteve simotra të përparuara, sot para jush po e shpall planin e reformave i cili kërkon konsensus të fuqishëm ndërmjet jush me qëllim të arritjes së standardeve më të larta demokratike për të cilat i kemi vënë vetes detyrë. Pika e parë e reformave është ta miratojmë një kalendar vjetor të Kuvendit të Kosovës.

Çdo parlament në botë e publikon kesi kalendarin prej një faqeje, një format të ngjashëm me atë që jua kemi dërguar. Me këtë kalendarin njoftohen deputetët dhe shoqëria për datat e seancave plenare dhe të mbledhjeve të tjera të rregullta. Projekti të cilin jua kemi shpërndarë parasheh të kemi më shumë seanca të rregullta dhe fikse me qëllim që punët t'i kryejmë në mënyrën më të rregullt. Seancat do të mbaheshin dy herë në muaj gjatë periudhave normale të punës dhe tri herë në muaj gjatë periudhave fikse ose intensive të punës.

Një javë para seancës do të mbaheshin mbledhjet e rregullta me kryetarët e komisioneve, të martave, pastaj me shefat e grupeve parlamentare të mërkurave, kurse me Kryesinë e Kuvendit të enjten. Periudha e pushimit është paraparë të jetë në muajin gusht, me gjithë se në këtë vit mund të bëjmë përjashtim duke marrë parasysh rrjedhat që po zhvillohen. Pika e dytë e formave, që është e afërt me të parën, ka të bëjë me kalendarin e ngjarjeve ose të aktiviteteve të Kryesisë. Ky kalendar i hollësishëm do të miratohet nga Kryesia çdo dy muaj dhe do të ndihmojë t'i organizojmë seancat dhe t'i dokumentojmë të arritjet tona më të mira, të cilat do të mbahen dhe do të postohen në zyrën e kryetarit të Kuvendit.

Pika e tretë e reformave është plani i standardeve që ka për qëllim ta forcojë sovranitetin e Kuvendit dhe llogaridhënien e Qeverisë. Pjesët e këtij plani janë shumë të qarta:

- Nën 1, të ketë periudhë të rregullt për pyetje,
- Nën 2, të ketë interpelanca të rregullta të udhëhequra nga një grup parlamentar,
- Nën 3, plani për mbështetjen teknike të komisioneve,
- Nën 4, ndryshimi i planit të brendshëm të administratës,
- Nën 5, Projektbuxheti i iniciuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe i miratuar nga Kryesia,
- Nën 6, përmirësime në menaxhimin e sistemin informatik,
- Nën 7, qasje në dokumentet për mediat dhe publike dhe
- Nën 8, lista e çështjeve për t'u diskutuar e cila i jep strukturë rendit të ditës dhe statusit të ligjeve.

Secila pikë e këtij plani do të përshkruhet në hollësi para se t'i afrohem datës së zbatimit. Për shumicën e këtyre pikave nuk do të ketë nevojë të bëhen ndryshime në Rregulloren e punës së Kuvendit. Me gjithë atë rregullat e tanishme lidhur me periudhën e pyetjeve për interpelanca janë pengesë për zbatimin e reformave. Për këtë arsye është propozuar ndryshimi i disa rregullave të Rregullores, material ky që u është dorëzuar të gjithë deputetëve, me të cilin praktikisht mundësohet zbatimi i këtyre reformave. Jam i bindur se me miratimin e këtij plani do të arrijmë që Kuvendin ta bëjmë më të efektshëm, më funksional dhe më demokratik. Ju faleminderit.

Nise dikush ka diçka të thotë në lidhje me këtë, le të urdhërojë Nait Hasani e ka fjalën.

DEPUTETI NAIT HASANI – I nderuar z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë.

Për mua është shqetësuese dhe pikërisht për këtë e ngrit dorën të flas për rastin e Krushës së Vogël, i cili ka ndodhur para një jave dhe askush nuk e ka bërë të madhe këtu, pikërisht as kryetari i Kuvendit, as Ministria, as Qeveria nuk janë marrë me këtë çështje.

Të nderuar deputetë,

Unë nuk dua t'jua prish ndjenjën e floftë siberiane që e keni për këtë ngjarje të Krushës së Vogël dhe nënat dhe gratë e veja që presin t'u kthehen, se paku eshtrat dhe të dinë ku i kanë varret të dashurit e tyre. Lus ndërgjegjen njerëzore të ndikoj te ju. Atë që e pamë para një jave në Krushë të Vogël, që na kujtojnë ditët e luftës në Kosovë pas 7 vjetëve të çlirimit nga Serbia. Atë ditë edhe një herë banorët e Krushës së Vogël, nënat, gratë dhe fëmijët jetimë kësaj radhe u gjuajtën me gazë lotsjellës dhe më të shtëna duke i tmerruar e kujtuar ditët më të vështira të tyre kur humbën më të dashurit e tyre, burrat e fëmijët nga 40 shtëpi shqiptare në Krushë të Vogël 114 meshkuj u morën, u kidnapuan u zhdukën dhe ende nga ajo ditë e 26 marsit 1999 nuk dihet për fatin e tyre nga vendësit e tyre serbë, që ishin veshur në uniformë policie serbe kundër fqinjëve të tyre shqiptarë, siç janë:

Tasiq Sveta i Krushës së Vogël, Nikolliq Momqillo, Nikolliq Sava, Nikolliq Ranko, Nikolliq Dimitrije, Petkoviq Ranko, Gjorgjeviq Drobolub, Cvetkoviq Gjorgje, Gjorgjeviq

Zllatko, Nikoliq Zvezda, të cilët vranë fëmijët në moshën 13 vjeçare: Xhelal Shehun, Mursel Hajdarin, Lirim Ahmet Batushën, Kadri Raçka, Ajvaz Shehu, Mehmet Shehu, Kujtim Shehu, Visar Shehu, Bajram Ramdani, Abedin Hajdari, Mentor Shehu, Mërgim Batusha, Bekim Batusha, Xhelal Zylfiu. të gjithë të grupmohës 13 deri 16 vjeçar.

Vizata e konvojit të serbëve nga 12 makina të UNMIK-ut në fshatin Krushë e Vogël dhe Poklek e kishin bërë krimin më makabër në historinë e njerëzimit, ku kishin vra fëmijë, burra e gra. Ata banorë serbë të Krushës së Vogël kishin ardhur të shihnin dhe t'i matnin ndjenjat fqinjëve të tyre shqiptarë dhe të ktheheshin si kriminelët në vendin e krimit me policinë e UNMIK-ut. Kjo shkelje është e paligjshme dhe e dënueshme se kjo vjen nga ata që duhet ta mbrojnë drejtësinë.

Në Krushë të Vogël kanë ardhur kriminelët në përcjellje të UNMIK-ut për t'i parë pronat e veta. Sa për kujtim, të nderuar deputetë se për krimet e bëra në Kragujevc ata që janë më të vjetër i kujtoj, nga nazistët gjermanë për 20 vjet nuk ka guxuar të kalohej asnjë makinë me regjistrim gjerman, sepse ua ka lënduar ndjenjat dhe ua ka përkujtua krimin, ndërsa në Krushë të Vogël pas shtatë vjetësh UNMIK-u vjen me serbë për të.

të provokuar situatën më të ndjeshme në Kosovë, provokon nënat, gratë dhe fëmijët jetimë duke u sjell atyre nëpër fshat me forcë, kriminelë serbë që kanë bërë krime, kur ata banorët e Krushës kanë bërë denoncimin e krimit, i kanë cekur edhe emrat e atyre që e kanë bërë krimin, në Gjykatën e Hagës ata i kanë dhënë edhe UNMIK-ut emrat e kriminelëve serbë, ata e kanë ngritur dhe ngjitur në bez emrat e tyre dhe kanë qëndruar me ditë të tëra para selisë së UNMIK-ut këta emra. Askush s'ka marrë kurrfarë mase për ta, prandaj nënat, grat e veja, fëmijët jetimë të Krushës së Vogël kërkojnë të mos provokohen dhe të mos luaj askush me ndjenjat e tyre madje as UNMIK-u. Nënat dhe gratë e veja, fëmijët jetimë të Krushës së Vogël kërkojnë të dënohen kriminelët dhe që pa u dënuar kriminelët serbë të Krushës, për të cilët u përmenden emrat më lartë, të mos ketë kthim të asnjë serbi në Krushë. Edhe unë kërkoj nga Kuvendi që të formojë një ekip ose grup që të merret me rastin e Krushës dhe ta shpejtojë procesin e të pagjeturve. Të nderuar deputetë ajo që keni parë në Krushë uroj të mos përsëritet më kurrë, kundër nënave dhe grave të veja dhe jetimëve. Ju faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Fjalën e ka profesor Alush Gashi në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

**DEPUTETI ALUSH GASHI** - I nderuari z. kryetar, lidhur me incidentin e rëndë që ka ndodhur në Krushë, ne si grup parlamentar i bashkangjitemi brengës së familjarëve, të farefisit dhe të qytetarëve të Kosovës.

Kërkoj z. kryetar që pas hetimeve të përfunduar, policia vendore, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo ndërkombëtare që Kuvendit të Kosovës t'i jepet një informatë me shkrim lidhur me hetimet e bëra. Mendoj që ka modele të vendeve të ndryshme të cilat kanë kaluar nëpër aparteid dhe gjenocid për vështirësitë në të cilën po kalon vendi ynë dhe jo vetëm që urojmë, por angazhohemi fuqimisht që incidentet të tilla të mos përsëriten.

Sa i përket fjalës suaj dhe tri pikave të këtij rendi të ditës ,së pari ne si grup parlamentar i kemi shqyrtuar të gjitha, kemi marrë pjesë në këtë debat për shumë muaj, por si grup parlamentar ne do të votojmë për. Faleminderit z. kryetar.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Faleminderit profesor. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylaj.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – I nderuar z. kryetar të nderuar,të ministra , deputetë të nderuar.

Sa i përket Krushës unë personalisht kam shkuar dhe kam biseduar në fshat me qytetarët e Krushës, i kam vizituar vetë dhe i kam parë të lënduarit si Aleancë i kemi dënuar gjithashtu e konsiderojmë një provokim. Mendojmë se ka qenë një incident i panevojshëm, qytetarët e Krushës ishin të shqetësuar bashkëndejmë me familjarët dhe martirët e Krushës së Vogël dhe konsiderojmë se në të ardhmen një incident i tillë nuk do të duhej asnjëherë dhe nga askush të provokohet dhe të ngjante. Sidomos ,jo në mënyrën si ka ngjarë. Autoritetet duhet të bashkëpunojnë edhe me autoritetet lokale, por edhe me vetë fshatarët për çfarëdo informate ose për ndonjë çështje tjetër që u duhet.

Grupi Parlamentar u dëshiron shërim të shpejtë të gjithë të lënduarëve.Gjithashtu konsiderojmë se të gjitha informatat të cilat do t'i ketë komisioni, i cili është formuar për të cilin ka thënë edhe UNMIK-u se do ta formojë, që ne të na përcillet këtu në Parlament që edhe ne ta informojmë ashtu që të mund t'iu informojmë edhe qytetarëve , në veçanti atyre të Krushës së Vogël.

Sa i përket çështjes së dytë, që e shtruat Grupi Parlamentar edhe më parë ka qenë në favor dhe ka shtruar në Kuvend çështjen e reformave të punës së Kuvendit. Mendojmë se ndryshimet e propozuara do të fuqizojnë dhe do të forcojnë edhe më tepër punën e Kuvendit ,sepse mbikëqytja më efektive parlamentare është një funksion i pashmangshëm i demokracisë moderne, përveç kësaj kjo do t'i forcojë edhe rritjen e efektivitetit , të ushtrimit të pushteti dhe krijimit të balancit në mes të pushteteve.

Prandaj ndryshimet e propozuara janë instrumente të cilat fuqizojnë edhe më shumë punën e Kuvendit,kështu që e mbështesim fuqimisht. Faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka z. Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** - Z. kryetar, sa i përket çështjes së Krushës dua të them se kjo ka qitë në dritë edhe një herë funksionimin e dobët të sistemit të sigurisë dhe të atij të drejtësisë dhe se kjo është dëshmi shtesë që në këto dy segmente tepër të rëndësishme dhe vitale në jetën politike të institucioneve të Kosovës do të bëhet një reformë e thellë. Mendoj që në këtë reformë roli i Parlamentit duhet të ketë vend të rëndësishëm në këtë reformim që do të bëhet në këto dy segmente.

Sa i përket pikës së dytë, ne falënderojmë ENDIA-në dhe OSBE-në gjatë monitorimit dhe mbështetjes që i kanë bërë Parlamentit, natyrisht edhe me kërkesat e deputetëve. Ne edhe pse kemi kërkuar, si grup parlamentar që seancat të jenë javore, duke pasur parasysh

kapacitetet administrative dhe profesionale të Parlamentit, por ndoshta edhe të vetë deputetëve, jemi dakord që seancat të jenë javore dhe me një fjalë edhe ndryshimet që janë kërkuar të bëhen në Rregulloren e punës të Parlamentit. Në këtë drejtim ne e mbështesim, por edhe shpresojmë se Parlamenti po hynë në një temp të ri të punës.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka Teuta Sahatqija.

**DEPUTETJA TEUTA SAHATQJA** – Faleminderit z. kryetar. Edhe grupi ynë parlamentar i përkrahë kolegët tanë deputetë në lidhje me incidentin i cili ka ndodhur në Krushë. Gjithashtu shprehim keqardhje dhe protestojmë me mënyrën se si është bërë kjo vizitë dhe si është bërë ky organizim, ose më mirë të them mos organizim i duhur gjatë vizitës në Krushë.

Mendoj që të gjitha vizitat, çfarëdo ofshin ato do të duhet të organizoheshin mirë dhe t'i sqarohet popullit se për çka ndodhë ajo dhe jo populli të vihet para aktit të kryer dhe që me plotë të drejtë të reagojë ashtu siç ka reaguar në rastin e Krushës së Vogël. Duhet ta kemi parasysh se ka shumë vende në Kosovë, në të cilat njerëzit ende janë duke u përballur me tmerret, me traumat dhe me streset të cilat i ka shkaktuar lufta.

Prandaj duhet të kemi konsideratë dhe të reagohet në mënyrë të duhur me sqarime

Sa u përket pikës së reformave, planit të tyre grupi ynë parlamentar e përkrah planin e reformave dhe mendojmë se nëpërmjet këtij plani do të ushtrohet një efikasitet më i madh në punën e Kuvendit në mbikëqyrjen e Qeverisë nga ana e Kuvendit dhe me një fjalë kjo do të sjell efikasitet dhe punë më të madhe që pritet prej deputetëve. Do ta shfrytëzoja rastin t'i falënderoj të gjithë partnerët që kanë marrë pjesë në përpilimin e këtij plani si dhe të gjithë deputetët të cilët në rastet e shumta në seancat e shumta kanë shprehur gatishmëri dhe kanë kërkuar që këto seanca të jenë më efektive dhe më të shpeshta.

Grupi ynë parlamentar e përkrah planin e reformave. Faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Deputeti Gjergj Dedaj.

**DEPUTETI GJERGJ DEDAJ** – Faleminderit z. kryetar të nderuar ministra, kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar për Integrim, po ashtu është shqetësuar, posaçërisht me fjalën e deputetit Hasani dhe të deputetëve tjerë për ngjarjen në Krushë që mendoj se ishte një provokim ndaj proceseve demokratike në Kosovë kur jemi të vetëdijshëm se jo vetëm në Krushë, por edhe në shumë vendbanime të tjera në Kosovë ende kemi me qindra dhe mijëra të zhdukur, prandaj në të ardhmen do të kishim kërkuar nga autoritetet e UNMIK-ut që kur bëjnë vizita në lokalitete të tilla t'i bëjnë në bashkëpunim dhe me njoftim me autoritetet e sigurisë në nivel qendror, si dhe me autoritetet lokale, por para së gjithash të marrin pëlqimin e banorëve të këtyre lokaliteteve, në mënyrë që të mos përsëriten ngjarjet e tilla.



Posaçërisht është me rëndësi të theksohet se pasi bëhen hetimet e sakta, është mirë të njoftohet Kuvendi që të dalë me një qëndrim për këtë çfarë ka ndodhur në Krushë të Vogël. Mendoj se nuk do të ishte mirë që kjo të ndodhë në asnjë lokalitet.

Sa i përket pikës së dytë, reformimit të Kuvendit të Kosovës dhe punës së tij, kisha dashur të mos jetë vetëm një reformim teknik i Kuvendit të Kosovës, por të jetë edhe një reformim substancial, në të cilin ku do me thanë unë jam këtu i vetëdijshëm sikur edhe deputetët e tjerë- kolegë që kemi pasur seanca për pika të caktuara ta zëmë për Universitetin e në shumë seanca e tjera kur në fund s'kemi marrë kurrfarë vendimi. Kemi shpenzuar energjinë kot, është mirë të kemi reformime substanciale që deputetët t'i dinë rolin dhe mandatin e vet dhe pse janë këtu. Tash na jepen mundësi dhe rast më i madh që t'i kryejmë obligimet tona si deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit shumë.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Faleminderit z. Dedaj. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

**DEPUTETI XHEZAIR MURATI** – Poštovani predsedniče, gospodo ministri kolege, Parlamentarna grupa 6+ pridružuje se svima onima koji osuđuju događaj koji se desio u Kruši, kao i preduzimanje odgovarajućih mera kako do takvih događaja ubuduće ne bi došlo. Naime, svaka nedovoljna priprema i neorganizovanost može da bude uzrok ponavljanja takvih stvari, mislim da ovo treba da bude poslednja opomena da svakom obeležavanju komemoraciji ili bilo kom drugom događaju treba prići ozbiljno, odgovorno i organizovano, kako se ne bi taj nemio događaj ponovio. Mi se pridružujemo reformi rada Skupštine Kosova i to smo izrazili i u aktivnostima sa ostalim šefovima parlamentarnih grupa i u Predsedništvu i u kontaktima sa predsednikom Skupštine i nadamo se da će to ostvariti jedan kontinuitet ubrzanog rada i donošenja zakona, ali i njihove implementacije, tako da ovo sve podržavamo i normalno stojimo na raspolaganju i dajemo svoj ideo u reformi rada Skupštine. Hvala!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Nga diskutimet e deritashme i kemi dy propozime. I pari, që formohet një grup ose një komision i punës për çështjen që ka ndodhur në Krushë të Vogël dhe tjetri - presim që bëhen nga organet kompetente dhe të na dërgohet Kuvendit një informatë për te. Urdhëroni z. Nekibe.

**DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI** – Nga diskutimet e shefave të grupeve parlamentare rezulton se me konsensus do të miratohet propozim ndryshimi i Rregullores së punës me plotësimet dhe ndryshimet që janë paraparë në të.

Me qenë se sipas rregullës 58 është caktuar terminologjia duhet të përdoret edhe në aktin përcjellës, terminologjia është adekuate. Unë do të propozoja që këto ndryshime të mos quhen amendamente dhe titullin ta mbajnë Propozimi për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores së punës së Kuvendit, edhe menjëherë shkohet në rregullën 22 duke i hequr amendamentet të gjitha, sepse rregulla 58 nuk lejon gjuhë tjetër të përdoret në rregullore. Faleminderit.

Sa i përket Krushës nuk kam çka të them ajo është veç dezhevry se ne të gjithë e kemi gjykuar atë akt dhe gjykojmë dhe do ta gjykojmë nëse në të ardhmen përsëritet por do të përiqemi që të mos përsëritet më. Faleminderit

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. me gjithë atë si propozim që patëm dy do të deklarohemi.

Për propozimin e parë kush është për, që të formohet Komisioni

Urdhëroni, deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – Z. kryetar nuk kemi si me e formuar një herë komision pa e pasur një informatën, se ku është bazuar dhe së pari duhet me pas informatën raportin prej Kai Vitrup dhe në qoftë se janë edhe vendorët atëherë së pari për çka ka ngjarë pastaj mundet me u formua komisioni.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Jakup Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – Z. kryetar mendoj që ngjarja ka ndodhur dhe se të gjithë reagues ndaj asaj çka ka ndodhur. Mund të vijë raporti i organeve përgjegjësinë e vet dhe se unë mendoj se duhet të formohet një komision për të na informuar ne, Parlamentin dhe kjo duhet të bëhet nëpërmjet grupet parlamentare që janë këtu.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit, më duhet t'i vë në votim propozimet sipas radhës. Kush është për formimin e Komisionit, urdhëro prof. Hamiti

**DEPUTETI SABRI HAMITI** – Ju lutem z. kryetar, faleminderit për fjalën.

Ne dëgjuam shumë emocione nga deputetët për ngjarjet që kanë ndodhur në Krushë dhe dëgjuam përpjekje racionale që të kërkohet çka mund të bëhet sot. Po shihet se edhe tensioni e dhimbja në sallë janë përtej asaj që lejon arsyeja e zakonshme e një tubimi qysh jemi ne, edhe problemi doli pasi që e votuam rendin e ditës që në kuptimin procedural nuk është mirë, por sido që të jetë problemi është dhe ne e shqyrtoam gojarisht nëpërmjet përfaqësuesve të grupeve parlamentare Patëm një gjysmë ideje po them gjysmë për shkak se u artikulua një herë nga një deputet, mandej një variant tjetër nga deputetë të tjerë. Unë mendoj që për këtë problem nuk është mirë të votohet në Kuvend, nuk është mirë që të votohet a të formojmë komision a jo, është mirë eventualisht të bëhet konsultim paraprak. J u lutem shumë, mendoj se nuk duhet të votojmë në këtë rast për propozime të tilla as për njërin as për tjetrin. Nëse ka nevojë të bëhen konsultime paraprake. E dyta, ne s'kemi informatë. Ishte një kërkesë më duket e z. Alush Gashi që të kërkohet informata dhe se ajo duhet të jetë në nivelin që jemi ne në Kuvend. Nuk mund të paragjykohej, ne kërkojmë që eksponentët ose përfaqësuesit më të lartë të Kosovës të merren me këtë punë në nivelet elementare, mandej të kalohet në nivelet më të gjera, sepse aq sa marr vesh unë dhe sa di, ai është aksion i bërë pa u konsultuar hiq me Shërbimin Policor të Kosovës nëse kjo ka ndodhur nuk është punë që duhet të diskutohet sot në Kuvend para se të merren sqarimet e përparshëm. Ky është

mendimi im tash edhe një herë mendoj se nuk duhet të votojmë tash për as për kurrfarë varianti, para konsultime. Faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit profesor ,fjalën e ka akademik Nexhat Daci.

**DEPUTETI NEXHAT DACI** – Ju faleminderit z. kryetar, kolegë deputetë. Nuk e besoj që në sallë dikush do të votonte kundër propozimit që e dha z. Hasani ose dikush tjetër, çështja është vërtet e dhimbshme ose a do të duhej të sillej seanca plenare në një nivel të atillë që një deputet ta ndiej ose të mos e ndiej atë që me dhimbje të madhe e ka pritur krejt Kosova. Ajo që është e dhimbshme si institucion, po e them dhe besoj se duhet të jetë hera e fundit që ngjanë në Kosovë.

Dy ministra përgjegjës për atë çështje janë në sallë, ministri i Brendshëm dhe ministri i Drejtësisë. Jam i bindur thellë se edhe ata kanë pasur po aq informacione sa kanë edhe të gjithë deputetët këtu, kjo është e dhimbshme. Komisioneri i Qeverisë ose ministri i Qeverisë sonë informohet nga shtypi. Kjo ka ngjarë edhe në fillim të mandateve të kaluara, kur binim qesharak dhe kryeministri kishte më pak informacione se gazetarët, kjo duhet të ndërpritet.

Profesor Hamiti e tha mirë. Nivelet e para tona, paria jonë në nivele përkatëse duhet ta stopojë këtë me çdo çmim. Ka qenë një qëndrim në institucione dhe në udhëheqësi të institucioneve. Në vendet e plagëve të mëdha, të masakrave të mëdha duhet të jemi shumë të kujdesshëm që mos të provokohen ato qendra. Krusha është një prej dhimbjeve shumë të mëdha që gjithkush që e ka vizituar ka parë se nuk ka prind ,nuk ka babë të fëmijëve dhe të ngjajë një aksident i tillë, një provokim i rëndë për institucionet, unë e them dhe për popullin e Kosovës, është e papërsëritshme.

Prandaj, z. Kryetar, ne e aprovuam një rend dite dhe të shkojmë sipas atij rendi të ditës. Askush në sallë nuk e ndien veten të papërgjegjshëm për atë që e tha deputeti Nait Hasani, të gjithë jemi për atë, po të shkojmë në një mënyrë që nuk e përçajmë seancën, nuk e përçajmë popullin, por jo edhe të pandjeshëm, prandaj po e përfundoj. Kërkoj që Qeveria jonë në këtë fazë të jetë e informuar nga burimi dhe ne pastaj të merremi me vendimet e Qeverisë tonë që e kemi zgjedhur. Prandaj të ndërpritet praktika, fitohet përshtypja që në Kosovë kosovarët nuk janë pronarë të asgjëje, 7 vjet pas luftës dhe pas çlirimit dhe të mos marrim vendim, ta presim pra, edhe prof. Gashi që të presim dhe raportin dhe t'i shohim qëndrimet e Qeverisë sonë dhe ato të ministrave përkatës, pastaj Parlamenti të vazhdojë Ju faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Diskutuesi i fundit për këtë çështje do të jetë Nazim Jashari.

**DEPUTETI NAZIM JASHARI** – Të nderuar kolegë deputetë ,të nderuar ministra. Shpreh keqardhjen që erdha pak me vonesë dhe nuk isha këtu kur u votua rendi i ditës, mirëpo sidoqoftë Rregullorja jonë e punës, qoftë ajo me të cilën kemi punuar deri më tani, qoftë ajo në të cilën po pretendojmë ta ndryshojmë e parasheh që rendi i ditës i punës së

Kuvendit mund të ndryshohet gjithmonë kur ka çështje urgjente dhe nuk e mendoj se çështja e rastit që ndodhi në Krushë të Vogël është çështje jo urgjente për këtë Kuvend. Dua ta përkrah z. Hamiti që ky Kuvend nuk duhet të votojë për, a duhet a s' duhet të formojë komision, por që duhet formojë komision ky Kuvend nuk dua ta ve në diskutim. Pse e them këtë? E them pse ky Kuvend duhet thjeshtë të marrë përgjegjësi të cilat i ka. Ne jemi të deleguar edhe nga qytetarët e Krushës së Vogël dhe duke qenë se kemi mandatin edhe të tyre, ne do të duhej ta vendosnim një komunikim të drejtpërdrejtë me ta dhe nuk ka mënyrë tjetër se si mund të bëhet ky komunikim përveç se të mandatohet një komision që kontakton me ata njerëz dhe e prek traumën dhe shqetësimin e tyre. Pra si do ta bëjmë, a do ta bëjmë në mënyrën siç e propozoj z. Hamiti pra, me konsultim të shëfave të grupeve parlamentare ta gjejmë një marrëveshje se si ta formojmë komisionin dhe ai komision të shkojë dhe të kërkojë informacione. Ne nuk duhet vetëm të presim informata, por duhet edhe t'i kërkojmë ato. Informatat kërkohe pikërisht në këtë formë, duke mandatar komisionet të cilat e kanë për detyrë të grumbullojë informacione dhe ato më vonë t'ia pasojnë Kuvendit. Pra e përkrah plotësisht propozimin e z. Hasani për formimin e Komisionit, e përkrah edhe propozimin e akademikut Sabri Hamiti që të mos votojë Kuvendi për komisionin, por sigurisht duhet të zgjidhet mënyra se si të formohet komisioni për pa e pruar Kuvendin në gjende të votojë. Pra duhet që shëfat e grupeve të ulen, të merren vesh dhe ky komision gjithsesi të formohet, të shkohet në Krushë të bisedohet me njerëzit, të kërkohe informata edhe nga policia e UNMIK-ut edhe nga policia jonë dhe ai raport t'i paraqitet kësaj seance. Ju faleminderit.

**KRAETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit. Megjithatë duhet të përcaktohem për, ose propozimin e Sabri Hamitit që ju jeni për të dyja njësoj. Vërtet është vështirë të vendoset tash kur i njëjti kandidat ose deputet përcaktohet për dy propozime. Fjalën e ka z. Xhavit Haliti.

**DEPUTETI XHAVIT HALITI** – Z. kryetar, të nderuar kolegë ministra. Shqetësimi është i të gjithëve, po shihet, rrugëdalja nuk po gjendet, prandaj unë propozoj për ta lehtësuar rrugëdaljen nga kjo gjendje që jemi, mendoj se asnjëri nga grupet parlamentare nuk po diskuton për të marrë primat ose për të bërë fushatë elektorale, por janë të bashkuara dhembjet që kanë ndodhur në Krushë me papërgjegjësinë. Në qoftë se është papërgjegjësia e atyre që kanë bërë dhe në qoftë se do të duhej të gjykonin drejtë mendoj që ka bërë papërgjegjësi të madhe, na kemi vërtet institucione dhe dakordohem me z. Daci që shumë herë ministrat tonë informohen prej mediave për ngjarjet që ndodhin dhe nuk i ka pyetur kush. Megjithatë propozimi i Kryesisë së Kuvendit, duke filluar me pikën e parë të rendit të ditës, mendoj që i hap rrugët edhe idesë së krijimit të komisioneve, idesë së thirrjes në interpelanca dhe për t'i shtruar pyetje edhe ministrit të Brendshëm që është këtu tani, edhe të gjitha institucioneve të Kosovës, të cilat janë përgjegjëse ndaj Kuvendit të Kosovës.

Prandaj, unë propozoj të mos futet në votim asnjëri propozim, të miratohet Rregullorja ose ndryshimet në Rregullore, të miratohen dhe amendamentet që do të miratohen u hapin rrugë, mendoj që menjëherë pas kësaj të shtrohen çështjet në këtë seancë të Kuvendit të Kosovës dhe të marrin informacione të sakta nga përgjegjësit e rendit, nga përgjegjësit e institucioneve të Kosovës. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit Xhavit, dua të them se edhe unë pajtohem që të mos shkohet në votim, është çështje vërtet serioze ,por shumë racionale ajo që pritet se hulumtimet t'i marrim nga organet kompetente.  
Prandaj propozojmë që të shkojmë me pika të rendit të ditës.

Propozim vendimin për disa ndryshime dhe plotësime në Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës.

Në harmoni me kalendarin dhe dokumentet që u paraqitën sot. Materialin e keni marrë me kohë, i keni lexuar sigurisht. Kalojmë në amendamentet e propozuara një nga një.

Amendamenti 1

Kemi votuar për rendin e ditës, pra për këtë pikë të rendit të ditës,kemi votuar. .  
Urdhëroni z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Lidhur me propozimin që ka ardhur nga Kryesia për ndryshimin e Rregullores së punës, natyrisht se si deputet pajtohem edhe unë siç u pajtuan edhe të tjerët siç tjerët u deklaruan këtu se ka një konsensus të grupeve parlamentare për ndryshimin e Rregullores. Vetë ideja e ndryshimit të kësaj rregullore nuk ka ardhur rastësisht ,por pikërisht prej asaj që vërtet Kuvendi nuk ka qenë funksional aq sa duhet dhe si duhet, por nuk do të thotë se vetëm me këto ndryshime të propozuara nga Kryesia e Kuvendit do të bëhet funksional Kuvendi.

Unë konsideroj se idenë e ndryshimit të Rregullores së Kuvendit duhet ta pranojmë si Kuvend dhe përpos këtyre amendamenteve ose këto çështje që Kryesia ka propozuar ndryshime, unë konsideroj se edhe disa nene të tjera për të cilat ne sot nuk mund të diskutojmë dhe të pranojmë në mënyrë automatike ndryshimet, që do të duhej të bëheshin ,sepse po të pajtohemi me këtë konstatim,atëherë do të ishte mirë që Komisioni për Rregullore të punës së Kuvendit t'i merrte këto propozime të Kryesisë dhe propozimet eventuale të deputetëve ose të grupeve parlamentare dhe pas një analize, pas një shqyrtimi të na sillen në Kuvend dhe si të tilla ne t'i miratojmë.

Unë do të përmend vetëm faktin me të cilin nuk mund të pajtohem kur lidhur me interpelancën që thuhet se ndryshohet e tërë rregulla, rregulla 25 dhe duhet të lexoj nga kjo rregull pikën 9 të propozuar dhe pikën 9 të Rregullores.

Pika 9 e propozuar e relativizon mundësinë e një vendimi dhe një votimi të një vendimi në Kuvend me rastin e interpelancës.

Ndërsa në Rregulloren që ka qenë më parë pas çdo debati propozimi vihet në votim, do të thotë është mënyrë kategorike dhe jo relativizuese. Prandaj nuk konsideroj se ky ndryshim është krejt me vend me që edhe pjesë të tjera të ngjashme të tilla ka sa të duash, propozoj që vërtet ne të miratojmë propozimin për ndryshimin e Rregullores dhe

komisioni në afat sa më të shkurtër me amendamentet e tjera dhe me këto të bëjë propozimin përfundimtar për ndryshim të Rregullores.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Faleminderit. Secili deputet e ka të drejtën të propozojë ndryshimet në Rregullore. Sot po flasim për amendamentet që janë afruar për ndryshim.

Amendamenti 1

Kush është për? Ju faleminderit, Kundër. Nuk ka. Që përmbahen.. Nuk ka. Ju faleminderit.

Kalon amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

Lus teknikën në qoftë se është gati për votim.

Votojmë tash:

Për..... 70;

Kundër..... 5.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 70;

Kundër..... 4.

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 74;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 4.

Votojmë për tekstin në tërësi, amendamentet që u votuan.

Votojmë tash:

Në sallë janë 90 deputetë,

Për ..... 74;

Kundër..... 2.

Kalon propozim vendimi për ndryshimin e Rregullores së punës të Kuvendit.

Sa për njoftim 3 deputetë nuk i kanë kartelat dhe kanë votuar me dorë, prandaj është ky numër 74. Faleminderit.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 19.12.2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportin dhe rekomandimet e amendamenteve.

Urdhëroni z. Nekibe.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Meqë në rend dite e kemi miratimin e procesverbalit ,a do të votohet a jo?.

KRYETARI KOLË BERISHA – E pranoj vërejtjen, por megjithatë ne votuam në fillim për rendin e ditës.

Atëherë pyes a ka dikush rreth miratimit të rendit të ditës për seancat e mbajtura të datës 11, 12 e 15 maj për procesverbalet, më falni. Urdhëro Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryetar, diskutimi dorëzuar me shkrim nuk është përfshirë në procesverbalin tim , asgjë tjetër ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Dikush tjetër? Aprovohet procesverbali i seancës së kaluar me këtë vërejte të deputetit Kelmendi.

Kush është për? Ju faleminderit.

Hapi diskutimin rreth shqyrtimit të dytë të Projektligjit për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës.

Komisionet parlamentare i kanë shqyrtuar vërejtjet dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionit Funkcional dhe raportues në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës e ka bazën e vetë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligji për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës me amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për operën, baletin dhe filarmoninë e Kosovës dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në miratimin e amendamenteve të këtij Projektligji një nga një.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për ..... 69:

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për ..... 69:

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për ..... 68:

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për ..... 68:

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për ..... 66:

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për ..... 69:

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 6.



Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për ..... 59:

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 7.

Urdhëroni z. profesor Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI - Zotëri kryetar i Kuvendit. Unë nuk kam vërejtje për asnjë amendament, por unë po e shoh që janë shumë, dhe po shoh që askush nuk po konteston asgjë. Me rregullat në fuqi të Parlamentit, nëse Komisioni nuk ka vërejtje, ka mundësi që të votohet votimi i Komisionit në tërësi. Mua më duket që kjo është krejt punë teknike se nuk është substanciale, nëse komisioni thotë që këto amendamente kalojnë prej tij pa asnjë vërejtje. Unë besoj që kemi të drejtë dhe mundësi që ta bëjmë edhe në këtë menjëherë, jo të shkojmë 61 se është punë teknike. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Edhe unë pajtohem me ju, por Rregullorja parashih ndryshe profesor. Le të shkohet për çdo amendament veç e veç, vazhdojmë me amendamentin e radhës nr. 8.

Amendamenti 8

Votojmë tash.

Fjalën e kërkon z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Rregullorja mund të thotë, ndoshta ndryshe, por është e drejtë e Kuvendit që me marrëveshje ta ndryshon këtë çështje . Unë mendoj se e shpejtojmë procedurën. Dhe mundemi.

KRYETARI KOLË BERISHA - Edhe unë pajtohem pasi që ka propozime të tilla që të shkojmë me këtë propozim.

Po ju them se me Rregullore nuk është e lejuar kjo, por kemi vepruar edhe në disa raste kësi soji, është kërkesë e Kuvendit, dhe ju lutem të vendosim për këtë.

Jeni për atë që të shkohet për të gjitha amendamentet përnjëherë.

Votojmë përmes elektronikës, kush është që të votohet për të gjitha amendamentet në tërësi, Votojmë tash.

Për ..... 47;

Kundër ..... 4

Kalon propozimi që të shkohet në të gjitha amendamentet përnjëherë.

Tash votojmë për të gjitha amendamentet.

Qes në votim aprovimin e amendamenteve në tersi.

Kush është për? Votojmë tash.

Për .....60;

Kundër..... 4,

Miratohet amendamentet në këtë Projektligj.

Votojmë për ligjin në tërësi. Kush është për  
Votojmë tash

Për.....57

Kundër..... 2,

Miratohet Projektligji në tërësi me amendamentet e propozuara.

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për operën, baletin dhe Filarmoninë e Kosovës. Ju faleminderit.

Kalojmë me pikën e radhës

#### **4. Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera**

Në bazë të raporteve dhe të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, si komision funksional dhe raportues, jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera si vijon

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj shkojmë në aprovimin e amendamenteve një nga një.

Urdhëroni profesor Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar, Grupi Parlamentar i LDK-së i ka shqyrtuar të gjitha amendamentet e këtij ligji dhe nuk ka rezervë ndaj asnjë amendamenti, kështu që ne kemi vendosur t'i mbështesim të gjitha dhe votojmë për.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit!. Fjalën e ka z. Krasniqi

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Edhe ne si grup parlamentar nuk kemi vërejtje në amendament, dhe kisha kërkuar që vetëm nëse ka vërejtje në ndonjë amendament atëherë le të diskutohet, por për amendamentin të cilin nuk ka vërejtje nuk e shoh të arsyeshëm të shkohet një për një kur nuk ka vërejtje. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. kryetar edhe Grupi Parlamentar i Aleancës i mbështet të gjitha amendamentet, jemi për.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Atëherë t'i miratojmë amendamentet në tërësi, votojmë tash

Për ..... 56,  
Kundër..... 2.

Kalojnë amendamentet, në sallë momentalisht janë 67 deputetë, votojmë ligjin në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash.

Për..... 62,  
Kundër..... 2.

Konstatojë se miratohet Projektligji me amendamentet e aprovuara më parë,

**5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2003/77 për lëndën arkivore dhe arkivat**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28. prill 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit funksional, përgjegjës për raportim si dhe komisioneve kryesore.

Ftoj nënkryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport deputetin Nimon Alimusaj që në emër të Komisionit para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë.

Ligji për lëndën arkivore dhe për arkivat është miratuar nga ky Kuvend, diku në fillim të vitit 2003, është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special dhe ka dalë në "Fletën Zyrtare", më vonë Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji etj. e ka rishqyrtuar këtë ligj me kërkesën e drejtorit të arkivave të Kosovës dhe ka parë se është e nevojshme të ndryshohet ky ligj dhe i ka propozuar Kuvendit të Kosovës të miratohet propozimi i këtij komisioni për ndryshimin e këtij ligji.

Kuvendi i Kosovës, e ka miratuar në vitin 2003 dhe në bazë të atij ligji arkivat e Kosovës i mbikëqyr Ministria e Kulturës. Duke u nisur nga rëndësia se arkivat janë institucione shtetërore me rëndësi të posaçme, me kalimin e arkivit në kuadër të Qeverisë, krijohen mundësi reale për realizimin e bashkëpunimit të suksesshëm ndërkombëtar të arkivave të Kosovës.

Ndryshimi i pozitës së Arkivit të Kosovës nga mbikëqyrja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Çështjeve Jorezidente dhe me kalimin në Qeverinë e Kosovës, si institucion i pavarur ,bëhet në pajtim me pozitën e të gjitha arkivave në vendet e tjera të botës.

Për ta realizuar qëllimin ky ligj është dashur të ndryshohej dhe të plotësohej me nenet ku parashiheshin mbikëqyrja dhe roli i institucionit të Arkivit të Kosovës. Me aprovimin e këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve të ligjit, do të krijohen kushtet që ligji të gjejë zbatim në të gjitha shtresat e shoqërisë. Avancimin e statusit të arkivave e kërkojnë standardet bashkëkohore të arkivistikës, Këshillit Ndërkombëtar për Arkivat dhe UNESCO. Me ndërrimin e pozitës së arkivit me kalimin në kuadër të Qeverisë së Kosovës, do të realizohen këto synime.

1. Fuqizimi i arkivave të Kosovës,
2. Pavarësimi në aspektin financiar, profesional dhe në realizimin e politikave programore,
3. Zhvillimi i veprimtarisë arkivore shumë sa më funksional dhe sa më profesional
4. Shërbimi arkivor në Kosovë të jetë unik, integral, i pandashëm dhe të ushtrohet në bazë të standardeve ndërkombëtare. Ne si komision shpresojmë se procedura për aprovimin e këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve të ligjit, do të përfundojë brenda afatit të shkurtër. Ju faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit profesor, përfaqësuesi i PDK-së, fjalën e ka deputetja Sala Ahmeti

**DEPUTETJA SALA AHMETAJ** – Me qëllim që ky ligj të jetë sa më funksional dhe për arsye të rëndësishme së madhe që ka arkivi, ne e mbështesim këtë propozim dhe pajtohemi që të vazhdohet me procedurën e më tutjeshme.

**KRYETARI KOLË BERISHA** –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Myrvete Dreshaj

**DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ** – BALIU- I nderuari z. kryetar, Grupi Parlamentar i Aleancës dhe unë anëtare e Komisionit e vlerësoj të arsyeshme përkrahjen e kërkesës së Komisionit për Arsimit, Shkencë Teknologji, Kulturë, Rinie dhe Sporte për miratimin e Projektligjit për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe për arkivat dhe kalimin e varësisë së tyre nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në varësi të drejtpërdrejtë të Qeverisë për disa arsye:

1. Në këtë mënyrë institucioneve të Kosovës u shtohet edhe një përbërës i rëndësishëm shtetëror,
2. Niveli i lartë i njohjes së pozitës të këtij institucioni brenda institucioneve të Kosovës ia bën të mundur komunikimin e drejtpërdrejtë me shtetet fqinje dhe përgjithësisht ndërkombëtar
3. Pozita e lartë shtetërore që shqyrtohet dhe miratohet sot për arkivat, kërkohet edhe nga institucionet ndërkombëtare, që më parë ia kanë bërë vendin e projektit të tyre me rëndësi kulturore dhe shkencore.
4. Avancimi i Arkivit të Kosovës nga varësia e Ministrisë së Kulturës , Rinisë dhe Sporteve në varësi të Qeverisë së Kosovës më në fund nënkupton edhe përmirësimin e anës buxhetore të tij që nënkupton edhe ngritjen e kapaciteteve profesionale kërkimore.

E gjithë kjo do të ndihmojë në pasurimin e fondeve të tij jo vetëm në fonde të administratës sonë shtetërore, por me dokumentet e fondeve të vjela nga arkivat ndërkombëtare për historinë dhe zhvillimet tona. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Shpresa Murati

DEPUTETJA NURAN MALTA – Sayın Başka, geçen dönem kabul edilen Arşivler Yasasının değişikliği ve önerilerini kabul etmekteyiz. 6+ Grubu olarak sayın başkan yardımcısı Nimon Alimusayın dediği gibi, biz komisyon olarak zaten kendi önergelerimizle geldik ve Kosova Arşivlerinin daha profesyonel ve fonksiyonel olması için 6+ Grubu olarak bu önergeleri kabul etmekteyiz.  
Teşekkür ederim.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Sabit Rrahmani e ka fjalën

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryetar, Grupi Parlamentar për Integrim i mbështet në parim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndë arkivore dhe arkiva duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, kurse më tutje do të japim kontributin tonë nëpër komisione. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit ! përfaqësuesi i Partisë Reformiste ORA

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar, në mbështetje në parim të modifikimit dhe plotësimin të paraqitura në këtë grup amendamentesh, Partia Reformiste ORA duhet të theksoj dhe të tërheq vërejtjen për rëndësinë e këtyre plotësimeve dhe në një korrigjim shumë të rëndësishëm që është bërë në lidhje me ripozicionimin e kësaj agjencie, që është kaq i rëndësishëm dhe veçanërisht për funksionimin karakteristik shtetëror ,që është klasik në vendet e tjera, besojmë dhe si komision shpresoj se do të japim mbështetje maksimale që këto amendamente të hyjnë në funksion sa më shpejt dhe veçanërisht të mos ketë pengesa sa i përket alokimit buxhetor, i cili deri më tani ka qenë i lidhur me Ministrinë e Kulturës dhe që tash duhet të lidhet drejtpërsëdrejti me Qeverinë e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari z. kryetar, unë mendoj se se ky ndryshim bëhet vetëm sa i përket mbështetjes së këtij ligji nga një ministri në ministrinë tjetër, kështu si është përpiluar në tekstin që na është dhënë për të diskutuar për të, në nenin I thotë të zëvendësohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me fjalën, Qeveria e Kosovës. Po kjo ministri është pjesë e asaj qeverie dhe unë nuk di sikur të thuhet mbështetet nga Ministria e Shërbimeve Publike do të ishte më konkrete dhe shumë më e mirë dhe më e përshtatshme për t'u zbatuar ky ligj, sepse Qeveria i ka disa ministri. Nuk është jashtë Qeverisë as Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por nuk është as ministri adekuate, e cila duhet të merret me çështjen e lëndës arkivore dhe me arkivat. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Pasi nuk ka të interesuar tjetër për diskutim, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash

Për.....66  
Kundër.... 1.

Kalon projektligji. Në sallë janë momentalisht 67 deputetë.

Në bazë të rregullës 23. pika 6 dhe të rregullës 35.2 Kuvendi ngarkon këto komisione,

1. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini dhe Sport si komision funksional dhe referues,
2. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Komizë Kushtetuese
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj pas shqyrtimit të parë ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqes raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e radhës.

**Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimit e të ushqyerit me qumësht të gjirit të nënës.**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 28 prill 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim. Si e shihni në sallë është z. ministër që mund ta thërrasim për prezantim të Projektligjit, urdhëroni z. Kryeziu

ZËVENDËSMINISTRI FADIL KRYEZIU – Z. kryetar, të nderuar deputetë, në fakt unë ulem zakonisht në pjesën e pasme atje, për arsye se është marrëveshje parimore, në mungesën e ministrit jam sot këtu, që të bëjë ose prezantojë ekspozitën e Projektligjit për

nxitje, mbrojtje dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht gjiri, këtij dokumenti mjaft të rëndësishëm për shëndetësinë dhe shëndetin e qytetarëve dhe sektorin shëndetësor në përgjithësi. Prandaj me këtë rast dëshiroj t'ju përshëndes të gjithëve që keni hapur këtë procedurë për këtë propozim ligj në Parlament.

Qëllimi i ligjit shkon në drejtim të nxitjes, të mbrojtjes dhe të promovimit të ushqyerit me qumësht gjiri, i cili ka për qëllim të kontribuojë në sigurimin e të ushqyerit adekuat të fëmijës me anë të nxitjes, mbrojtjes dhe promovimit të të ushqyerit në gjiri.

Të ushqyerit me gjiri është mënyra më e shëndetshme, më e mirë, më e lehtë, më e lirë, më higjienike dhe më ekologjike e të ushqyerit të foshnjës. E gjithë evidenca shkencore që ka të bëjë me të ushqyerit e foshnjës favorizon të ushqyerit me gjiri në raport me cilado forma ose lloje të zëvendësuesve të qumështit të gjirit, qofshin ato natyrale ose artificiale. Situata me të ushqyerit me gjiri në Kosovë nuk është e mirë, ndonëse mbi 90% të nënave fillojnë të ushqejnë me gjiri foshnjat e tyre, shkalla e të ushqyerit të foshnjës vetëm me qumësht gjiri deri në moshën 4-mujore zë në 16% ,ndërsa në 6 – mujore është vetëm 12.2%.

Arsyet e një shkalle kaq të ulët e të ushqyerit me gjiri në Kosovë janë të shumta dhe të llojllojshme. Kjo rënie kaq e madhe dhe e shpejtë e të ushqyerit me gjiri i atribuohet më së shpeshti futjes së hershme të lëngjeve dhe të zëvendësuesve të qumështit të gjirit në dietën e foshnjave, niveli i ulët i informimit, i edukimit dhe i komunikimit lidhur me të ushqyerit e foshnjës në popullatë, praktikat jo të shëndetshme të ushqyerit të foshnjave, këshillimi i pamjaftueshëm lidhur me mënyrat më të mirat të ushqyerit dhe të përkujdesjes për foshnjat ,si dhe ofrimi dhe marketingu i parregulluar dhe i pakontrolluar i zëvendësuesve të qumështit të gjirit.

Nevoja për këtë ligj del edhe nga kërkesa për të plotësuar arritjen e qëllimit paqësor, fillimi i shëndetshëm i jetës së dokumenteve themelore të Ministrisë së Shëndetësisë, politikës shëndetësore të Kosovës, strategjisë për zhvillimin e sistemit shëndetësor të Kosovës, është një nga qëllimet e parapara në strategjinë e shëndetit riprodhues.

Përpilimi i këtij projektligji është bërë duke u mbështetur në dokumentet relevante ndërkombëtare, veçanërisht në rekomandimet teknike të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, UNCEF-it dhe të rrjeteve të fuqishme të organizatave joqeveritare që përkrahin,mbrojnë dhe promovojnë të ushqyerit me gjiri si p.sh. Itfan etj.

Ky projektligj është mbështetur fuqishëm në Deklaratën e Inoçent-it Kodit Ndërkombëtar të Marketingut të zëvendësimit të qumështit të gjirit dhe dhjetë hapave të të ushqyerit të suksesshëm me gjiri, si dhe në përvojën dhe në zbatimin e ushqimit me gjiri si dhe në spital të ashtuquajtur mik të foshnjës në më se 100 shtete. Sikurse edhe në Kosovë, ku 5 maternitete në spitalet rajonale janë të certifikuar si spitale mike të foshnjës. Ndihmë të madhe në procesin e përpilimit të këtij ligji kanë dhënë: grupi kosovar për iniciativë, spitali mik i foshnjës dhe Shoqata e Pediatërve të Kosovës, të cilët në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtar që në vitin 2001 kanë përpiluar

Rregulloren për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me gji, e cila është miratuar edhe nga Ministria Shëndetësisë me Udhëzim të posaçëm administrativ.

Në hartimin e këtij projektligji jemi mbështetur në Ligjin për shëndetësinë, në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, në Rregulloren për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me gji, në Ligjin për barazinë gjinore - përmbledhje ndërkombëtare e legjislacionit shëndetësor, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë që ka qasje në dokumentacionin ligjor të shumë shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të ushqyerit me gji të shteteve të Bashkësisë Evropiane të tjera.

Projektligji për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht gjiri mbështetet në tri shtylla kryesore: afirmimin e evidencës shkencore dhe i njohurive që mbështesin të ushqyerit me qumësht gjiri, si mënyra më e mirë e të ushqyerit të foshnjës i siguron rritjen dhe zhvillimin fizik, psiko-social, e konjektiv të fëmijës, mbron shëndetin e nënës dhe mirëqenien emocionale dhe materiale të familjes dhe të shoqërisë dhe vendosjen e institucioneve shëndetësore që nxisin përkrahjen dhe promovojnë të ushqyerit me qumësht gjiri.

Afirmimin e së drejtës së patjetërsueshme të fëmijës, në mënyrën më të mirë të ushqyerit, të drejtën për mbijetesë, rritje, zhvillim dhe përkujdesje shëndetësore, të nivelit më të lartë dhe të së drejtës së femrës për informim dhe zgjedhje të mënyrës së të ushqyerit të foshnjës së saj.

Promovimin dhe respektimin e Kodit Ndërkombëtar të marketingut të zëvendësuesve të qumështit të gjirit. Grupi i punës dhe ekspertët përkrahen kësaj nismë dhe kanë qenë të vendosur që këto tri shtylla të prezantohen në këtë projektligj, me qasje të balancuar në mënyrë që të rregullohen këto fusha të rëndësishme të mbrojtjes shëndetësore të nënës dhe të fëmijës të të ushqyerit të foshnjës dhe të mbrojtjes së familjes e shoqërisë, duke mos rrezikuar praktikën dhe interesat optimale të prodhuesve, të tregtarëve dhe distributorëve të produkteve ushqimore që përfshinë ky projektligj konform kodekseve të pranuar ndërkombëtare, e që është hartuar në 11 kapituj e 19 nene.

Pritet që ky ligj të ketë ndikim në ngritjen e theksuar të shkallës së të ushqyerit me qumësht gjiri të foshnjave, veçanërisht të ushqyerit vetëm me qumësht gjiri të foshnjave gjër më 6 muaj. Të kontribuojë në uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë infantile, prevalencës dhe incidencës së karcinomës së gjirit, karcinomës së ..... dhe të kontribuojë në mirëqenien e familjes dhe të shoqërisë. Zbatimi i ligjit kërkon bashkërenditje të institucioneve shëndetësore dhe sociale dhe përkrahje të fortë të institucioneve tregtare dhe kontrolluese si inspektoratet sanitare, tregtare, dhe të shoqërisë civile dhe të organizmave qeveritarë dhe joqeveritarë që do të ndihmojë në monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji.

Sa u përket implikimeve eventuale financiare këto janë të parapara dhe gjejnë mbështetjen në strategjinë e shëndetit riprodhues 2006-2015, e cila i ka vendosur



synimet dhe qëllimet strategjike në këtë fushë që përfshihen në planin e aktiviteteve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Presim që diskutimet dhe propozimet që do t' mbani në këtë shqyrtim të parë, të ndihmojnë që në propozim ligji të begatohet edhe më shumë , të nxirret një ligj kualitativ për të mirën e qytetarëve të Kosovës, pra në fushën që e mbulon. Ju faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit!, z. zëvendësministër, fjalën e ka deputetja Nafije Berisha

**DEPUTETJA NAFIJE BERISHA** - I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputetë, e nderuara Qeveri nëse jeni diku në hol të sallës së Kuvendit.

Projektligjin që e kemi ne sot në diskutim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje edhe pse mendon se ndoshta është një ligj i rëndësishëm ku kompletohet e gjithë legjislatura e fushës së shëndetësisë, mirëpo megjithatë mendon se nuk ka qenë ndonjë ligj me prioritet shumë të lartë. Edhe pse gjithë fusha dhe problematika e këtij projektligji kanë mundur të hynin lirisht në Projektligjin e mëhershëm që e kemi aprovuar këtu në Kuvend për shëndetin reprodaktiv.

Megjithatë personalisht jam shumë e shqetësuar, fillimisht nga titulli i Projektligjit, sepse Projektligji titullohet Projektligj për nxitjen, mbrojtjen promovimin e të ushqyerit me qumësht gjiri e që mendoj së këtij Projektligji do të ishte shumë e arsyeshme t'i shtohej edhe fjala: gjirit të nënës ,d.m.th. të fokusohet pak kjo sferë.

Në memorandumun e Projektligjit për shëndetin riprodhues thuhet se Kosova për fat të keq ka indikatorë shumë të dobët vitalë në lëmin e shëndetit të nënës dhe të fëmijës në Ballkan, d.m.th. e ka kualitetin më të dobët. Gjithashtu në fjalën hyrëse të këtij projektligji ceket se në vit ne na vdesin 1200 deri në 1500 fëmijë të moshës nën 1 vjet. Unë e kisha pyetur ministrin nëpërmjet z. ministrit të tregojë se, me cilat pika dhe me cilat nene mendon ai se ky Projektligj do ta zvogëlojë vdekshmërinë e foshnjave dhe të nënave. Gjithashtu në hyrjen shpjeguese të këtij projektligji, i cili fillon me një pasus të cilin e përdori dhe zëvendësministri në fjalën e tij, ku të ushqyerit me qumësht gjiri është mënyra më e shëndetshme dhe më e mirë, me e lirë dhe më higjienike e më ekologjike e të ushqyerit të fëmijëve. Unë pajtohem me disa nga këto konstatime, por nuk e di z. ministër kam dëshirë të di si mendoni ju që është mënyra më e lehtë dhe më ekologjike e të ushqyerit të fëmijëve.

Të dhënat statistikore të cilat janë përdorur në pjesën shpjeguese të këtij projektligji kam përshtypje se nuk japin shpjegim për ndonjë studim të kryer në Kosovë lidhur me këtë çështje, por japin përshtypje se janë marrë nga shtetet e ndryshme, SHBA-ja Kanada, Evropa, të cilave u shtohet vetëm një konstatim se situata e të ushqyerit me gjiri të nënës në Kosovë nuk është e mirë.

Natyrisht që me këtë konstatim unë nuk pajtohem plotësisht, duke nisur ose duke u bazuar në disa indikatorë, të cilët mund të pengojnë nënën që ta ushqejë fëmijën me qumështin e gjirit. Në e dimë se në Kosovë papunësia është shumë e madhe d.m.th. pjesa më e madhe e femrave në Kosovë janë të papuna, puna nuk është faktori që i pengon ato të mos mund ta ushqejnë fëmijën rregullisht me gjë, pastaj nënat tona nuk kanë pushim të lehonisë z. zëvendësministër kishte me qenë një herë shumë më e arsyeshme që ju t'u siguronit e nënave tona pushimin e lehonisë së paku për 6 muaj, e pastaj me anë të Projektligjit në një mënyrë ato të mbrohen ose të inkurajohen që së paku 6 muaj ta ushqejnë fëmijën me qumësht gjiri.

Gjithashtu në Kosovë, momentalisht nuk ka ndonjë fuqi ose ndonjë rregullore në fuqi, e cila i mundëson nënës së punësuar të ndajë ndonjë kohë nga orari i punës për ta ushqyer fëmijën e vet me qumësht gjiri, e gjithashtu kjo çështje nuk është potencuar as në këtë projektligj.

Të gjitha këto rrethana që i cekta më lart, megjithatë pra gruas sonë po iu i nevojitka krijimi i vetëdijes dhe i përkrahje se duhet ta ushqejë fëmijën me qumësht gjiri. Duhet marrë parasysh atë deklaratën e atij INOQET-it që e përmendi edhe z. ministri që është në hyrjen shpjeguese të Projektligjit ku thuhet se duhet të merren masa, të sigurohet ushqim adekuat i femrave për hir të shëndetit optimal të tyre dhe të fëmijës së tyre.

Z. ministër këtu në këtë projektligj absolutisht asnjë nen nuk flet as nuk thuhet ndonjë masë se çfarë do t'u sigurohej dhe cilat do të ishin ato masa të cilat do të përmirësonin ushqyeshmërinë e femrës në Kosovë që ne e dimë se ushqyeshmëri në bazë të rrethanave dhe të zhvillimit ekonomik e të gjendjes që sot mbretëron në Kosovë supozoj që është një ushqyeshmëri e nivelit shumë të ulët.

Gjithashtu në këtë deklaratën e NOQET-it atje përmenden disa objektiva që me siguri për Qeverinë tonë që nuk vlejnë se ato është dashur të përfundojnë në vitin 90, 95, pastaj politikë kombëtare e të ushqyerit me gjë e që për vendet e rajonit nga është kopjuar kjo statistikë, ajo ka përfunduar diku në vitet e 90-ta. Pra, duhet të bëjmë ndonjë plan kombëtar në këtë drejtim, s'ka lidhje se veç ka kaluar ajo kohë. Sqarimet rreth implementimit buxhetor të këtij projektligji mua nuk më duken shumë normale dhe thjeshtë e kuptoj vetëm si një intencë e Ministrisë që t'i emërojë për një çështje një numër të caktuar të mjeteve, sepse nëse gjendja është aq alarmante në terren, siç paraqitet në këto statistika, atëherë unë nuk e kuptoj se çfarë promovimi do të mund të bënte Ministria për 3 vjet radhazi me vetëm 7.500 € dhe çfarë trajnimesh dhe kujt do t'ia bënte ato trajnime për 3 vjet me vetëm 17.000 €, kështu që kjo deklaratë financiare absolutisht më duket shumë e paarsyeshme. Gjithashtu edhe në këtë projektligj me pak nene dikund 19 nene ose 20 nene në disa vende insistohet dhe ceket që në të ardhmen do të nxirren akte të ndryshme nënligjore. Ky projektligj kishte mundur me qenë akt nënligjor p.sh i Ligjit për shëndetin riprodhues ose akt nënligjor siç e cekta edhe ministri dhe nuk kam arritur ta shoh atë rregullore, e cila momentalisht është në fuqi, a thua ka ndonjë nen më të gjerë ky si ligj se ajo rregullore. Megjithatë Grupi Parlamentar i LDK-së, përkundër të gjitha këtyre çështjeve dhe duke shpresuar që Ministria në të ardhmen do të bëjë edhe më shumë në përmirësimin e të gjitha problemeve që i cekta më lart, ka vendosur ta përkrah

këtë projektligj në leximin e parë për dy arsye. Në një, se do të mundohemi nëpërmjet amendamentimit të këtij projektligji t'i sigurojmë femrës një kornizë ligjore e cila do të mund edhe gjatë orarit të punës t'i siguronte kohë optimale për të ushqyer fëmijën me qumësht të gjirit. Gjithashtu edhe pikërisht për pjesën ku trajton zëvendësuesit e qumështit të gjirit, reklamimin, etiketimin dhe plasimin e tyre në treg, d.m.th këto janë arsyet që grupi parlamentar e ka përkrahur këtë projektligj. Ju faleminderit.

**KRYETARI KOLË BERISHA** - Ju faleminderit. Në emër të grupit parlamentar të PDK-së fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

**DEPUTETJA FLORA BROVINA** - Ju faleminderit z. kryetar, ju përsëndes, e përsëndes z. ministrin që është këtu, ju përsëndes kolegë dhe kolege.

Sot në shqyrtim të parë para nesh është Projektligji për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumështin e gjirit të nënës. Kujtoj se këtë profesion e kam dhe duhet ta kenë, mjekët pediatër, mjekët që merren me këshillimoren për nënat dhe fëmijët, kuadri shëndetësor, dhe gjithë mjekët familjarë në përgjithësi punëtorët shëndetësor, këtë e bëjnë për çdo ditë.

Natyrisht që jam për mundësit e promovimit sa më të mirë pranë nënave të reja për përparësitë për shëndetin e nënës dhe fëmijës për leverdi ekonomike me ushqimin shumë të sigurt, dhe si është ushqimi i gjirit të nënës. Jam gjithashtu edhe për programet të avancuara të edukimit shëndetësor në këtë lami në përgjithësi, do ta quaja një plan nacional për edukimin shëndetësor dhe gjithashtu për njohjen e Deklaratave dhe Konventave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, UNOCEFIT dhe njohjes së strategjive botërore për shëndetin riprodhues, Strategjisë Evropiane për shëndetin publik, planit për veprim të dalë nga Konferenca Internacionale për zhvillimin e popullatës në Itali të mbajtur më 1994.

Çdo respekt anëtarëve të grupit punues të cilët janë nxitur sigurisht nga një ide shumë e mirë dhe e favorshme për shëndetin e nënës dhe e fëmijës, por kam shumë dilema rreth nxjerrjes së ligjit. Diskutimi im mbështetë shumë diskutimin e koleges Nafije Berisha me të cilën edhe jemi së bashku në Komisionin për shëndetësi.

Vërtetë a do të kemi ma shumë nëna pas nxjerrjes së ligjit a do të kemi ma shumë nëna të ushqejnë fëmijët në gj, si mundet një ligj ta rregullojë këtë çështje, a është ky ligj i jashtëzakonshëm apo është një njohje me deklaratën e inocent-it për mbrojtje dhe përkrahjen e promovimit e të ushqyerit në gj të nënës. Për këtë flitet edhe në ligjin për shëndetësi në përgjithësi dhe kujtojë gjithashtu sikur kolege Nafije se ky Projektligj mund të ishte një akt nënligjor i ligjit për shëndetësi ose ligjit për shëndetin riprodhues.

Pyes pse Ministria për Shëndetësi na sjellë një varg ligjesh parciale ose që duhet t'i qoj në vend të ligjeve thelbore dhe të rëndësishme që të rregullonin problematikat në shëndetësi që nuk janë të pakta e të cilat probleme mund të zgjidhen në kuadër të ligjit për shëndetësi dhe ligjit.

Do ti përmend p.sh. ligji për shëndetësi për shëndetin riprodhues, ligji për abortin, ligji për edukimin shëndetësor, mund të ishin një ligj ose akte nënligjore.

Ministria e shëndetësisë e dinë mirë se ky ligj nuk mund të aplikohet pa u aprovuar ligji për sigurimin shëndetësor në të cilin ligj nënave u garantohet pushimi i lehonisë, 3 plus 3 muaj gjegjësisht 6 muaj me mundësi që nënat të punësuara të kenë mundësi t'i ushqejnë foshnjat në gjë edhe gjatë orarit të punës dhe të detyrohen që punëdhënësit të lirohen nënat për këtë.

Ligji për sigurimin shëndetësor ka kaluar shqyrtimin e parë në këtë parlament, ka kaluar debatin publik dhe është amendamentuar në Komisionin për shëndetësi. tani është stopuar pikërisht për shkak të pushimit të lehonisë që do të ishte një nxitje më e mirë e të ushqyerit në gjë dhe promovimit pra të kësaj metode shumë të favorshme, edhe është refuzuar edhe për shkak të pamundësisë së formimit të fondit për sigurimin shëndetësor.

Së dyti, arsytimi që jep grupi punues duke u mbështetur në të dhënat e UNICEFIT të vitit 2001 për Kosovën kujtojë se janë vetë një kopje e një vendi tjetër dhe nuk qëndrojmë, sepse edhe në kuadri mjekësor profesional në lëmin e pediatrikë kemi bërë studime dhe nuk e vërtetojmë këtë të dhënë që citohet në ligj. Në Kosovë ka probleme shumë, por ka edhe dukuri pozitive kur të tjerët mund të mësojnë nga ne. Është traditë nacionale, janë kushtet ekonomike, është papunësia e madhe e gruas që kanë kushtëzuar ushqimin në gjë të nënave me një përqindje më të lartë në Evropë, reklama më e mirë për promovimin e deklaratës për ushqimin në gjë të nënës pikërisht janë nënat e Kosovës kolona e gjatë e refugjatëve e nënave me fëmijë në gjë, pyes çka do të ndodhte po mos të ishin këto nëna të cilat ishte një shembull fort i mirë për gjithë nënat në botë, se ushqimi në gjë është ushqimi që i mbron fëmijët e tyre.

Në pamë se ato nuk ishin shishe, dhe nuk reklamohin produktet e tjera që reklamohen në botë. Në vitin 1996 në Prizren u mbledhën gjithë pediatërit e Kosovës në kongresin e tyre për të biseduar pikërisht për ushqimin në gjë. Kosova atëherë kishte njëqind pediatër prej të cilëve 90% ishin të përfshirë nga puna.

Po atë vit në vjeshtë u takuam në kongresin ndër regjional në Tiranë ku u bë promovimi i deklaratës për nxitje dhe promovimin e ushqimit në gjë. Me këtë shembull desha të them se nuk po startojmë prej sot dhe Ministria e Shëndetësisë nuk starton sot me kuadro të promovojnë ushqimin në gjë.

Kuadrat shëndetësore në Kosovë janë të njohur në këtë çështje. Në fund vërejtjet e mia sigurisht që janë pjesën financiare, projektligji për promovimin e ushqimit në gjë të nënës ose deklarata ka një raport të pa studiuar financiar, e them këtë sepse një ministri e cila nuk disponon me mjetet e mjaftueshme financiare dhe ka probleme të shumta financiare, parashih që 47.500 euro të shfrytëzohen për promovimin e kësaj çështje, dhe absurdi më i madh është që vetë promovimi i nxitjes mbrojtës dhe promovimi i ushqimit në gjë të nënës parashihet të jetë 7500 euro dhe monitorimi po aq mjete ka, kush do të monitorojë që zbatimin e këtij projektligji ose ligji a do të monitorojnë vetë punëtorët e ministrisë po ashtu marrin rroga nga Ministria apo dikush tjetër, nuk thuhet në Projektligj.

Trajnimet parashihen 17 mijë euro, dhe kush do të trajnohen, mjekët që e kanë detyrë ta bëjnë promovimin e ushqimit në gji, apo dikush tjetër nuk thuhet në ligj.

Zbatimi i implementimit në spitale, e njëjta pyetje edhe për këtë parashihen 13 mijë euro, shuma prej vitit në vit fillon duke u zvogëluar, në vitin 2007 parashihen 16 mijë euro, në vitin 2008, parashihen 8 mijë euro çka do të thotë kjo, unë nuk e kam të qartë, a do të thotë se do të zvogëlohet nevoja për nxitjen e promovimit e ushqimit në gji apo foshnjat e lindura tani do të rriten, dhe çka do të ndodhë me nënat e reja që do të lindin fëmijë të tjerë, 77500 euro parashihen nga donatorët e zotuar, por për çfarë dhe cili është projekti për t'i harxhuar këto mjete që kërkohen nuk thuhet në këtë projektligj.

Mendoj dhe përsërisë, se Kosovës i duhet një plan nacional për edukimin shëndetësor e pra edhe për ushqimin në përgjithësi dhe për njohjen e deklaratës për nxitjen dhe promovimin e të ushqyerit në gji të nënës. I duhet edhe kontroll i shëndetësisë për kuadrin mjekësor për zbatimin e ligjit për shëndetësi, por jo një ligj i tillë për të cilin do të harxhonin mjete të kota i cili do të ishte një akt nënligjor.

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

**DEPUTETJA ZYLFJE HUNDOZI** – z. kryetar, z. Ministër, kolegë deputetë, të ushqyerit e foshnjës me gji është mënyra më e mirë që të rritet një fëmijë i shëndoshë. Në Kosovë kjo mënyrë edhe në kohërat e reja e ka ruajtur rëndësinë e vet. Në materialin e dhënë për këtë projektligj jepen të dhëna statistikore për një rënie të numrit të femrave që i ushqejnë foshnjat me gji dhe atë në një shifër shumë të ulët që gjendet në muajin e 6 vetëm 12% të nënave ushqejnë foshnjat me gji.

Shkak për këtë rënie të të ushqyerit me gji konsiderohet mos informimi i mjaftueshëm për rëndësinë e të ushqyerit me gji, kështu që stimulimi dhe promovimi i të ushqyerit me gji janë më se të nevojshëm. Me të ushqyer fëmijën me gji parandalohen shumë sëmundje. pasi që imonoglobulimet nga nëna kalojnë te fëmija, por me këtë sigurohet edhe ngrohtësia emocionale, fëmija ndihet i sigurt, gjë që paraqet një parakusht për zhvillimin e një personaliteti psikik stabil. Me këtë projektligj, gjithashtu, parandalohen keqpërdorimi i ushqimit artificial për foshnje, reklamimi i panevojshëm për çka janë paraparë edhe ndëshkimet, që është shumë pozitive. Ky projektligj përfshin në vete një tematikë të rëndësishme për shëndetin e foshnjës dhe të nënës, por te femrat e punësuar nuk mund të gjejë zbatimin pasi që pushimi i lehonisë edhe më tutje ka mbetur 3 muaj edhe pse Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kohëzgjatjen prej 6 muajve të pushimeve të lehonisë dhe pagesën e tyre e ka inkorporuar në Ligjin për sigurime shëndetësore, i cili pret ta kalojë leximin e dytë në këtë Parlament.

Pa u aprovuar ligjet bazike si është Ligji për sigurimet shëndetësore, Ligji për punë, implementimi i këtij projektligji do të jetë i mundshëm vetëm pjesërisht se femrat e punësuar nuk do të jenë në gjendje t'u japin gji fëmijëve gji gjer në 6 muaj. Pasi që duhet të kthehen në punë pas tre muajve, mendoj që ministritë gjatë përpilimit të

Projektligjeve duhet të marrin parasysh realitetin kosovar dhe që më së pari t'i përfundojnë ligjet bazike të cilat do të mund të implementohen në jetën e përditshme e kur të hartohen këto ligje të vogla shumë lehtë do ta gjendej rruga e implementimit. Thënë me fjalët e tjera për ndërtimin e shtëpisë më së pari duhet të vihen themelet e pastaj në fund kulmi, e jo e kundërta. Gjithashtu duhet të bërë përmirësimin në titull të projektligjit, që duhet të jetë: Projektligji për nxitjen, mbrojtjen dhe promovimin e të ushqyerit me qumësht të nënës, sepse dihet se te njerëzit nënat janë ato që kanë qumësht, e jo burrat.

Për shkak që u thanë edhe për arsye që ky projektligj është i shkurtër për hir të kursimit të mjeteve të buxhetit të Kosovës, ky projektligj ka mundur të inkorporohet në Projektligjin për shëndetin riprodhues, megjithatë pasi që Ministria nuk e ka bërë këtë dhe për shkak të rëndësisë dhe të tematikës në të cilën përfshihet ky projektligj, Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrah në parim. Ju faleminderit

**KRYETARI KOLË BERISHA** - Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqiu në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s

**DEPUTETJA TEUTA SAHATQIU** – Ju faleminderit z. Kryetar. Sipas Deklaratës të bashkangjitur për proceset e integritimit evropian kuptohet se ligji nuk përmban ndonjë obligim që punëdhënësit t'u garantojnë siguri punëtorëve të tyre që janë ushqyese me qumësht gjiri.

Në bazë të rregulloreve në fuqi në këtë kontekst gruaja e punësuar është e diskriminuar sa i përket çështjes së të ushqyerit, pasi që ajo i ka të garantuara vetëm 12 javë pushim lehonie me kompensim, por jemi dëshmitarë të moszbatimit të Kontratës Kolektive në të cilën është pretenduar rregullimi i pushimit të lehonisë. Mendojmë se mungesa e Ligjit për punë, mosmiratimi i Ligjit për sigurime shëndetësore, janë pengesa direkte të mosrealizimit të drejtave elementare të nënës që të jenë pranë foshnjës së tyre, e krejt me qëllim të krijimit të parakushteve për fillim të shëndetshëm të jetës së fëmijës pasi që në gjashtë muajt e parë si ushqim ekskluziv për foshnjën është gjiri i nënës.

Ne e potencojmë që edhe grupi ynë parlamentar në vazhdimësi është angazhuar që kjo çështje të zgjidhet me zgjatjen e pushimit të lehonisë përmes së cilës automatikisht do t'u garantohej kjo e drejtë nënave. Në parim e përkrahim nevojën për promovimin e gjidhënies edhe pse mendojmë se disa çështje kanë mundur të zgjidhen nëpërmjet një ligji e jo si ligje të veçanta. Megjithatë e përkrahim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komision funksion parlamentar. Gjithashtu do të lus që prioritetet t'u jepen ligjeve fundamentale e më vonë të orientohem në ato ligje të cilat nuk janë prioritet dhe që aplikohen nga çdo nënë e cila ka mundësi pa marrë parasysh a ekziston ai ligji apo nuk ekziston ligji. Gjithashtu u bashkohem kolegeve të mia të cilat udhëzuan që kjo çështje do të duhej më mirë të zgjidhej përmes një udhëzimi administrativ se sa përmes një ligji dhe po frikësohem se ky ligj është një vazhdimësi e bërjes së ligjeve për të siguruar një numër të ligjeve e jo më tepër për funksionalizimin e tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ fjalën e ka deputetja Shpresa Murati

DEPUTETJA SHPRESA MURATI – Poštovani predsedniče, ministre i kolege poslanici, Nacrt zakona o podsticaju zaštite i promovisanju dojenja je značajan zakon, jer praktično promovise dojenje kao najbolji način prehrane novorođenčeta, koji obezbeđuje normalan fizički, psihofizički socijalni razvoj deteta, štiti zdravlje majke i emocionalno i materijalno blagostanje porodice i društva. Mleko majke, to jest humano mleko je uvek najbolja i nezamenljiva hrana za odojče u prvih četiri do šest meseci života. Prednosti majčinog mleka su mnogobrojni biohemijski sastavi majčinog mleka je prilagođen potrebama novorođenčeta optimalna je svarljivost majčinog mleka. Majčino mleko štiti dete od infekcija ima ulogu u prevenciji alergije, dojenje podstiče i emotivnu vezu između majke i deteta. Dojenje ima i nesumnjive prednosti i za majku, sve ovo navodi na zaključak da je više nego neophodno mlade majke edukovati i tokom trudnoće o prednostima dojenja beba i samim njenim prednostima. U slučajevima kada je prirodna ishrana iz određenih razloga nemoguća ili nedovoljna odojčetu je neophodno dati adaptiranu mlečnu formulu sastavljenu u skladu sa relevantnim međunarodnim preporukama. Parlamentarna grupa 6+ podržava ovaj predlog zakona u načelu i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit për Integrim, fjalën e ka Dr. Agani

DEPUTETI FERID AGANI – I nderuari z. Kryetar, i nderuari z. ministër i nderuari zotëri zëvendësministër, të nderuar kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar për Integrim e konsideron këtë dokument ligjor pavarësisht nga kritikën që mund të jenë edhe të bazuara sa i përket inkorporimit eventual të tij në si pjesë të akteve të tjera ligjore, megjithatë si një akt shumë i rëndësishëm, si një veprim tejet i rëndësishëm i Ministrisë së Shëndetësisë, i lëmit të shëndetësisë publike.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për gjendjen socio ekonomike të popullatës së Kosovës, për shkallën e lartë të varfërisë dhe të papunësisë, për nevojën e sigurimit të një ushqimit sa më cilësor për foshnjat në ditët e para të jetës së tyre. Konsideroj se ky projektligj, duke insistuar në promovimin dhe në nxitjen e përdorimit të qumështit të nënës si mjet themelor ushqyes të foshnjat, së paku vitin e parë të jetës. si ligj i cili do të sigurojë zgjedhje të informimit të nënave tona për mënyrën e ushqimit të foshnjave të tyre, do të jetë një kontribut substancial në lëmin e shëndetësisë publike, posaçërisht nëse i kemi parasysh disa fakte. Unë jam i bindur se shumë nëna të reja sikur në mediat tona elektronike të jenë më shpesh të ballafaquara me informatat, siç janë për shembull, se në rast se i ushqejnë foshnjat me qumësht të nënës, ato do të kenë vdekshmëri 8 deri 10 më të vogël nga infeksionet respiratore ose nga barkqitjet.

Në rast se, sipas studimeve më bashkëkohore të botuara në revistat eminentë botërore, shkalla e inteligjencës së fëmijëve të ushqyer dy vjet me gjii të nënës është më optimalja, në rast se janë konstatuar shkallë të ulura të karcenomit të gjirit dhe të

vezoreve, shkallë e ulët e karriesit të fëmijëve, deformitetit të nofullave etj. etj. jam i bindur se këto nëna do të orientohen për ushqimin e fëmijës nëpërmjet qumështit të tyre dhe dhënies së gjirit e jo të heqin dorë shpejt nga kjo mënyrë shumë e natyrshme e të të ushqyerit.

Natyrisht, ky projektligj nuk ka arritur në të gjitha aspektet t'i adresojë këto nevoja, posaçërisht ndihet mungesë e madhe, e përmenden edhe parafolësit se ka të bëjë me obligimet më të qarta ligjore për institucionet ku punojnë nënat. Nuk ka asnjë dispozitë ligjore e cila i obligon institucionin qartë, se duhet t'ia mundësojë nënës realizimin e kësaj së drejte dhe atë jo vetëm nënës, por në mënyrë indirekte edhe foshnjës së saj që të realizojë këtë të drejtë, e cila ka një bazë të madhe shkencore. Po ashtu një mangësi serioze është edhe në pjesën financiare e cila me siguri duhet ripunohet dhe mjetet financiare të nevojshme për mbështetjen e zbatimit të këtij ligji janë shumë të ulëta dhe nuk janë në relacion me rëndësinë e lëmit të cilin ky projektligj e rregullon. Ne do të japim kontributin tonë në procedurat e mëtutjeshme parlamentare dhe shpresojmë që në fund do ta kemi dokumentin ligjor specifik dhe unik, por shumë relevant dhe në pajtueshmëri me veçoritë kulturore të popullatës tonë. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori

**DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI** – I nderuari z. kryetar, kryeministër e zëvendës ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Do të jem shumë i shkurtër në paraqitjen time, meqë u tha nga kolegët diçka edhe më tepër. Unë nuk e vë në dyshim rëndësinë e të ushqyerit të fëmijës me qumështin e gjirit të nënës, kur do të mbajë rezervën time në dy aspekte: aspekti i parë ka të bëjë me atë se sa përmbajtje e vet këtij Projektligji është në harmoni me emërtimin e Ligjit, mendoj se këtu duhet shikuar shumë, për të përmbajtjesor dhe për të begatuar; aspekti i dytë ka të bëjë se ky Projektligj kështu si është parapa sa është në harmoni me infrastrukturën ligjore tjetër që del nga marrëdhënia e punës dhe që do të mundësonte që vërtet nëna të ketë kushte më të mira për të gjetur kohë për ta ushqyer fëmijën me qumështin e vet dhe për të pasur një fëmijë të shëndosh. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi

**DEPUTETJA NEKIBE KELMNEDI** - Ju faleminderit z. kryetar. Unë deri më tash i dëgjova opinionet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, por t'ju them të vërtetën nuk e kam të qartë qëndrimin e tyre të fundit. Jam që ky ligj të miratohet në lexim të parë, por jam edhe për atë që ky Ligj të mos miratohet në lexim të parë, por t'i bashkëngjitet ndonjë ligj tjetër nga fusha e shëndetësisë, si për shembull Ligjit për mbrojtje dhe sigurim shëndetësor, mbrojtja shëndetësore dhe sigurimi shëndetësor, kështu që jam në dilemë ta votoj ligjin apo të votoj që ky ligj të tërhiqet dhe të vendoset që t'i bashkëngjitet ndonjë ligj tjetër. Edhe Komisioni Shëndetësor nuk është decidiv, nëse këtë e konsideron si ligj apo akt nënligjor apo nëse ky dokument duhet të jetë pjesë përbërëse e ndonjë ligji tjetër.

Sa për titullin e ligjit, të them të vërtetën ky titull është tepër i gjatë, promovimi nuk e ka vendin, sepse me ligjin nuk promovohen gjërat pozitive, por ato promovohen nëpërmjet konferencave të ndryshme shkencore, simpoziumeve, seminareve, motrat e



patronazhit kur shkojnë për t'i vizituar lehonat e tjera, kurse të ushqyerit nga gjiri, qumështit i gjirit të nënës, nuk e ka vendin në titull, por duhet nga qumështi i nënës se prej krijesave njerëzore qumësht prodhon vetëm nëna, kurse krijesat e tjera jonjerëzore apo shtazore ka që prodhojnë. Mirëpo tash e kemi fjalën për njerëzit, për fëmijët dhe duhet të ndryshohet titulli, të bëhet për ushqimin me qumësht të nënës. Në parim jam që ky ligj të mos miratohet në këtë formë si projektligj, por t'i kthehet Qeverisë dhe ta inkorporojë në ndonjë ligj që e mbulon fushën e shëndetësisë. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti

**DEPUTETI SABRI HAMITI** – Ju faleminderit për fjalën. Unë këtu nuk mund të shtoj asgjë faktikisht, sepse idetë që i pata, i tha Nekibja. Nuk është çudi që ne edhe ashtu biseduam rreth këtij problemi. Çështja themelore sa dëgjova me vëmendje çka u tha këtu është, të gjitha grupet janë në një farë dytësie, të gjithë e pranojnë materien si të domosdoshme, por të gjithë hedhin dyshimin a duhet të jetë ky ligj apo akt nënligjor? Meqë neve na është propozuar me rregulla si ligj, ne do të veprojmë si me çdo projektligj dhe ne duhet të vendosim po si për projektligj apo jo. Këtu le të vendosë Parlamenti. Ne si grup mendojmë që duhet të kalohet me votime, sipas Parlamentit. Kaq

**KRYEETARI KOLË BERISHA** - Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj

**DEPUTETJA NURISHAHE HULAJ** – Ju faleminderit! Unë nuk pata ndërmend ta marr fjalën, por në bazë të diskutimeve që u paraqitën për këtë projektligj shumë të rëndësishëm, do të kontribuoj me disa arsyeshmëri. Meqenëse grupacioni i nënave dhe i fëmijëve është grupacioni më sensitiv në Kosovë dhe duke u bazuar në të dhënat kërkimore-shkencore, në të dhënat me të cilat ne kemi punuar prej periudhës së pasluftës për nënat në Kosovë, duke u bazuar në indikatorë të mortalitetit të lartë të foshnjave në Kosovë, diku 35 promil vdekshmëria e foshnjave është në 1000 lindje gjallë dhe duke u bazuar në indikatorët shkencorë se grupacioni i nënave përbën diku 26 deri 28% të të periudhës riprodhueses në strukturën e popullatës së Kosovës, duke u bazuar në indikatorin se gjidhënia është diku 12.2%, është në nivel shumë të ulët dhe duke u bazuar në indikatorët se ka nëna të reja në Kosovë, është ligji shumë i arsyeshëm, sepse është ligj shumë specifik që i kontribuon dhe ndërlihet edhe me Ligjin për ndërprerjen e shtatzënësisë edhe me Ligjin për shëndetin riprodhues, do të thotë e ka rëndësinë e vet të veçantë dhe arsyeshmeria në baza shkencore është shumë e fuqishme. Në këtë drejtim Organizata Botërore e Shëndetësisë ka punuar shumë. Tani, nëpër spitalet rajonale nënat nuk i kanë foshnjat të ndara, por duke u bazuar në rregulloret nga ana e Organizatës Botërore të Shëndetësisë foshnja është pranë nënës pa ndërprerje dhe me dëshirën e saj dhe me dëshirën e foshnjës që e ka pranë, ajo në mënyrë permanente i jep gjë foshnjës dhe kjo ka ndikuar për periudhën pesëvjeçare që të zvogëlohet morbiditeti i foshnjave. Është një indikator shumë i rëndësishëm për këtë edhe është arsye pse është ky ligj duhet të ketë përkrahje në punën e Komisionit që të amendamentohet më mirë dhe të futen të gjitha elementet esenciale për promovimin e gjidhënicës, sepse promovimi është një metodë edukativo-shëndetësore shumë e rëndësishme që duhet të inkorporohet nëpër qendrat kryesore të mjekësisë familjare, ku do të punojë personaliteti shëndetësor në këtë drejtim dhe nuk rregullohet për një vit, për dy vjet, por kjo do të ketë një qasje për një

program afatgjatë që ka bazën e politikës shëndetësore dhe në strategjinë shëndetësore të Kosovës. Ligji është shumë i arsyeshëm, por kërkon edhe një punë më të lartë përmes Komisionit që do të marrë formën e vet të fundit. Edhe një indikator tjetër shumë i rëndësishëm në të dhënat bazë, të cilat ne i kemi të dokumentuara në Kosovë: rreth 46 deri 50% e morbiditetit të foshnjave një deri në katër vjeç është 46 deri 50% është morbiditeti nga diaretë një deri në 4 vjeç, prandaj është një indikator që ka shtyrë të bëhet ky ligj dhe është një indikator që e shtyn të bëhet promovimi për gjidhënie nëpër qendrat e mjekësisë familjare, prandaj mendoj se duhet të përkrahet në parim që do t'i lejojmë qasje të mëtutjeshme për punë të vazhdueshme. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri

**DEPUTETJA TEUTA HADRI** – Ju faleminderit z kryetar. Unë këtu desha vetëm ta bëj një sqarim se u tërhoqa nga fjala që e kërkoja më parë, duke parë se deputetët e Parlamentit thanë shumë fjalë dhe vërejtjet e tyre ishin shumë të arsyeshme rreth këtij ligji që sot paraqitet në Kuvendin e Kosovës. Desha ta mbështes edhe zonjën Nekibe se, ne me të vërtetë sot u paraqitën dy mëdyshje, sa i përket Komisionit a është recidiv. Komisioni ka qenë decidiv dhe të gjitha deputetet anëtare të Komisionit e kini pranuar që sot të dalim me një kundërshtim ndaj këtij ligji. Ne duhem ta tregojmë edhe arsyeshmërinë pse ta kundërshtojmë këtë ligj. Jemi bazuar aty se buxheti i Kosovës nuk përmban distribuimin e mirë të mjeteve për shëndetësi dhe ky ligj nuk ka qenë aq prioritar për shëndetësi. T'i jepen 47.500 € dhe të anashkalohen projektligjet apo ligjet e tjera, siç ka qenë ai i emergjencës, siç e thanë kolegët të mos të diskutojmë për të gjitha ato ligje që Ministria e Shëndetësisë nuk po i miraton, prandaj ne sot, mendoj se të gjithë anëtarët e Komisionit, ndoshta nuk e betë sqarimin mirë, por ne kemi qenë kundër miratimit në lexim të parë të këtij ligji, se ky ligj dua t'i njoftojë edhe deputetët se unë jam në Klinikën Gjinckologjike, ligji i miratuar që katër vjet po zbatohet nga personeli shëndetësor i Neonatologjisë ku çdo nënë jona që nga momenti i lindjes së foshnjës e merr fëmijën në gjirin e vet dhe i jep gjii, njëherësh e kemi edhe traditë se nanat tona lindin disa fëmije, kështu që ky buxhet prej 47.000 € më mirë kishte qenë që t'i ndihmohet neonatologjisë me pompat infuzive ku fëmijët do ta kenë të mbrojtur jetën me mjetet sanitare që janë aq të rëndësishme, me ultrazë. Edhe desha t'ia kujtoj Qeverisë së Kosovës se qyteti i Gjilanit me 250.000 banorë ka vetëm një respirator për të mbrojtur jetën e foshnjave, kështu që më mirë ky buxhet do të ishte të drejtohet atje. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Alush Gashi

**DEPUTETI ALUSH GASHI** - I nderuari z. kryetar. Për të evituar dy kuptimsinë, qëndrimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës është ai i cili u dha ngjashëm me profesor Sabri Hamitin. Ne e kemi pranuar në rend të ditës në lexim të parë, ne e kemi shqyrtuar në Grup si lexim të parë dhe ne do t'i japim mbështetjen në parim si lexim të parë. Ju faleminderit

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit profesor Nafije, replikë, a po?

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA – Unë veç desha t'i informoj deputetët se në takimin e fundit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në të cilin nuk ka qenë, ka munguar z. Teuta, kemi diskutuar mjaft mirë këtë çështje dhe ka qenë vendim i Komisionit që ky projektligj të shkojë në aprovim në leximin e parë. Janë paraqitur mangësi të cilat edhe ne në të ardhmen si Komision do të punojmë dhe do ta japim kontributin dhe do t'i kemi parasysht të gjitha vërejtjet e deputetëve që janë dhënë. Mirëpo, Komisioni nuk ka marrë vendim që ky projektligj të kthehet, sepse zonja Teutë, është mbajtur edhe të mërkurën një mbledhje, ku ju nuk keni qenë atë ditë e pranishme. Gjithashtu unë mjaft qartë e paraqita qëndrimin e Grupit Parlamentar dhe i dhashë arsyet pse Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka doktoresha Hundozi

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI - Po edhe unë desha t'ia përkujtoja Teutës se dje e mbajtëm një mbledhje të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale edhe në kundërshtim me krejt dilemat që i patëm në Komision, por edhe sot këtu në Parlament, vendosëm për shkak të rëndësisë së materies që shtjellon ky projektligj, që sot ta miratojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Replikë Teuta Hadri, vetëm një minutë e keni

DEPUTETJA TEUTA HADRI – Kryetarit të Komisionit i kam lajmëruar se kam qenë kujdestare në Klinikë dhe kam pasur dëshirë shumë të madhe të merrja pjesë, se e kemi lënë me të gjitha koleget që së bashku, se nuk kemi pasur qëllime që sot ta kundërshtojmë dhe kam pyetur edhe zonja Zylfije para gjysmë ore i thashë: Të gjitha jemi për atë mendim që kemi qenë herën e parë. Unë nuk di sot që e kanë ndërruar brenda katër apo pesë orësh Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të këtij projektligji

Votojmë tash:

Për .....	61 votë
Kundër .....	9

Kalon ligji

Sipas rregullës 23, pika.... dhe rregullës 35, pika 2, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si komision funksional dhe referues.
2. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Komizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisioni për Komunitete

Në radhë është shqyrtimi i parë i Projektligjit për hulumtimet gjeologjike. Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 3 maj të vitit 2006 dhe janë përmbushur të gjitha kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'u adresohen për shqyrtim Komisionit funksional, përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet ministri Et'hem Çeku, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin

MINISTRI ET'HEM ÇEKU –I nderuari z. kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë ministra

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Qeverisë t'ia paraqes për miratim Kuvendit të Kosovës Projektligjin për hulumtimet gjeologjike. Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e minierave.

Njohuria për përbërjen e tokës dhe kuptimi i proceseve gjeologjike është bazë për zhvillimin dhe menaxhimin e suksesshëm të vendit.

Proceset gjeologjike dhe përbërja gjeologjike e vendit tonë ndikon drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të Kosovës dhe atë nëpërmjet nevojës për zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve, të burimeve energjetike dhe të burimeve të tjera.

Në këtë mes paraqitet edhe nevoja e njohjes së proceseve gjeologjike, të atyre natyrore ose të ndikuara nga veprimtaria njerëzore, të cilat mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve tanë në rastet të rrëshqitjeve të dheut, të kontaminimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe gjeo-rreziqeve të tjera si erozioni i sipërfaqeve, tërmetet, vërshimet etj.

Kosova më parë apo asnjëherë nuk ka pasur shërbim gjeologjik. Të gjitha trajtimet e hulumtimit janë bërë jashtë vendit apo në institucionet jugosllave, ose në qendrat e ndryshme si: Beogradi, Zagreb, Shkup edhe tani ato qendra i kanë dhe i mbajnë të gjitha informacionet të pasurive tona minerale. Niveli i hulumtimeve të gjertanishme nuk është i mjaftueshëm për të dhënë mendimin përfundimtar për potencialin e pasurive minerale të vendit.

Prandaj, është e domosdoshme që Kosova të krijojë institucione dhe mekanizma të nevojshëm, që në mënyrë profesionale do të bëjnë hulumtimin dhe vlerësimin e potencialeve të saj natyrore.

Me Ministrinë e Energjetikës dhe të Minierave, me themelimin e Agjencisë Gjeologjike të Kosovës dhe të Zyrës së Rregullatorit të Minierave, do të kompletohet struktura institucionale për këtë sektor, si dhe do të qartësohen roli dhe përgjegjësitë e institucioneve vendore edhe pas statusit përfundimtar të Kosovës.

Personeli profesional i përgatitur deri me tani nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale i UNMIK-ut dhe nga Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, do ta përbëjnë thelbin e Agjencisë Gjeologjike të Kosovës.

Me këtë personel dhe me punët e kryera deri më tani do të sigurohen rezultate të shpejta dhe cilësore, të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit nga potenciali mineral.

Ky projektligj përcakton parimet themelore të cilat rregullojnë:

- themelimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Gjeologjike të Kosovës sipas normave evropiane që ofron këshilla të paanshme gjeo-shkencore, të sigurtat dhe informata për partnerë të shumtë, ku përfshihen Qeveria, industria dhe opinionin publik
- Mënyrën, kushtet për kryerjen dhe mbikëqyrjen e hulumtimeve gjeologjike në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe me standardet e pranura mjedisore dhe të sigurisë në punë,
- Rregullon, mbledh analizat dhe përpunon të dhënat gjeologjike si dhe kryen punë profesionale që lidhen me zbulimin dhe raportimin e rezultateve të hulumtimeve gjeologjike të lëndëve të para minerale,
- Monitorimin dhe paralajmërimin e gjeo-rreziqeve dhe marrjen e masave adekuate për minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga gjeo-rreziqet eventuale;
- Nxitjen e përdorimit të teknologjive moderne për kryerjen e hulumtimeve gjeologjike, me synim zbulimi dhe vlerësimin e pasurive minerale të Kosovës.
- Financimin, programimin dhe organizimin e hulumtimeve gjeologjike me interes për Kosovën, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore, si dhe nxitjen dhe zhvillimin e shfrytëzimit optimal të burimeve minerare në Kosovë.

Konceptin e Projektligjit e përshkon parimi i transparencës dhe i jo-diskriminimit, i konkurrencës dhe i shfrytëzimit racional të resurseve minerare në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

#### **Të nderuar deputetë,**

Përmbajtja normative e Projektligjit për hulumtime gjeologjike të Kosovës është sistemuar në 6 kapituj, që paraqesin një tërësi koherente normative, me qëllim të pasqyrimin adekuat të tërë kompozicionit të ligjit dhe qasjes më të lehtë në përmbajtjen e tij, duke respektuar parimet themelore të metodologjisë legislative dhe të teknikës juridike për hartimin e ligjit. Pra, nuk dua të lëshohem në shpjegime dhe detaje të tjera për arsyeshmërinë dhe nevojën e rregullimit ligjor të kësaj fushe, por ju propozoj që pas procedurave të shqyrtimit, ky projektligj të miratohet nga Kuvendi i Kosovës dhe t'i

hapet rruga fuqizimit të tij, gjë që do të jetë në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e minierave, e po ashtu ,do të jetë në funksion edhe të zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të vendit tonë. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit z. ministër. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës fjalën e ka deputeti Ibush Jonzi

**DEPUTETI IBUSH JONUZI** - Ju faleminderit z. kryetar, ministra, deputetë të nderuar dhe të gjithë të pranishëm.

Sot e kemi në shqyrtim të parë Projektligjin për hulumtimet gjeologjike. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ta paraqes projektligjin në fjalë. Kosova ka pasuri të mëdha nëntokësore dhe sipërfaqësore, metale, jometale dhe minerale. Ne të gjithë e dimë që kemi rezerva të mëdha të këtyre resurseve, por nuk e dimë sa janë ato, prandaj duhet të verifikohen nëpërmjet hulumtimeve gjeologjike. Hulumtimet e tilla gjithsesi duhet ta kenë bazën e duhur ligjore në përputhje me ligjet e BE-së. Ky projektligj ka shumë rëndësi, sepse rregullon çështjen e këtyre hulumtimeve dhe se fuqizimi i tyre vërtet i hap rrugë zhvillimit të Kosovës. Siç e thashë edhe më lart janë shumë të nevojshme hulumtimet gjeologjike për të cilat duhet ta shfrytëzojmë gjithë potencialin shkencor, profesional dhe atë material që të mund t'i arrijmë rezultatet e duhura në hulumtime. Këto hulumtime te ne kanë mbetur prapa, sepse prej viteve 90 në këtë drejtim nuk është punuar. Ndoshta është bërë pak te hulumtimet e linjtit, e të qymyreve të llojeve të tjera, por pasqyrimi i gjendjes gjeologjiko-strukturale teknike nuk është kryer dhe është shumë e nevojshme që sipas etapave të zhvillimit të bëhen hulumtime shtesë që të konstatohen: kontura reale të basenit, rezervat bilancore, rezervat jobilancore, rezervat eksportabile të shfrytëzuara, verifikimi i cilësisë, vlerësimi ekonomik, ndikimi në mjedis i punëve minerare në të ardhmen. Edhe një herë po e përsëris se Kosova ka rezerva të shumta që duhet të hulumtohen dhe të verifikohen me kujdes. Miratimi i këtij projektligji siguron bazë të mirëfilltë ligjore në fushën e gjeologjisë. Ky qëllim synohet të arrihet me anë të promovimit dhe të sanksionimit të standardeve të pranura ndërkombëtare, me qëllim inkurajimi të sektorit privat dhe të nxitjes së investimeve të huaja në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Në janar të këtij viti është miratuar Projektligji për miniera e minerale, por ky ligj do të ishte i mangët pa miratimin e ligjeve për hulumtimet gjeologjike, sepse fillimit të punimeve minerale duhet t'i paraprijnë hulumtimet gjeologjike. Kjo është abc-ja e kësaj fushe. Meqë Kosova është vend me pasuri të mëdha natyrore, shumë firma të njohura ndërkombëtare kanë treguar interesim për të investuar në fushën e hulumtimeve gjeologjike. Pas hulumtimeve dhe verifikimit të rezervave vjen faza e përgatitjeve për shfrytëzim. Kështu kjo fushë mundëson krijimin e një baze të mirë materiale, si dhe hapjen e vendeve të reja të punës për shumë profile teknike, ekonomike etj. Projektligji ka edhe mangësi që shkurt do t'i potencoj disa. Neni 3 duhet të definohet zona e lejuar për hulumtime dhe nuk duhet të mbulojë një zonë, e cila është objekt për një leje tjetër të hulumtimit, apo të kërkimit. Neni 5, hulumtimet gjeologjike themelore, pika 5.1 nën (th) bëhet fjalë për përpilimin e hartave gjeologjike. Duhet të potencohet se janë të nevojshme edhe hartat ,p.sh. hartat inxhinierike, metilo-gjenike dhe hidro-gjeologjike. Neni 9. pika 9 nën (th) të korrigohet. Neni 13. pika 2, ku bëhet fjalë të sigurohen

shpime nëse zbulohet uji nëntokësor, i cili nuk do të shfrytëzohet menjëherë, por nëse duhet të jetë: të bëhet edhe ruajtja e tërësishme e ... ..mbajtës nëntokësor dhe për hulumtim të tillë të jepet leje e veçantë për institucionet e specializuara, në mënyrë që të mos priset ..... ujëmbajtës nga kompanitë e ndryshme e specializuara të shpimit Po ashtu nenit 13 duhet t'i shtohet edhe kjo pjesë gjatë fazës së hulumtimit nëse haset në indikacione për konstatimin se ka elemente radioaktive, duhet të paraqitet menjëherë tek inspektori përgjegjës për shkak të specifikës dhe të rëndësisë që kanë këto elemente. Nxjerrja apo marrja e mostrave minerare nuk bën të përdoren për çështjet komerciale, por vetëm për studime. Sipas deklaratës financiare të lëshuar nga Ministria për Buxhet dhe Financa, del se Projektligji ka implikime buxhetore në shumë prej 605.551.98 € për vitet 2006-2008 ,sidomos pasi me nenin 7 të Projektligjit parashihet të formohet Agjencia Gjeologjike e Kosovës, për të cilën Komisioni Parlamentar ka rezervat e veta. Ne në Komision me kujdes do ta shqyrtojmë këtë çështje në fazën e amendamentimit në parim, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Projektligjin për hulumtime gjeologjike. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERIHA** - Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së fjalën e ka deputetja Sala Berisha- Shala

**DEPUTETJA SALA BERISHA SHALA** - I nderuari z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, anëtarë të Qeverisë

Kosova posedon pasuri të lakmueshme të mineraleve të dobishme që do të garantonin zhvillim ekonomik. Në qoftë se do të bëhej një hulumtim gjeologjik detal i këtyre pasurive për të vazhduar më tutje të bëhet strategji për shfrytëzimin racional të tyre. Projektligji për hulumtime gjeologjike ka qenë dashur të hartohet më parë , d.m.th. para se të vinte në Parlament Projektligji për minierat dhe mineralet,duke e ditur se gjeologjia është ajo që i paraprin xehetarisë, përkatësisht minierave. Pavarësisht nga dobësitë që e përcjellin Projektligjin në fjalë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ne e mbështesim në parim , duke shpresuar se do të eliminohen dobësitë gjatë amendamentimit. Unë .të mos i përsëris ato që i tha parafolësi im, kryesisht do të fokusohem në kreun e tretë, ku bëhet fjalë për formimin e Agjencisë Gjeologjike të Kosovës dhe mendoj se këtu duhet pasur qasje krejt tjetër. Të nderuar deputetë, formimi i agjencive nëpër ministri është bërë një lloj sindromi pakuptimit, andaj kemi në dorë ne si ligjdhënës t'ua ndalim hovin garave të ministrive e të ministrave,se cila prej tyre do të krijojë më shumë agjenci në kuadër të tyre, në përpjekje që t'ia përshtatin ligjet vetvetes duke menduar se ato karrige... ministrore i kanë me tapi. Ne mendojmë se, kur është fjala tek agjencia këtu e kemi një ndryshim të vogël, por që është shumë përmbajtjesor, në vend të shprehjes agjenci mendoj se duhet të jetë shërbim. Mendoj se duhet të jetë: Shërbimi Gjeologjik i Kosovës ,në nivel Qeverie, për këto arsye: gjeologjia apo gjeo-shkenca është diçka më e gjerë sesa një ministri cilado qoftë ajo. Andaj për t'u ikur monopolizimit dhe konflikteve e interesave ,Shërbimi Gjeologjik i Kosovës duhet të jetë në nivel të Qeverisë e jo në kuadër të ministrisë. Qëllimi kryesor i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është që të sigurojë informacionin të shpejtë dhe përkatës shkencor që është në gjendje të ndeshet me nevojat aktuale dhe me perspektivat e vendit. Roli i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është këshillues për

Qeverinë. Me hartimin e strategjive të ndryshme ekonomike që kanë të bëjnë me mineralet. Nën një, nisur nga rëndësia e shërbimeve gjeologjike që janë në shumicën e rasteve më se 70% në Evropë janë institucione shtetërore me peshë të veçantë, jo vetëm për gjeologjinë e një vendi, ngase gjeologjia është multidisiplinare, kështu që shërbimi gjeologjik në nivel qeverie krijon mundësinë e posaçme reale për realizimin e bashkëpunimit të suksesshëm ndërkombëtar. Ky nivel është në pajtim me pozitën e shumicës së shërbimeve gjeologjike në Evropë, d.m.th. mbi 70% të tyre kanë nivel qeverie, diku janë edhe si institucione të pavarura. Nën dy, me ndërrimin e këtij niveli d.m.th. nga Ministria e Energjetikës e të Minierave të kalohet në nivel qeverie, do të realizohen këto synime: fuqizimi i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, përkatësisht roli i pasurive minerale si garanci për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Nën dy është edhe pavarësimi në aspektin financiar, profesional dhe realizimi i politikave programore. Mandej desha t'ua përkujtoja atyre që e kanë ditur dhe t'i njoftoj ata që nuk e kanë ditur se në lidhje me Shërbimin Gjeologjik të Kosovës ekziston një material i ashtuquajtur Këshill për formimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës të përpiluar nga Shërbimi Gjeologjik Britanik, i cili është fitues i tenderit të shpallur nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Ky material në mënyrë detale përshkruan rëndësinë e Shërbimit Gjeologjik për vendet dhe mënyrat e funksionimit të tyre në vendet e Evropës. Aty jepen edhe rekomandimet, detyrat e një Shërbimi Gjeologjik të Kosovës, grafiku i statusit të shërbimeve gjeologjike në Evropë, si dhe marrëdhëniet e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës në raport me faktorët e tjerë relevantë nëse do të ishte shërbim gjeologjik i pavarur ose që i raporton Qeverisë, d.m.th. kjo sipas Shërbimit Gjeologjik Britanik, i cili e ka fituar tenderin, e ka financuar Buxheti i konsoliduar i Kosovës. Kosovës, i duhet një shërbim gjeologjik funksional. Detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit Gjeologjik aktualisht janë ndërmarrë atë sa kishte mundësi nga disa institucione kryesisht nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ish-Drejtoria e Minierave dhe Mineraleve, një pjesë nga Ministria e Energjetikës dhe Minierave, një pjesë nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Raporti i Shërbimit Gjeologjik Britanik parasheh themelimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës si rezultat i shqyrtimit të ekipit të projektit të Shërbimit Gjeologjik Britanik fuqishëm rekomandon krijimin e një shërbimi gjeologjik të pavarur dhe transparent të Kosovës të modeluar sipas normave evropiane dhe duke pasur misionet si në vijim: për të ofruar këshilla të paanshme gjeo- shkencore dhe të cilësisë të sigurt dhe informatat për partnerët të shumët, ku përfshihen Qeveria, opinioni publik dhe industria. Prandaj, për të mos ju marrë më shumë kohë, mendoj që duhet mbështetet. Shpresoj se e kam edhe përkrahjen e Komisionit funksional, i cili është i obliguar që ta përmirësojë dhe ta bjerë në nivelin e duhur Projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

**KRYETARI KOLË BERISHA** – Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj

**DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ** - I respektuar kryetar i Kuvendit, të respektuar ministra, kolegë deputetë

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës Projektligjin për hulumtime gjeologjike me vëmendje e shqyrtoi edhe parafolësit theksuan se nevoja për këtë ligj është e rëndësishme së veçantë, sepse Kosova ka pasuri të mëdha meqë duhen të hulumtohen.



Hartuesi i Projektligjit e ka akorduar punën me institucionet profesionale të brendshme dhe të jashtme dhe ka nxjerrë para nesh një Projektligj mjaft cilësor, i cili determinon saktë të gjitha veprimet e nevojshme në fushën e hulumtimeve gjeologjike në Kosovë. Projektligji materien ligjore e sistemon në mënyrën e duhur dhe i zbërthen nënën me një kujdes të veçantë për t'i bërë ato më të zbatueshme. Nuk le konfuzitet apo më mirë të themi dilema të rastit në përdorim të Projektligjit. Gjithashtu është i avancuar edhe gjuhësisht, por megjithatë ka mundësi që me disa vende të ketë shprehje dhe terma më adekuatë si për shembull në vend të shprehjes programim, siç është në kontekst, përdoret fjala planifikim ose shprehja themelore të zëvendësohet me atë bazike. Mirëpo, unë do të ndalem më tepër dhe Grupi Parlamentar i Aleancës rreth formimit të agjencisë për të cilën është duke u folur mjaft. Ne e dimë se ka implikime buxhetore që janë mbi 600.000 E dhe të parapara për vitin 2006, 5.000, për vitin 2007 diku 300.000 dhe 2008 po në të njëjtën shumë, mirëpo ne kemi punuar dhe disa ministri kanë punuar edhe agjencitë më me pak rëndësi sesa kjo agjenci që me të vërtetë duhet të bëjë një punë mjaft të madhe dhe një hulumtim të gjerë në fushën gjeologjike. Kështu Grupi Parlamentar përshëndet formimin e agjencisë, sepse ka rëndësi të madhe për arsye të hulumtimeve të mëdha gjeologjike që do të bëhen në territorin e Kosovës. Edhe nga parafolësit u tha se ashtu -kështu dhe pa agjenci ka pasur implikime buxhetore, sepse është fituar tenderi nga Instituti Britanik që ka marrë miliona të tëra euro nga Buxheti i Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Minierave, i cili i ka harxhuar më tepër sesa është planifikuar dhe se kostoja e buxhetit. Prandaj, agjencia a do të quhet agjenci, a do t'ia ndërrojmë një emër tjetër, me rëndësi është që diçka duhet të funksionojë dhe duhet që të menaxhojë në lidhje me hulumtimet gjeologjike, sepse është mjaft me rëndësi për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar ORA z. Genc Gorani

DEPUTETI GENC GORANI - Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar z. kryeministër, ministra të nderuar kolegë

Projektligji për hulumtimet gjeologjike është një projektligj fundamental. Me siguri i mirëpritur nga profesionistët, të cilët e dinë rëndësinë e fushëveprimit siç është gjeologjia. Nuk do të kisha hyrë në detaje, të cilat janë përmendur, por kisha folur vetëm për dy ose tri shqetësime në nivel parimor. Parimi i parë, do të thotë shqetësimi i parë është mënyra se si projektohet buxheti. Paramendohet se aktivitetet që parashihen me këtë projektligj, pra me këtë ligj, ku besoj se edhe do të kalojë. Buxheti i paraparë për këtë faktikisht nuk është i miratuar, ngase për vitet 2006, 2007 dhe 2008 nuk e parashohin këtë harxhim. Mund të arsyetohet aspekti i buxhetit 2006, sepse proporcionalisht është relativisht buxhet i vogël, mirëpo për 2007 dhe 2008 nuk mund të thuhet që sot se buxheti do të na mjaftojë për përmbushjen e aktivitetit, për përkrahjen e aktivitetit të paraparë me këtë projektligj. Patjetër, duhet para këtij Kuvendi, para këtij Komisioni funksional përkatës të shpjegohet dhe të tregohet më saktësisht kur do të nxirret kjo dhe si do të evitohet eventualisht të hyhet në konflikt buxhetor, siç ndodh shpesh nga agjencitë shpenzuese. Në këtë aspekt do të kishte qenë ndoshta shumë më tepër e udhës të krijohej në nivel të Departamentit një grup pune fillimisht i cili do të punonte në hartimin e një plani punues dhe i cili do ta kishte arsyetuar plotësisht

alokimin shtesë buxhetor, ndoshta edhe më të madh se ky, sepse është shumë lehtë të paramendohet se kjo agjenci do të lironte tepër të hyra ose të kursejë harxhimet siç u përmendën, sesa që është buxheti i alokuar këtu. Numri i personave që mendohet që të punësohen në këtë agjenci 21 në vitin 2007 dhe 2008 faktikisht 2008 është relativisht i lartë, atëherë rrjedhimisht paramendohet se do të ketë aktivitet mjaft të rëndësishëm, mirëpo ky aktivitet nuk është i pasqyruar këtu. Në kuadër të Komisionit do të kisha mirëpritur një informacion shumë më të saktë edhe më të zgjeruar nga Ministria që do të na tregojë arsyeshmërinë e aktivitetit të paraparë nga kjo agjenci. Një aspekt i fundit do të ishte çështja e inspektoratit. Ekzistojnë disa inspektorate të cilat faktikisht do të kishin mundur ta mbulonin këtë sferë që parashihet me hulumtime gjeologjike. Nëse çështja është më tepër te konflikti i kompetencave, nëse kemi inspektorë të cilët potencialisht do të mund ta mbulonin inspektimin e këtyre fushave, ekziston një potencial, një mundësi që në rast të konflikteve të interesave ose në rast të moskryerjes të detyrave, atëherë inspektoratet e ndryshme do t'ia qesin fajin njëra tjetrës, për këtë arsye besoj se për të kursyer nga aspekti buxhetor edhe për t' u ikur këtyre mundësive të kompetencave , është shumë më mirë që projektligji, praktikisht ligji përfundimtar të qartësohet se në kompetencat e kujt është, si dhe në kompetencat e kujt nuk ishte dashur të ishte inspeksioni në aspekt të hulumtimeve gjeologjike. Unë besoj se formimi i agjencive ,në përgjithësi, nuk është mënyra më e mirë dhe punësimi faktikisht formimi i agjencive profesionale , nuk e kanë vendin në kuadër të ministrive. Shumë më tepër se do të ishte funksionale edhe në pajtim me standardet më të reja evropiane dhe të shteteve të zhvilluara që këto agjenci profesionale të jenë të krijuara në nivel të ministrive, që do të thotë të jenë të lidhura drejtpërdrejt me Qeverinë, të gjendet mekanizmi për formimin e këtyre agjencive në këtë mënyrë.

Vërejtje e fundit është, sa i përket deklaratës të Zyrës për Integritet Evropian. Kjo deklaratë thotë se ky projektligj nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga kjo zyre. Është për t' u çuditur se me gjithë këtë deklaratë e cila nuk është demantuar nga e njëjta zyre, Qeveria e miraton këtë ligj edhe nuk e merr parasysh edhe pse kjo zyre funksionon në kuadër të Zyrës së kryeministrit. Faktikisht Zyra e kryeministrit e injoron rekomandimin e një organi të cilin e ka formuar vetë. Dy konsekuenca janë prej kësaj së paku, e para, nesër me një evaluim të ligjeve ne po japim thjeshtë argumentin kryesor të një zyre për integritet evropian na thotë se ne nuk i respektojmë rekomandimet e tyre edhe pse deklarohemi se i kemi kryer për atë qëllim. Konsekuenca e dytë do të jetë për Qeverinë tjetër kur këto ligje do të deklarohen jo konform me standardet evropiane, ky Kuvend dhe të gjithë të tjerët do të duhet prej fillimit t' i hapin këto projektligje dhe t' i korrigjojmë e sipas të gjitha gjasave është fjala për do korrigjime teknike që do të kishin mund të bëhen që tani, që të mos lihen për më vonë për ato arsye që i tregova. Grupi Parlamentar ORA e përkrah këtë projektligj në parim. Besojmë se në punën e mëtutjeshme në Komision edhe në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse do të mund t' i bënim këto korrigjime dhe të avancojmë këtë ligj në nivel të duhur. Ju faleminderit!

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit z. deputet. Në emër të Grupit Parlamentar 6+ fjalën e ka deputeti Xhezair Murati

**DEPUTETI XHEZAIR MURATI** – Poštovani predsedavajući, gospodine premijeru, ministri i kolege

Nacrt zakona o Geološkoim istraživanja Kosova spada u red onih zakona koji treba da pdstaknu privredni razvoj Kosova i zato je izuzetan značaj što je on makar i sa zakašnjenjem došao na ovoj skupštinskoj raspravi. Po običaju memorandumu, predloženom memorandumu ima dosta grešaka i lektori će imati suguro dosta posla, no su tehnički propusti. Ja bih govorio, ovaj zakon pledira da sredi geološke aktivnosti i funkcionisanje na Kosovu i u tom slučaju veoma je bitno da moalo veću pažnju posveti odeljku racionalnog rešenja rudnih i mineralnih ogastava, iz toga mi u Grupi 6+ analizirajući ovaj Zakon došli smo do zaključaka da su nedovoljno precizne kaznene odredbe u poglavlju 5. član 21. zatim treba posvetiti mnogo veću pažnju inspekcijskom nadzoru koji sadrži četvrto poglavlje i ovaj, posebno, imamo primedbu kako je došlo do toga da zakonska, odnosno Pravna kancelarija UNMIK-a nije učestvovala u radu Radne grupe, koja je pripremila ovaj zakon a plediramo da on opravdava recimo i bude u skladu sa zakonodavstvom Evropske unije, možda nam treba takvo jedno objašnjenje pošto geologija, odnosno rudarstvo spadaju u red oablasti teške industrije. Veoma je bitno dalje pojasniti i ovaj. Uvesti novu regulativu koja će da sadrži malo detaljnije, recimo kako da zaštititi okolinu, kako zaštititi tlo, kako zaštititi vode i vazduh od zagađenja s obzirom, da upravo ova oblast sapada u one oblasti koje su potencijalni zagađivači okoline, odnosno na koji način otkloniti svaku mogućnost s obzirom da su i razvijen svet i razvijene ostale oblasti, kažem u Evropi, ogromnu pažnju poklanjaju upravo tim odredbama mi sigurno kasnimo u tome i nakon, mi znamo, recimo povećanu stopu oboljenja i ona koja se ne može rješiti tako dalje, s toga mi sugerišemo da se ovoj oblasti malo više povede pažnja. U celini računajući na to da će u daljoj proceduru ovaj zakon biti potpunjen, mi ga u načelu ipak podržavamo.

KRYESUESI - XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. deputet .Për fjalë është paraqitur deputeti Ilmi Ahmeti

DEPUTETI ILMI AHMETI – I nderuari kryesues, i nderuari kryeministër, ministra, deputetë të nderuar.

Unë do t'i them disa fjalë për Projektligjin të cilin po e shqyrtojmë sot dhe atë duke e përkrahur punën, në radhë të parë të ekspertëve që e kanë bërë këtë projektligj e ku pjesëmarrës kanë qenë 5 doktorë shkencash të gjeologjisë dhe një inxhinier. Prandaj unë konsideroj se duke pasur parasysh këtë përbërje nuk ka pse të mos përkrahët një projektligj për rëndësinë e të cilit besoj se pajtohemi të gjithë.

Në fillim kisha me thënë, lidhur me atë që tha z. Gorani se të gjitha vërejtjet e Zyrës për Integritet Evropiane janë të trajtuara dhe janë të tejkaluara. Për këtë le të lexohet në faqen 3, pjesa e parë, ku janë të përfshira të gjitha rekomandimet dhe janë bërë harmonizimet mes Zyrës për Integritet Evropiane dhe Zyrës së kryeministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, faqe 3. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji nevoja për të ka qenë e kahershme. Kosovës i ka munguar gjithmonë një ligj i tillë dhe në të kaluarën janë bërë hulumtime gjeologjike, të cilët i kanë bërë të tjerët dhe më shumë për interesa të tyre dhe tash në Kosovë mungojnë të dhënat e hulumtimeve gjeologjike që janë bërë gjer më tani. Prandaj, ky projektligj në mënyrën më të mirë përcakton parimet bazë lidhur me mënyrën dhe kushtet e hulumtimeve gjeologjike si financimi, organizimi, kontrollimi i hulumtimeve gjeologjike nga kushdo

që e kryen si nga kompanitë vendore, ashtu edhe ato të huaja që të drejtën për hulumtime e fitojnë në një konkurrencë të denjë për të gjithë pjesëmarrësit. Nëpërmjet këtij projektligji të hulumtime gjeologjike, Kosova synon ta arrijë përmes promovimit, sanksionimit të standardeve më bashkëkohore të pranura ndërkombtarisht, si dhe rregullimit të mbledhjes, menaxhimit, arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore për tërë territorin e Kosovës. Të gjitha këto janë të parapara në këtë projektligj. Ky projektligj mjaft mirë i rregullon llojet e hulumtimeve dhe metodat e hulumtimeve gjeologjike. Pjesa e projektligjit që ka të bëjë me kryerjen e punëve profesionale të hulumtimeve gjeologjike parasheh formimin e Agjencisë Gjeologjike të Kosovës si organ ekzekutiv profesional në kuadër të Ministrisë së Energjetikës dhe të Minierave. Në kuadër të kësaj ministrie sot ekziston një Komision për Miniera dhe Minerale e që kryen një pjesë të punëve rreth hulumtimeve gjeologjike, por nuk mund ta zëvendësojë Agjencinë Gjeologjike të Kosovës. Agjencisë në mënyrën më të mirë i janë përcaktuar punët dhe detyrat që nga përgatitja e programeve për hulumtime gjeologjike, mbledhja, arkivimi, përpilimi, përpunimi dhe mirëmbajtja e të dhënave gjeologjike deri te hulumtimet sizmike për të cilat, për dallim nga vendet e rajonit, Kosova as sot nuk e ka hartën sizmike. Projektligji rregullon edhe çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin teknik të projekteve për hulumtime gjeologjike si dhe detyrat e zbatuesit të projekteve deri te elaboratet, rezultatet deri te elaborati i rezultateve dhe ekspertiza e këtyre hulumtimeve, e që kryerësi i punimeve obligohet që një kopje të këtij elaborati t'ia dorëzojë Agjencisë Gjeologjike të Kosovës dhe një lëshuesit të lejes për hulumtime gjeologjike. Edhe pas kësaj kryerësi i hulumtimeve gjeologjike është i obliguar të ruajë mostrat dhe të evidentojë të gjitha mineralet qofshin ato shkëmb formuese apo xehe-formuese. Ky Kuvend kohë më parë ka miratuar Ligjin për minierat dhe për mineralet e që rregullon vetëm një pjesë të hulumtimeve gjeologjike dhe të inspeksionit të tyre e që do të duhet të ishin pjesë e këtij projektligji që po e shqyrtojmë sot, madje do të thosha Ligji për hulumtime gjeologjike do të duhej të miratohet para Ligjit për miniera dhe minerale dhe çështjet e hulumtimeve do të duhej t'i takonin këtij projektligji. Marrë në tërësi Projektligji për hulumtime gjeologjike është punuar mjaft mirë nga ekspertët e gjeologjisë. Disa lëshime të vogla që janë bërë kësaj besoj se janë lëshime shtypi si për shembull nuk thuhet lëndë minerare, sepse punimet janë minerare, ndërsa lëndët janë minerale. Duke pasur parasysh të gjitha këto çka u thanë, unë konsideroj se ky ligj meriton të miratohet në parim dhe të përkrahet. Ju faleminderit!

**KRYESUESI XHAVIT HALATI** - Ju faleminderit z. deputet. Për fjalë është paraqitur Behxhet Brajshori

Fjalën e ka për replikë Genci

**DEPUTETI GENC GORANI - REPLIKË** - Ju faleminderit z. kryesues, vetëm shkurt sa i përket deklaratës së Zyrës për integritet evropian. Natyrisht se e kam lexuar në faqen e tretë që Ministria deklaroi se këto pika i ka harmonizuar. Ajo që vlen nuk është deklarata e Ministrisë e kjo është abuzim. Është deklarata e Zyrës për Integritet Evropian e përfundimtare që thotë: "Po ka pasur probleme e janë zgjidhur", pra po e përsëris Zyra e para i ka ngritur problemet, Ministria i ka zgjidhur po supozoj, mirëpo ajo që është dhe që vlen është deklarata e fundit e Zyrës për integritet evropian që

shpresoj do të na e dërgon nëpërmjet Komisionit dhe atëherë zgjidhet problemi. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit!

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit z. Kryesues, i nderuari Kryeministër, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë

Unë mbështes nxjerrjen e këtij ligji dhe do të them se vërtet është në kohën e qëlluar, ndoshta pak edhe i vonuar për dy arsye kryesore: e para, ky Projektligj vërtet do të ndihmojë shumë që të përcaktohem qartë në prioritetet tona zhvillimore duke u bazuar në rezultatet që do të dilnin nga hulumtimet gjeologjike. Ne jemi tani në fazën e hartimit të strategjisë të zhvillimit ekonomik, strategjisë kombëtare, zhvillimit ekonomik dhe po të kishim mundësi ta shfrytëzojmë këtë ligj shumë gjëra do të ishin më të qarta, prandaj në këtë aspekt e mbështes fuqimisht dhe aspekti i dytë është: pavarësisht se parashihen shpenzimet e caktuara dhe implikimet të caktuara buxhetore, unë mendoj se duhet të shkohet me tutje, sepse ligji në një fazë të caktuar edhe do të krijoj të hyra buxhetore, që dot të bënin të mundshëm balancimin, do të thotë shpenzimet në të hyrat buxhetore dhe në këtë drejtim nuk do të na kushtonte shumë. Aq më tepër kur unë kam parasysh se të gjithë i kemi parasysh kufizimet buxhetore në një periudhë të caktuar dhe natyrisht do të kemi parasysh se nuk do të lejojmë që të kalohen limitet e caktuara buxhetore qoftë te kufirit tepër që mbulon Ministria, qoftë edhe numrit të punësuarve që ka brenda Ministrisë, sepse kemi rekomandime të caktuara të cilat në këtë drejtim do të na ndihmojnë. Prandaj, fuqishëm e mbështes dhe mendoj se do të jetë një ndihmë e madhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Brajshori. Për fjalë është paraqitur z. Bajrush Xhemajli

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit z. kryesues, përshëndetje, z. Kryeministër, ministra, kolegë deputetë

Me vet faktin që Kosova është e pasur me resurse të mëdha në këtë fushë, mendoj që nuk e shoh të arsyeshme të flas për rëndësinë e këtij ligji, edhe ashtu u tha nga nga parafolësit, u tha edhe për Agjencinë, që unë pajtohem e të tjera. Unë do të ndalem vetëm në dy çështje, që konsideroj që edhe pse u trajtuan, ka mbetur diçka të thuhet në këtë aspekt. Është çështja e deklaratës së pajtueshmërisë së Projektligjit me standardet ndërkombëtare dhe me deklaratën financiare. Po filloj prej deklaratës financiare. Sa i përket kësaj deklarate shihet qartë se 605.000 euro u tha edhe këtu që është një kosto shumë e lartë për një projektligj, në njërin anë dhe në anën tjetër mendoj se në zbatimin e ligjit nuk parashihen të hyrat, siç u tha, ku ta di çfarë, se i parasheh neni 21. dhe ato të hyra janë vetëm sa u përket gjobave dhe sigurisht se ne nuk mund të presim ta gjobitim dikë për ta plotësuar atë, d.m.th. për shkak se na nevojiten të hollat dhe nuk mund të pritët nga ato gjoba diçka e madhe. Kjo për mua është shqetësuese për shkak se kostoja kaq e lartë është e paplanifikuar, d.m.th. nuk është planifikuar, për kund ... në aspektin buxhetor dhe na paraqitet si deficit në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Pse deficit? Deficit për shkak se nuk ka mundësi, së paku ashtu është thënë që buxheti i

konsoliduar i Kosovës të rritet me çfarë hapi, mendoj se me këto mjete të pasiguruara do ta kemi shumë vështirë.

Unë u ndala në këtë aspekt për shkak se e konsideroj se është një shtegdalje në aspektin e asaj që të bëhet diçka që të zbuten këto shpenzime, ndoshta duke i fuzionuar dy agjencitë, z. Ministër, siç është ajo për miniera dhe minerale, që dhe kjo shumë çka ka të përbashkët me të. Kjo është si ide, po mendoj, por duhet të shikohet, përndryshe mendoj se një buxhet kaq i lartë shkakton deficit të madh. Ajo tjetra çka duhet të them këtu është çështja e deklaratës së pajtueshmërisë së Projektligjit me standardet ndërkombëtare, ose ..... akikomunitare ....që e themi shpesh. U tha këtu diçka, por unë mendoj se nuk na mjaftojnë këto dy paraqitje këtu që u thanë nga parafolësit, siç është deklarata e Zyrës për integritet evropian që i ka vërejtjet dhe e Ministrisë që thotë vërejtjet janë inkorporuar. Pse po e them këtë, po e them për shkak se na duhet dhe pajtohemi me atë që u tha më parë se duhet të jetë një deklaratë shtesë dhe këtë e kërkoj si deputet, por besoj se do ta kërkojmë edhe si Komision funksional që të na vijë se vërtet a janë plotësuar apo jo ato kritere të cilat u thanë. Pse po e them? E them për faktin se ka pasur deklarime të tilla, ka pasur edhe deklarime nga Ministria, që për shembull për Ligjin për efikasitetin e energjisë dhe ato nuk janë plotësuar. Do të thotë kjo edhe kushtëzon faktikisht atë, në mënyrë që të janë të bindur për atë dhe në këtë drejtim mendoj se është shumë me rëndësi për shkak se ne gjithmonë po themi që të investohet etj. por në qoftë se një investues do të pyes se si të investohet në Kosovës, sigurisht se do të pyes se a ka ligje dhe a janë në përputhje me .....akikomunitare..... që po i themi. Duhet të themi se tash janë duke u bërë edhe zbulime të mineraleve të tjera, për shembull për bakrin e tjera dhe sigurisht që do të ketë edhe për metale të tjera shumë hulumtime, kështu që rëndësia e vërtetë është shumë e madhe. Ju faleminderit!

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** - Ju faleminderit! Me diskutimin e z. Xhemajli konsideroj se ka përfunduar për t'i paraqitur diskutimet rreth Ligjit për hulumtimet gjeologjike dhe tani i lus deputetët të bëhen gati për votim dhe regjia njëkohësisht. Regjinë e lus që të fillojmë votimin

Kush është për ta miratuar në procedurë ligjin?  
Fillojmë votimin

Konsideroj që Projektligji për hulumtime gjeologjike, në lexim të parë është miratuar me 72 vota "Për" dhe 1 "Kundër".

Në bazë të rregullës 23, pika 6 dhe rregullës 35, pika 2 Kuvendi i ngarkon këto Komisione:

1. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion si Komision funksional dhe referues,
2. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisioni për Komunitete

Komisioni duhet në afat jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime dhe amendamente përkatëse.

Ju faleminderit!

Do të vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës. Urdhëro z., Xhezair Murati

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – G.Predsedavajući ja predlažem da se naredna tačka odloži za, kao prva za sutrašnje zasedanje zato što u dogovoru sa šefovima agrupa SDK i AAK nedovoljan je broj poslanika prisutnih u Sali i mi smo došli do dogovora da predložimo da ovo odložite kao prvu tačku za sutra.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Unë nuk pajtohem që në sallë nuk ka mjaft deputetë. Në sallë ka mjaft deputetë, janë 79, është çështje e seancës në qoftë se ju mendoni se duhet ta ndërpresim për një arsye ose tjetrën, ne mund të votojmë. Unë jam i ngarkuar ta përfundoj pikën e tetë të rendit të ditës dhe të vazhdoj me shqyrtimin e raportit përfundimtar për buxhetin e vitit 2005.

Mendoj që kjo pikë nuk do të na marrë shumë kohë është e shkurtër, është vetëm emërtimi i zëvendësministrit të cilin e ka propozuar Qeveria dhe emërtimi i disa anëtarëve në komisionet e Grupit Parlamentar për Integritet në komisionet përkatëse të Kuvendit, si të doni e hedhim në votim, në qoftë se kryetarët e grupeve parlamentare janë pajtuar për ta ndërprerë sot dhe për ta vazhduar nesër, unë s'ka gjë kundër, a do fjalën, z. Alush Gashi e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Ne i kemi edhe dy pika të rendit të ditës, pika e dytë që është në rend të ditës, respektivisht është pika e fundit për grupin tonë, është prej pikave me rëndësi të posaçme ndoshta edhe më e rëndësishme çështja e buxhetit. Mendoj se tash duhet të krijohet një pauzë dhe të vazhdohet, ministri nuk është këtu, ministri është nga radhët e LDK-ës, dhe na insistojmë që ajo çështje të diskutohet kur të jetë ministri këtu. Duke marrë parasysh që tash është koha për pauzë, kërkesa jonë është që këto dy pika të shqyrtohen nesër. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – z. Krasniqi në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Unë propozoj që pika numër 8 të hiqet krejt nga rendi i ditës për faktin se zëvendësministrat askund nuk emërohen as votohen në Parlament, ato janë çështje të Qeverisë dhe mendoj që ne po e bëjmë një precedent duke votuar për zëvendësministra në Parlament, kështu që mendoj që duhet ta heqim këtë çështje nga rendi i ditës zëvendësministra janë çështje të koalicionit dhe atje le të emërohen ne i zgjedhim ministrat, kabinetin e Qeverisë, kryeministrin dhe ministrat.

Sa i përket çështjes së dytë pikës së 9, raportit edhe unë mendoj që derisa nuk është ministri për Ekonomi dhe Financa dhe për derisa nuk është kabineti i tij i plotë, të shtyhet për nesër ose për ndonjë ditë tjetër, kur duhet të jetë komplet kabineti qeveritar.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Urdhëro z. Gjylnaze Sylja.

DEPUTETI GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryesues. Edhe Grupi Parlamentar pajtohet që kjo të shtyhet për nesër. Mendoj që nesër do të vazhdojë sidomos duke marrë parasysh se edhe buxheti gjithashtu është për grupin parlamentar ,ndër pikat më me rëndësi dhe kërkohet prezenca e ministrit, gjithashtu. Dy pikat e fundit të shtyhen për nesër. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit .Edhe kryeministri edhe ministrat në një farë mënyre po e mbështesin propozimin e z. Krasniqi. Do të thotë për të mos votuar zëvendësministrat në Parlament . Kjo të mbetet çështje e Qeverisë. Me Rregullore e kemi ndryshe. A jeni dakord a po e lëmë për nesër të vendosim për këtë. Faleminderit .Atëherë vazhdojmë nesër në orën 10,00.

### Vazhdimi i seancës më 2.6.2006

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Mirëmëngjesi. Lus ministrat dhe deputetët t'i zënë vendet e tyre.

Ju përshëndes të gjithëve dhe ju njoftoj se do të vazhdojmë me rendin e ditës që na ka mbetur në gjysmë. Besoj se të gjithë deputetët e kanë marrë një dokument shtesë që ministri i Financave e ka dorëzuar për shqyrtim për ta lexuar dhe për të pasur konsideratë. Ju njoftoj se të pranishëm janë 71 deputetë dhe mund ta vazhdojmë punën. Dje e trajtuam problemin e votimit të zëvendësministrit të ,z. Alltai Surroi, anëtar i Partisë Demokratike Turke për postin e zëvendësministrit të Drejtësisë.

Neve na është krijuar një praktikë ,që edhe dje u konsiderua jo e domosdoshme që të merret Parlamenti me të, por megjithatë mendoj se çështja e zëvendësministrave dhe marrëveshjeve që i bën koalicioni qeverisës, mendoj se janë çështje të brendshme dhe se nuk do të duhej të votohej, por të miratohej me një votim formal, meqë i kemi dy rregullore që edhe ajo e UNMIK-ut edhe kjo e Kuvendit e parashohin të votohet në Kuvend. Mendoj se Qeveria e ka autorizuar ministrin, përkatësisht kryeministri ministrin e Drejtësisë ta paraqesë propozimin. Unë deri më tash pata disa reagime që vijnë nga i gjithë spektri politik i Kuvendit të Kosovës. që kjo çështje të mos kalojë në votim, por të miratohet ashtu siç është propozuar. Tash kërkoj një deklaratë lidhur me këtë nga kryetarët e grupeve parlamentare ,që mund të thonë diçka lidhur me propozimin që e ka bërë Qeveria për zëvendësministrin e Qeverisë. Z. Alush Gashi e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Ne deri më tani kemi pasur edhe një përvojë të zgjedhjes së zëvendësministrave. Në asnjë fazë personalisht nuk kam qenë i sigurt se cila është mënyra më e drejtë. Dje e kemi dëgjuar një propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Mendoj se do të ishte e udhës se z. kryeministër këtë çështje ta sqaroj me Përfaqësuesin Special të Serkretarit të Përgjithshëm, sepse me organizimin e Kornizës Kushtetuese fjala e tij në këtë organizim tonin dhe në këtë fazë të zhvillimit është e fundit. Ndoshta nuk do të bëhej



shumë vonë që ne të bisedojmë që kjo çështje të sqarohet deri në seancën e ardhshme. Nëse kjo nuk pranohet ne natyrisht i nënshtrohemi votimit dhe i presim rezultatet ato çfarë do t'i jep ky Kuvend, por mendoj se një propozim i PDK-së që ka qenë dje konstruktiv meriton respektin dhe marrjen në konsideratë të atij propozimi. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit z. Gashi, propozimin e Partisë Demokratike e kemi dëgjuar dje, propozimin e grupit të Aleancës-për Ardhmërinë e Kosovës z. Gjylnaze Syla.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – Ju faleminderit z. kryesues. Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah atë çka e tha z. Alush Gashi, d.m.th .edhe ne pajtohemi që kryeministri së pari ta sqarojë këtë me Petersenin dhe në qoftë se nuk pajtohet, ne mund të kalojmë në procedurë të votimit dhe konsiderojmë se duhet të shtyhet për seancën e ardhshme. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Fjalën e ka Grupi 6+ z. Murati.

**POSLANIK DŽEZAIR MURATI** – Mi se predružujemo statovima grupa SDK i Aleanse za budućnost, dakle podržavamo da se najpre to reši u razgovoru iz među premieera i specijalnog predstavnika ako ne da se pristupi glasanje u Parlamentu. Hvala.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Maloku.

**DEPUTETI NAIM MALOKU** – I nderuari z. kryesues. Më lejoni që para Kuvendit ta jap një mendim pak më ndryshe. Në procesin e bartjes së kompetencave në këto dy ministri, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në atë të Drejtësisë, më lejoni t'ju them se kam qenë pjesë e ekipit nga ana e vendorëve për hartimin e rregulloreve, posaçërisht të Rregullores për Ministrinë e Punëve të Brendshme. Si marrëveshje ndërmjet vendorëve , ndërkombëtarëve dhe UNMIK-ut ka qenë që në këto dy ministri, një zëvendësministër të jetë nga minoritetet i punëve të brendshme nga minoriteti serb, ndërsa në të drejtësisë një zëvendësministër të jetë nga minoritetet jo serbe në Kosovë dhe i takoi minoritetit turk. Pasi kjo është marrëveshje dhe procedurë e tillë ka qenë në plotësimin e kushteve dhe për bartjen e kompetencave në këtë fazë në këto dy ministri dhe ai zëvendësministër është duke punuar, lus Kuvendin pasi kjo nuk është pjesë e marrëveshjes së koalicionit qeverisës, por i tejkalon këto rrethana, dhe këtë kornizë, është pjesë e marrëveshjeve në procesin e bartjes së kompetencave, mendoj se Kuvendi duhet ta bëjë një votim formal për këtë zëvendësministër dhe të vazhdojë punën, por nga sot, pasi të merret vendimi për votimi në Kuvend do të kishte një formë legjitimiteti edhe nga ky Kuvend. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit z. Maloku, nuk i konteston askush ato që i thatë, megjithatë nuk dua t'i komentoj ato që i thatë, por mendoj që nuk do të duhej të vishej me imunitetin e ministrit me votim në Parlament zëvendësministri, ky është mendim i imi që e kam shfaqur disa herë. Pra, kërkoj deklarinimin e grupeve parlamentare dhe grupet parlamentare e kanë fjalën.

Tani në emër të Orës janë dy të paraqitur, Teuta Sahatqija mendoj se do të flasë

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryesues. Më lejoni ta lexoj Rregulloren kreu VII, rregulla 18 pika 3, në të cilën flitet për zgjedhjen e kryeministrit dhe Qeverisë. Pika tre thotë: “Qeveria e Kosovës e përbërë nga kandidatët për kryeministër, zëvendëskryeministër dhe nga kandidatët për ministra dhe zëvendësministra konsiderohet e zgjedhur nëse kandidatët marrin shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit. Mënyrën e votimit për zgjedhjen e Qeverisë e cakton Kuvendi”. Në këtë rregull e shohim që Kuvendi e ka kompetencën e votimit të secilit prej tyre, prej kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrave dhe zëvendësministrave, prandaj mendoj që sipas Rregullores ne do të duhej të votojmë edhe për kandidati për zëvendësministër, pasi Rregullorja thotë kështu, në qoftë se dëshirojmë ta anashkalojmë Rregulloren ashtu si e anashkaluam edhe dje ,atëherë kisha propozuar që ta ndërrojmë Rregulloren dhe ta bëjmë ashtu si na konvenon. Në qoftë se e kemi rregulloren është mirë ta respektojmë . Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, në emër të Grupit për Integrim, z. Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar ministra, kolegë deputetë. Sa na kujtohet neve në Kuvendin e Kosovës edhe Grupi për Integrim ,të gjithë zëvendësministrat deri më tash janë votuar nga ky Kuvend dhe nuk e shohim të arsyeshme që vetëm z. Alltan Surroi të mos hyjë në këtë procedurë. Grupi Parlamentar për Integrim mendon se Kuvendi duhet të deklarohet dhe ta votojë, ndërsa ne si grup do ta mbështesim dhe do ta votojmë për disa arsye. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Për fjalë lidhur me çështjen është paraqitur z. Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI - Faleminderit z. kryesues. Mendoj se nuk është mirë të flas këtu si deputet në emër të Grupit, por në emrin tim personal ,sepse kemi të drejtë të shprehim mendime të gjithë. Nuk është mirë që një precedent t i tillë të ndodhë në Kuvend për hir të institucioneve tona, kandidati i nominuar për zëvendësministër është kandidat i Grupit 6+, kurse grupi 6+ është pjesë e koalicionit qeveritar . Pra,kjo është çështje edhe e koordinimit ndërmjet përbërësve të koalicionit qeveritar. Mënyra si do t'u qasen emërimeve të kandidatëve të tyre, prandaj nuk ishte dashur që ky emërim tash të futet në rend dite, sepse këta e konsiderojnë se nuk i kanë votat e nevojshme për emërimin e personit në fjalë, pra është një koordinim i domosdoshëm dhe i pashmangshëm ndërmjet përbërësve të koalicionit për t'i kryer ato synime që i ka koalicioni rreth emërimit të kandidatëve. Prandaj krejtësisht është e pakuptimtë, pavarësisht se këtë propozim e ka bërë opozita, që është absurd në veti të anashkalohet votimi për një përbërës të Qeverisë. Prandaj nuk duhet të futemi në këso lojërash ,siç ndodhi dje kur u votua ,pra u shkel Rregullorja e Kuvendit. Në qoftë se Rregullorja nuk na pëlqen ose nuk i pëlqen shumicës që e ka këtu përbërjen ,atëherë votojmë ta ndryshojmë Rregulloren dhe të vazhdojmë sipas tekeve dhe sa herë të mos ju pëlqej rregullorja, prapë të votojmë ta ndryshojmë atë dhe të vazhdojmë .Ko mendoj se është

krejtësisht e papranueshme dhe vetë diskutimi për këtë problematikë është i pakuptimtë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Është e drejtë e çdonjërit të shfaq mendim e vet. Fjalën e ka z. Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. Kryesues. Unë i dëgjova pikëpamjet e grupeve parlamentare dhe këto në një mënyrë lidhen njëra me tjetrën dhe këtu për t'i kuptuar duhet të bëhen interpretime, d.m.th. ka kërkesa të grupeve të mëdha parlamentare të mendohet dhe të veprohet ndryshe, por gjithashtu, ka kërkesa të grupeve që insistojnë që Rregullorja të zbatohet me përpikëri. Edhe unë mendoj se duhet të veprohet patjetër sipas Rregullores. Nuk është problemi vetëm a do të votohet, por a do të votohet i njëjti njeri. Pra, këtu qëndron problemi i Rregullores. Nëse koalicioni qeveritar në Kuvend mendon që sot nuk duhet të votohet edhe unë mendoj kështu. Tjetër është puna e solidaritetit ose e dëshirës së të tjerëve që ta votojnë, problemi është shkurt dhe qartë. Ky njeri për t'u zgjedhur në Kuvend duhet t'i marrë 61 vota, nëse ky Kuvend i jep sot 61 vota ai zgjidhet, nëse jo-nuk zgjidhet dhe nuk kemi nevojë të zhvillojmë teori të ndryshme. Unë mendoj se duhet të merren seriozisht mendimet e grupeve parlamentar që e përbëjnë koalicionin që të procedohet në një mbledhje tjetër. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Është e vërtetë se Rregullorja e punës së Kuvendit, rregulla 18.3 thotë se ministrat dhe zëvendësministrat i zgjedh Kuvendi, por është edhe një e vërtetë tjetër se Korniza Kushtetuese përcakton pak më ndryshe zgjedhjen e Kabinetit Qeveritar dhe në te nuk janë paraparë, d.m.th. ka një zbrastësi juridike lidhur me zgjedhjen e zëvendësministrave ose të zëvendëskryeministrit. Është po ashtu një e vërtetë se ekziston një rregullore e punës, Rregullorja për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës dhe ka plotësim të kësaj rregulloreje, varësisht si janë zhvilluar institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës. Pra, në asnjërin prej këtyre rregulloreve nuk thuhet se zëvendësministrat zgjidhen nga Kuvendi, absolutisht nuk thuhet, prandaj nëse është kështu edhe pse me Rregulloren e punës së Kuvendit ekziston kjo rregull, ka një akt juridik që është më i lartë, më i madh, më i fuqishëm nga pikëpamja juridike se Rregullorja e punës së Kuvendit – është Korniza Kushtetuese. Urdhëroni ta ndryshojmë Kornizën Kushtetuese, që ta harmonizojmë ose ta ndryshojmë Rregulloren e punës së Kuvendit me Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Koci. Më lejoni që të bëjë konstatim formal nga të gjitha diskutimet, veçanërisht nga diskutimet e atyre grupeve që përbëjnë koalicionin që u konstatua se vendimi për këtë çështje duhet të merret në një seancë tjetër të ardhshme. Mendoj se ky vendim duhet të merret në seancën e sotme. Vazhdojmë me rendin e ditës. S'ka procedurë këtu, kurrfarë procedure nuk ka. Vazhdojmë, urdhëro Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Unë nuk e konsideroj këtë punë tallje, siç po e merrni ju, në rast se marrim vendime, prapë duhet t'i përmbahemi Rregullores se në të thuhet

qartë se në rast propozimi të qartë për ta zhvendosur një pikë të rendit të ditës për një ditë tjetër duhet të votohet, ai është mocion që duhet të votohet. Në këtu votim nuk patëm. Vullneti i shprehur nga koalicioni qeveritar që të shtyhet për një ditë tjetër, por prapë votim nuk pat. Duhet të votohet për propozimin ,sepse me këtë kryhet kjo punë Ju lutem t'i përmbahemi Rregullores ,sepse shkelja e saj na godet më shumë se opozitën, sepse këta i kanë gishtat dhe sa herë që duan e shkelin.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Unë konstatoj se nuk ka shkelje të Rregullores, është tërheqje e grupeve që e përbëjnë koalicionin. Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar 6+ kërkoi të shtyhet kjo dhe kandidati vjen nga ky grup parlamentar, prandaj nuk mendoj që ne do të duhej të përzihehemi në punët e brendshme dhe në vendimet dhe qëndrimet e tyre dhe të votojmë për qëndrimet e tyre të brendshme.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

**Kemi një vendim të Kryesisë mbi bazën e kërkesës së Grupit Parlamentar për Integritet dhe vendimit të Kryesisë lidhur me rritjen e numrit të anëtarëve të grupeve nëpër komisione.**

Duke u bazuar në rregullat 48.4.5 të Rregullores së punës dhe në pajtim me kreun IX, I dhe XIX të Komizës Kushtetuese në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare të mbajtur më 30 maj 2006 shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar për Integritet për t'u përfaqësuar në komisione parlamentare dhe mori këtë:

#### **Propozim vendim**

Për rritjen e numrit të anëtarëve në komisionet funksionale.

1. I propozohet Kuvendit që numri i deputetëve anëtarë në 8 komisione funksionale të rritet nga 12 në 14 anëtarë dhe
2. Numri i anëtarëve të rinj të bëhet me propozim të grupeve parlamentare dhe atë 6 anëtarë të
3. Grupit Parlamentar për Integritet, 2 anëtarë të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe 8 anëtarë të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Unë dua t'ju informoj edhe lidhur me këtë shkresë që është bërë zyrtarisht pas debatit që është zhvilluar është vendosur që këta anëtarë të cilët shtohen dhe ky propozim të shtohet në numër të barabartë ndërmjet pozitës dhe opozitës, d.m.th nuk ka pasur tendencë që Lidhja Demokratike t'i merr numrin aq të madh të anëtarëve dhe partitë e tjera të koalicionit të mos kenë në këtë përbërje ashtu siç grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është treguar i gatshëm që të bëjë lëshim në raport me grupin parlamentar për integritet dhe t'ia mundësoj zgjedhjen edhe në 6 komisione parlamentare grupit për integritet sepse është konstatuar që grupi parlamentar për integritet aktualisht është i përfaqësuar në 5 komisione parlamentare që do të thotë se do të marrin pjesë edhe në 6 komisione tjera parlamentare. Unë ju ftoj që vendimin e Kryesisë së bashku me anëtarët e grupeve parlamentare ta miratoni sepse është bërë një

analizë e gjatë në 3 mbledhje radhazi dhe është diskutuar kjo çështje si dhe e vetmja formulë që ka mund të kalojë është kjo.

Gjergj Dedaj donë ta merr fjalën lidhur me këtë çështje .

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Vetëm sa për sqarim. Asnjë anëtar i Grupit Parlamentar për Integrim nuk është në asnjërin prej komisioneve deri më tash, vetëm është Komisioni për Kthim ku detyrimisht janë përfaqësuesit e bashkësive etnike dhe nuk e kuptoj që u deshën 6 muaj të prisnin 6 deputetë të 6 partive të ndryshme politike të na sistemonin nëpër komisione, edhe pse kjo është e drejtë jona dhe është në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit . Ne kemi edhe grupe të tjera, respekt për të gjitha grupet që kanë 6 deputetë e që janë kryetarë të komisioneve parlamentare dhe anëtarë të Kryesisë e që janë të përfshirë në 12 komisione parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Grupi Parlamentar për Integrim falënderon për këtë zemërgjerësi Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, për zgjidhjen e pjesshme të këtij problemi, insistojmë që ajo që vlen për 6 grupet e tjera në Kuvendin e Kosovës , të vlejë edhe për Grupin Parlamentar për Integrim. Ky është vetëm hapi i parë se ne do të shtrojmë edhe kërkesa të tjera që të përfshihemi në të gjitha komisionet parlamentare që ta kryesojmë ndonjërin komision dhe ta kemi përfaqësuesin tonë në Kryesinë e Kuvendit . Njëkohësisht kërkojmë, sikur që kemi kërkuar edhe përpara , pasi jemi nga 6 parti të ndryshme, ta kemi së paku nga një zyrë që na është thënë kur të kalojë Qeveria në ndërtesë të re shumëkatëshe .Qeveria ka kaluar,prandaj duhet të na mundësohet edhe ne si grup nuk do të pranojmë më të diskriminohemi nga ata që janë kompetentë ta luftojnë diskriminimin dhe të punojnë me drejtësi dhe barazi. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Dedaj. Për fjalë është paraqitur shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së.

DEPUTETI ALUSH GASHI - Ju faleminderit z. kryesues. Grupi ynë parlamentar e mirëpret organizmin e deputetëve që nuk kanë qenë të përfshirë në asnjë grup parlamentar. Ne si grup parlamentar do të bashkëpunojmë me grupin e ri dhe lidhur me propozimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, grupi ynë do të votojë për, prandaj ju lus që të fitoni vota. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, atëherë ju ftoj që të votojmë lidhur me propozimin e Kryesisë për zgjedhjen që e ka bërë. Regjia ju lutem ta bëni gati teknikën.

Votojmë tash.

Në sallë janë 75 deputetë, me teknikë kanë votuar 66. A ka dikush që nuk ka kartelë, d.m.th ,66 vota me elektronikë dhe 2 me dorë, janë 68 vota.

Për ..... 68  
Kundër ..... 06

Konstatoj që propozimi i Kryesisë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e 9 të rendit të ditës.

## 9. Shqyrtimi i raportit përfundimtar për buxhetin e vitit 2005.

Në pajtim me dispozitat e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe për përgjegjësitë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka proceduar raportin përfundimtar për buxhetin e vitit 2005. Këtë dokument të shqyrtuar Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa ia ka propozuar Kryesisë ta radhitë për shqyrtim në seancë plenare. Në pajtim me rregullën 22.5 ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave z. Haki Shatri që ta prezantojë raportin.

MINISTRI HAKI SHATRI – I nderuar kryesues, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, të nderuar të pranishëm .Siç e dini ,Ligji për buxhetin për vitin 2005 është miratuar më 2 muaj vonesë për shkak të zgjedhjeve të fundit të vitit 2004 dhe konstituimit të institucioneve qendrore në dhjetor 2004. Po ashtu në këtë periudhë është vendosur të kalohet nga sistemi i zotimeve në sistemin e keshit. Ky ndryshim fillimisht është përcjell me probleme për organizatat buxhetore të cilave u nevojitej një periudhë e adaptimit. Efektet e aplikimit të sistemit të keshit fillimisht ishin negative për organizatat buxhetore të cilat nuk ishin përgatitur me kohë për kalim në sistemin e ri dhe si pasojë disa programe kanë mbetur të papërfunduara në vitin 2004. Mirëpo efektet pozitive të sistemit të ri janë shumë më të mëdha dhe shprehen kryesisht në kontrollin më efikas të shpenzimeve nga ana e Ekonomisë dhe Financave. Ky dokument që po e shqyrtojmë sot përmban të dhënat mbi realizimin e të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore sipas organizatave buxhetore të përcaktuara si ndarje për vitin 2005. Mendoj që ky dokument përnda forma dhe përmbajtja është shumë më komplet, më lehtë i lexueshëm, më i kuptueshëm, përmban më shumë të dhëna dhe mbështetet në praktikat dhe në standardet ndërkombëtare të raportimeve financiare. Përveç kësaj Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka përgatitur dhe ka informuar Kuvendin, Qeverinë dhe PSPP-në me raporte periodike dhe mujore. Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe për përgjegjësitë e obligon ministrin e Ekonomisë dhe të Financave të prezantojë raport vjetor financiar për secilin vit buxhetor dhe përcakton kërkesat për raportim. Të nderuar deputetë,siç shihet nga të dhënat e bilancit të gjendjes së pasurive dhe të fondeve, më 31.12.2005 në vitin raportues vazhdoi konsolidimi i qëndrueshmërisë dhe i stabilitetit buxhetor. Ndryshimi negativ ndërmjet shpenzimeve të cilat ishin 696 milion euro dhe të hyrave të cilat ishin 628 milion euro është mbuluar nga rezervat e parasë në kesh në shumë prej 68 milion euro. Si rezultat rezerva e keshit më 31.12.2005 është 104 milion euro, këtu përfshihen edhe rreth 9 milion euro para të cilat janë si të hyra buxhetore të organizatave të caktuara buxhetore që gjithsej rezerva arrin në 114 milion euro. Kjo rezervë e domosdoshme garanton vitin 2006 dhe 2007 për funksionim të sigurt pa rrezik të bllokimit të institucioneve për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore. Kur kemi parasysh që në fillimi të këtij viti është realizuar me sukses një konferencë me donatorë për mbështetje buxhetore ku Kosovës i janë zotuar rreth 57 milion euro mbështetje buxhetore del se këtë vit dhe dy vitet pasuese Kosova nuk do të ballafaqohet me problemin e mungesës së mjeteve buxhetore. Dëshiroj të potencoj se konferenca me donatorë është e organizuar pas disa vizitave, misionit të fondit monetar ndërkombëtar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe vlerësimeve pozitive që u janë bërë procedurave buxhetore në vitin 2005. Vlerësimet pozitive të fondit ndërkombëtar dhe raportimi mbi respektimin e

rekomandimeve të fondit nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Qeverisë ja hapën dyert konferencës së donatorëve e cila u organizua nga Banka Botërore dhe komisioni Evropian në bashkëpunim me institucionet vendore dhe UNMIK-un. Rrethanat makroekonomike gjatë vitit 2005 kur u realizuan të hyrat dhe shpenzimet buxhetore që po i shqyrtojmë sot ishin të pa ndryshuara me ato që janë parashikuar me analizat makroekonomike në kohën e aprovimit të buxhetit për vitin 2005. Të hyrat fiskale në vitin 2005 janë paraparë të jenë 641 milion e 900.000 euro që do të thotë 4.31% më shumë se në vitin 2004. Në tabelën 1 faqe 3 të materialit që keni marrë janë pasqyruar të dhënat sipas burimit të të hyrave, plani i të hyrave 2005, realizimi në vitin 2005 si dhe krahasimi me vitin paraprak. Çka është karakteristike e të hyrave në vitin 2005. Plani i të hyrave është realizuar 98%, të hyrat janë realizuar në brendi, kanë shënuar rritje më dinamike se sa të hyrat në kufi, kjo ka ndikuar në fillimin e përmirësimit të strukturës së të hyrave fiskale. Janë dy burime të hyrash që nuk janë realizuar, e para, të hyrat vetjake të komunave janë realizuar vetëm 71%, pra 10 milion më pak se sa që janë parapa dhe e dyta, nuk janë realizuar të hyrat e parapara nga taksa për licencën e telefonisë, pra operatorit të dytë të telefonisë mobile. Përbërja e të hyrave fiskale të vitit 2005 dhe krahasimi me vitin 2004 janë pasqyruar në faqen 4 të këtij raporti, unë nuk e kam parë të nevojshme që t'i komentoj shifrat sepse i keni në pasqyra dhe tabela dhe në qoftë se ka nevojë pastaj me sqarime plotësuese mund të jepen.

Shpenzimet – Me ligjin për buxhetin në vitin 2005 kufijtë e shpenzimeve buxhetore janë limituar në 744 milion e 881.000 euro, në këtë shumë janë përfshirë edhe 2 huadhënie të Qeverisë për KEK-un dhe Aeroportin në shumë prej 22 milion euro, kjo do të thotë që shpenzimet reale janë përcaktuar në kufijtë 722 milion e 881.000 euro. Shpenzimet buxhetore në vitin 2005 kanë qenë 696 milion e 121.000 euro duke përfshirë këtu edhe huanë prej 22 milion euro, nëse zbresim huadhënien atëherë del se shpenzimet reale në vitin 2005 kanë qenë 674 milion e 121.000 euro ose 10% më pak se në vitin 2004 dhe po ashtu 10% më pak se në ndarje të buxhetit për vitin 2005. Karakteristikat esenciale të shpenzimeve në vitin 2005. Zvogëlimi global i shpenzimeve në krahasim me vitin 2004 dhe në krahasim me ndarjet e vitit 2005. Kursim përmbajtjesor përmes zvogëlimit të shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe kjo për 24% në krahasim me vitin paraprak dhe 10% në krahasim me ndarjet buxhetore 2005. Në asnjërën kategori të shpenzimeve nuk janë tejkaluar shpenzimet buxhetore të parapara me ligjin mbi buxhetin për vitin 2005.

Shpenzimet kapitale janë shpenzuar vetëm 87.5% ose kanë shënuar rënie për 22.7% në krahasim me vitin 2004, kjo paraqet pikën më të dobët të realizimit të buxhetit në vitin 2005, pra mosrealizimi i shpenzimeve për investime kapitale, këtu dëshiroj të theksoj se krahasimi me vitin 2004 kërkon një analizë pak më të përpiktë, sepse në vitin 2004 në diskonim për shpenzime kanë qenë 938 milion euro, kurse në vitin 2005 744 milion euro, pra ka pasur një vëllim më të madh të mjeteve të lejuara për shpenzime si rezultat i sistemit të zotimeve dhe grumbullimit të programeve për investime nga vitet paraprake dhe si rezultat i gjithë kësaj është ruajtur pjesëmarrja për shpenzime për të ardhura personale në nivelin e vitit paraprak, pra është karakteristikë tjetër e shpenzimeve, është zvogëluar pjesëmarrja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime, transferët sociale kanë mbetur në nivelin e vitit paraprak dhe është zvogëluar pjesëmarrja e investimeve kapitale në shpenzimet e gjithëmbarshme dhe kjo e fundit është negative.

Struktura e shpenzimeve e pasqyruar në faqen 6 tregon se në vitin 2005 në nivelin qendror më së shumti është shpenzuar për çështje ekonomike 29%, për mbrojtje sociale 22%, për siguri publike 15% dhe për shërbime të përgjithshme 13%, shëndetësi 9%. Në nivelin lokal në vend të parë vjen arsimit me 47%, shërbimet 39% dhe shëndetësia 12%. Në faqet 8 deri 14 të këtij raporti është bërë shpalosja e shënimeve të pasqyrave financiare 2005 si llogaritë bankare të fondit të konsoliduar të Kosovës, gjendja e llogarive në BPK dhe në Komerc Bank Frankfurt në llogaritë bankare të komunave, paratë në transit, fondi i privatizimit, fondi i donacioneve të përcaktuara dhe të hyrat vetjake Qeveritare dhe rezervat e Qeverisë. Një përshkrim detaj i të hyrave sipas llojit të të hyrave qoftë në kufi, qoftë në brendi është bërë në pjesën e raportit në faqen 15 deri në 28. Në këtë dokument janë pasqyruar ndryshimet gjatë vitit, pra ndryshimet që janë bërë me rishikim buxhetor në krahasim me buxhetin fillestar sipas organizatave buxhetore, pra për çdo organizatë buxhetore veç e veç pasqyrohen edhe ndryshimet e bëra gjatë vitit, jo është dhënë në aneksin 1 në faqen 32 deri 38.

Shpenzimet sipas organizatave buxhetore janë pasqyruar në aneksin 2 në faqen 39 deri 45. Raporti i grandeve të përcaktuara të donatorëve në aneksin 3, Fondi i privatizimit në aneksin 4, gjendja e të hyrave vetjake Qeveritare në aneksin 5, të dhënat për numrin e shërbyesve civil janë pasqyruar në aneksin nr. 6, në faqen 44 siç shihet numri i të punësuarave në fund të vitit është më i vogël se sa që është lejuar me buxhetin fillestar dhe për 2000 më i vogël se sa numri i lejuar i të punësuarve me rishikim në mesin e vitit 2005. Në nivelin lokal kemi në tejkallim të numrit të të punësuarve për 94 persona dhe në fund në aneksin 7 janë pasqyruar të dhënat për transferet e rezervave të Qeverisë dhe të PSSP-së në shumë prej 4 milion euro, respektivisht 3 milion euro. Shpenzimet dhe mbetja, pra janë të pasqyruara në këtë pasqyrë.

Të nderuar deputet ky raport përmbledh të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet e organizatave buxhetore dhe mbështetet në raportet individuale të organizatave buxhetore në të cilat janë të përfshira të gjitha të dhënat në detaje. Këto të dhëna i disponon Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe në shqyrtimin e këtij raporti në Komisionin për buxhet unë i kamë garantuar qasje në këto të dhëna të gjithë deputetëve të interesuar dhe sot po e përsëris edhe para jush se i mundësohet çdo deputeti të Kuvendit të Kosovës qasja në të dhënat si për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore kudo nëse për një gjë të tillë tregohet interes.

Përgjegjësia e Ekonomisë dhe Financave dhe e Qeverisë është respektimi i ligjeve dhe akteve tjera përcjellëse deri në vënien në dispozicion të parave të ndara në organizatat buxhetore. Më tutje, pas kalimit dhe ndarjes së mjeteve, zotimit për organizatat buxhetore përgjegjësia kalon te organizatat buxhetore dhe përgjegjës për shpenzimin e mjeteve publike janë menaxherët e financave në organizatat buxhetore, prandaj kërkoj që me rastin e diskutimit, vërejtjeve, pyetjeve apo edhe rekomandimeve të precizohet se për cilën organizatë buxhetore është fjala sepse mund të vijmë deri te një lajthitje ose mund të mos ofrojmë përgjigje precize në pyetje ose në komentet që ju i bëni. Ju falënderoj për vëmendje dhe jam i gatshëm që këtu t'i jap edhe përgjigje ose shpjegime plotësuese në rast se ka nevojë. Ju faleminderit.



KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Shatri, lus deputetët që të paraqiten në kohë për diskutim sipas radhës fjalën e ka z. Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës.

DEPUTETI NASER OSMANI – Faleminderit z. kryesues. E nderuara Qeveri, të nderuar deputet. Fjala ime këtu do të jetë edhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Duke u bazuar në kornizën kushtetuese kreu 5.1 dhe kreu 9.1.11 Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës ka shqyrtuar aktualitetet fiskale dhe raportin e analizave dhe të aktiviteteve ekonomike për periudhën janar – dhjetor të vitit 2005, të hartuar nga njësia e raportimit fiskal e MEF-it. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e obligon Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që të përgatis dhe dorëzoj raportin e përkohshëm buxhetor që mbulojnë periudhat periodike dhe vjetore për vitin fiskal. Raporti i përpiluar nga MEF-i është më i kompletuar nga krahasim me vitet e kaluara dhe për t'u avancuar edhe më tutje në këtë drejtim MEF-i duhet që të nxjerrë udhëzime administrative sa i përket kësaj çështje. Pasqyra financiare për vitin fiskal 2005 në mënyrë të qartë na tregon bilancin e gjendjes së pasurive dhe fondeve duke përfshirë paratë e gatshme në bankë, parat e gatshme në arkë, fondin e depozitave, fondin e privatizimit, fondi i cili nuk është në dispozicion të buxhetit e as në shërbim të ekonomisë Kosovare dhe për të cilat mjete duhet të ketë një raportim të ndarë dhe transparent nga institucioni përkatës. Buxheti i Kosovës për vitin 2005 i cili bazohet në paratë e gatshme i aprovuar në shkurt në këtë Kuvend ka paraparë të hyra buxhetore në shumë prej 641.90 milion euro, ndërsa shpenzime në vlerë prej 714.80 milion euro duke mos llogaritur edhe 22 milion euro të ndarë për KEK dhe Aeroport, pra qysh në fillim është paraparë një deficit real prej 72.90 milion euro, ndërsa duke llogaritur edhe huazimet është 94.90 milion euro. Ky deficit është planifikuar të mbulohet nga mjetet rezervë që kanë mbetur prej viteve të mëhershme. Raporti për vitin fiskal 2005 janë realizuar të hyra në shumë prej 628.22 milion euro ose 97.9% nga plani. Të hyrat janë të realizuara nga një planifikim përafërsisht i saktë, por me një strukturë të pavolitshme të të hyrave. Buxheti i Kosovës edhe më tutje mbështetet nga të hyrat e mbledhura në kufi me 69% dhe varësi e tillë është mjaft e lartë krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe pasqyron bilancin negativ tregtar në ekonominë e Kosovës. Të hyrat nga administrata tatimore në shumë prej 129 milion euro ose 20.5% nga shuma e të hyrave nuk janë të kënaqshme nga se administratës tatimore i kanë obligim tatimpaguesit në shumë 130 milion euro. MEF-i këtu duhet të përqendrohet më tepër sidomos në arkëtimin e obligimeve nga ndërmarrjet shoqërore, tanimë të privatizuara që kap një shumë prej 30 milion euro si dhe të atyre ndërmarrjeve të huaja që marrin punë në Kosovë nëpërmjet ofertave ndërkombëtare sidomos në ndërmarrjet publike që i menaxhon AKM-ja që janë diku në shumë prej 13 milion euro, si dhe të atyre kompanive që kanë punuar për AER-in e njëjta shumë është e pa inkasuar në vlerë të njëjtë 13 milion euro. Të hyrat komunale që në pasqyrën financiare figurojnë që kanë rritje prej 4.68% në krahasim me vitin fiskal 2004 ato janë të vogla dhe të pamjaftueshme si pasojë e centralizimit të të hyrave në nivelin qendror. Në këtë mënyrë të gjitha komunat në masë të madhe janë të varura nga grandet qeveritare që janë në shumë prej 127 milion euro, ndaj mjeteve vetjake që komunat sigurojnë kryesisht nga tatimi në pronë dhe pak mjete nga tarifat administrative dhe një pjesë e gjobave dhe licencave që përbëjnë gjithsej 24.71 milion euro. Shpenzimet janë preokupimi im kryesor dhe në këtë raport nxjerrin vlerësimet e duhura se si janë

shpenzuar dhe menaxhuar mjetet publike, por sikur të kishim të gatshëm një raport të auditivit për këtë periudhë fiskale ne do të ishim më të sigurt në këto vlerësime, sidoqoftë ne ju besojmë shënimeve dhe vlerësojmë mbi këto parime. Në vitin 2005 janë shpenzuar 696.12 milion euro nga 714.80 milion euro të planifikuara dhe janë dhënë në huazim 22 milion euro 2 ndërmarrjeve publike. Edhe këtu kemi strukturë të pavolitshme të shpenzimeve, sepse 28% të buxhetit shkon në paga, përqindje kjo më e madhe në rajonin e gjerë dhe për 6% më e madhe se mesatarja e Bashkësisë Evropiane. Kjo tregon se duhet të bëhet ristrukturimi i të punësuarve në sektorin publik, në mënyrë që të korrigohet politika e punësimit dhe të bëhen sistemime më të mira të të punësuarve. Në këtë të ketë një kujdes më të shtuar gjatë krijimit të vendeve të reja nëpër agjenci që po themelohen vazhdimisht dhe të korrigohet niveli i pagave për ..... dhe anëtarët e bordeve etj. Zvogëlimi i shpenzimeve në kategorinë e mjeteve të mallrave dhe shërbimeve për 24.2% në krahasimi me vitin fiskal 2004 për ne është inkurajues dhe duhet një nxitje edhe më e madhe për Qeverinë për programe kursimi. Kjo përqindje e zvogëlimit sigurisht se do të ishte më e madhe sikur të mos ishin bërë edhe riklasifikimi i disa pozicioneve nga pozicioni i investimeve kapitale në mallra dhe shërbime. 123.90 milion euro në emër të pagesave sociale nga mjetet e kategorisë subvencione dhe transferove paraqesin një brengosje dhe kërkojmë që Qeveria të përmirësojë procedurat për krijimin e bazës së të dhënave më të sakta, në mënyrë që të eliminohen përfituesit e tepërt në shojza. Kjo do t'i mundësonte Qeverisë që të zbatojë rekomandimin e Parlamentit për ndarjen e mjeteve edhe për 6 milion euro, siç e kemi thënë për ngritjen e pensioneve. Ajo që është e pashmangshme për ne është brengosja jonë e vazhdueshme për mjetet e dedikuara për AKM-në apo për ndërmarrjet publike në shumë prej 80 milion eurove dhe 22 milion euro huazim. Për këtë s'ka koment. Duhet që Qeveria të hartojë raport të veçantë për të gjitha mjetet që i janë ndarë AKM-së nga buxheti i Kosovës që nga fillimi në mënyrë të hollësishme që të pasqyrohen se a janë shpenzuar ato mjete ashtu siç janë destinuar dhe në fund duke mos u ndalur te kategoria e shpenzimeve kapitale ju ftoj të miratoni këtë raport, pasi Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar unanimitisht dhe në fund edhe një herë i bëj apel Qeverisë që të përqendrohet më tepër në programe kursimi se ka ende hapësirë të mjaftueshme të kursethet. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Tani sipas radhës grupet parlamentare kanë të drejtë, sipas madhësisë së tyre, ta marrin fjalën. Grupi Parlamentar i LDK-së a ka ndonjë të caktua? Jo...Atëherë në radhë është Grupi Parlamentar i PDK-së z. Jakup Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** - Z. kryesues. Ministra të ndërcuar, të nderuar deputetë. Është shumë interesant për mua, po debatojmë për raportin financiar për vitin 2005 në seancë merr pjesë një e treta e Kabinetit qeveritar edhe më pak se gjysma e deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Mendoj se kjo është një shkallë që tregon seriozitetin e institucioneve të Kosovës për shpenzimet që janë bërë për paratë publike. Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave është e obliguar të paraqesë raport vjetor financiar deri më 21 mars të vitit vijues. Në rastin tonë kjo po ndodh në fillim të muajit qershor 2006, d.m.th më se 2 muaj vonesë. Qëllimi i raportit është që Qeveria t'u japë informata të duhura tatimpaguesve, të bëhen sa më transparente si mënyra e grumbullimit, ashtu edhe mënyra e shpenzimit të parave publike.

Këto synime Qeveria, përkatësisht MEF-i nuk i ka arritur t'i përmbush. Raportet e auditorit gjeneral sidomos ato për vitin 2005, kanë shpalosur shumë keqpërdorime të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, por raporti i Qeverisë nuk e thotë asnjë nga këto gjëra që kaq shumë flitet dhe shkruhet sot në Kosovë. Me keq shfrytëzimin e buxhetit nuk kanë mbetur prapa Qeverisë as Kuvendi e Presidenca e Kosovës si dhe komunat. Prijnë sidomos komunat e mëdha prej nga kanë ardhur disa anëtarë të ish- kabinetit dhe të kabinetit të tashëm. Raporteve të të gjitha njësive buxhetore u mungon transparenca, pozicionet janë të paraqitura në mënyrë sintetike, analitika mungon në tërësi si për të hyrat ashtu edhe për të dalurat. Mënyra e tillë e raportit na shtyn të mendojmë dhe jemi të bindur se ka për qëllim fshehjen e vjedhjeve buxhetore dhe të veprimeve të tjera të paligjshme. Shpenzimet e bëra për vitin 2005 janë të sintetizuara në 4 pozicione, paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, transfere dhe subvencione dhe investime kapitale. Brenda këtyre pozicioneve nuk ka analitikë e cila do t'u mundësonte tatimpaguesit për të parë si janë dhe ku janë shfrytëzuar paratë e tyre. Kjo nuk u mundësohet as deputetëve të Parlamentit. Një formë e tillë e raportimit e pamundëson skajshmërisht transparencën, i mbulon të gjitha keq shfrytëzimet dhe vjedhjet që i janë bërë buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Karakteristikë tjetër e buxhetit të vitit 2005 është se dominojnë të hyrat në kufi 443 milion euro, në të hyrat e brendshme ka ngecje, në vend të 34.800.000 euro janë grumbulluar 24 milion, pra mbi 10 milion euro më pak. Në krahasim me vitin 2004, në vitin 2005 investimet kapitale janë zvogëluar për 42 milion euro. Në buxhetin e vitit 2005 për herë të parë kemi të paraqitur deficit për 70 milion euro. Sikur të mos ekzistonte suficiti nga vitet paraprake kjo Qeveri në aspektin financiar do të falimentonte, prandaj ky raport është dëshmi tjetër që ky Kuvend duhet t'ia marrë votëbesimin këtij kabineti qeveritar sa nuk është bërë tepër vonë. Investimet kapitale janë në vlerë prej 144.800.000 euro dhe në krahasim me vitin 2004 kemi një zvogëlim prej 42 milion euro. Këtu do të duhej të tregohej sa mjete janë shpenzuar për veturat e shtrenjta dhe të blinduar. Qeveria dhe institucionet e tjera kanë harxhuar shuma marramendëse, kurse tatimpaguesit nuk dinë asgjë për to. Ata për gjëra të tilla po arrijnë të njoftohen nëpërmjet mjeteve të informimit publik, ndërsa qeveritarët heshtin e kur nuk heshtin mashtrojnë me raporte të tilla, siç është ky që ne e kemi përpara. Neglizhenca e Qeverisë dhe implikimet e tjera rreth operatorit të dytë të telefonisë mobile, buxhetit të Kosovës për vitin 2005 i kanë kushtuar rreth 6 milion e 500.000 euro, që kanë qenë të hyra të planifikuara që është dashur të inkasohen gjatë vitit 2005. Në të njëjtën kohë kjo neglizhencë e dëmton shumë buxhetin e qytetarëve tanë me shërbime më të larta të telefonisë mobile në rajon dhe me telefoninë në përgjithësi, e në të njëjtën kohë u sjell fitime marramendëse MONAKO Telekomit dhe vendeve të tjera të rajonit për rreth nesh. Në raport askund nuk tregohet sa ka qenë shuma e parave të shpenzuara për vitin 2005 për qiradhënie, për hapësira qeveritare. Harxhimet e parasë publike për qiradhënie janë të mëdha dhe është dashur të pasqyrohen në këtë raport. Për mallra dhe shërbime thuhet në raport se kanë pasur 142 milion euro, por çka është brenda këtij zëri buxhetor, tatimpaguesit nuk mund të dinë, pra kështu siç janë paraqitur të dhënat në raport askush nuk ka mundësi të dijë sa njësi buxhetore kanë shpenzuar për telefona, sa kanë shpenzuar për derivate, sa kanë shpenzuar për reprezentacione, sa për udhëtime zyrtare të brendshme e të jashtme. Këtu mund të ketë edhe të dhëna të kamufluara, siç është rasti kur shpenzimet e udhëtimit të nxënësve paraqiten si shpenzime kapitale. Këto dhe të metat e tjera që të dëshmojnë edhe nga të tjerët, dëshmojnë se raporti nuk është i plotë dhe se Qeveria nuk i ka arritur

objektivat e planifikuar, ajo i ka shpenzuar paratë publike jo për çështjet e planifikuara. Ministrat e ndryshëm kanë shpenzuar shuma të mëdha të parave publike për teket dhe qcfet e tyre personale primitive pa pasur as ndjenjën e përgjegjësisë morale. Për gjëra të tilla ata do të duhej të përgjigjeshin para drejtësisë, por drejtësi në Kosovë nuk ka. Këtë po e tregojnë edhe shumë raporte të mekanizmave të jashtëm ndërkombëtarë. Qeveria me rastin e aprovimit të buxhetit të vitit 2005 ia ka dhënë vetes disa detyra, se do të ketë zhvillim ekonomik, arsim cilësor, përkujdesje shëndetësore, ndërsa mënyra e shpenzimit të buxhetit nuk e tregon këtë, nuk janë siguruar zhvillimi ekonomik, as vende të reja pune, pos mbipunësim në shërbimin publik. Nuk ka arsim cilësor dhe kompitabil me nevojat e ekonomisë së tregut të Kosovës, nuk ka përkujdesje adekuate shëndetësore, nuk ka përkujdesje sociale ndaj kategorive të veçanta e as ndaj kategorisë së luftës çlirimtare. Investimet në infrastrukturë dhe transport mungojnë, nuk ka siguruar zhvillim rural, nuk ka treguar ndonjë kujdesje për rajonet që tradicionalisht kanë qenë të diskriminuara nga regjimet e kaluara, siç është rajoni i Drenicës dhe rajonet e tjera të prapambetura ekonomikisht. Të gjitha këto dëshmojnë, besoj se edhe deputetët e tjerë do të shpalosin se ky kabinet qeveritar ka keq menaxhuar dhe ka keq shfrytëzuar, prandaj është i paaftë për ta qeverisur Kosovën. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Edhe një fjalë e ka Jakupi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – Kisha dëshiruar që ministrat që janë këtu sot dhe e dëgjuan fjalën time të jenë më të edukuar edhe nëse unë kam thënë diçka që nuk qëndron në raport, të dalin dhe ta shfrytëzojnë foltoren për të folur dhe t'i ndërprejnë gjuarjet e fjalëve në stilin e rrugaçëve, kjo do të ishte hera e fundit që kërkoj nga ministrat nëse janë këtu të rrinë si njerëz dhe jo si rrugaçë.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së është paraqitur deputeti Mazllo Kumnova.

**DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA** – Z. kryesues, raporti përfundimtar i buxhetit për vitin 2005 si është emëruar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa si pasqyrë financiare për vitin 2005, që në fillim na ka vënë në dilemë se a duhet pranuar si raport a si pasqyrë financiare. Me sa di unë raporti ka edhe komente si detyrim që del nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe nga përgjegjësitë e tjera që kërkon Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në kornizat e kësaj përgjegjësie është raportuar edhe pse ndonjë koment për zhvillime negative në ekonomi, deficitin tregtar, reflektimi i falimentimit të një banke ose në përgjithësi siguria bankare dhe të dhënat e tjera nga autoriteti bankar i Kosovës, menaxhimi financiar i fondit për rehabilitim, ndonjë tregues i keq menaxhimit ose qytetarët sa kanë qenë objekt i qeverisjes dhe i mirëkuptimit, sa ka qenë korrekt ndaj parasë publike dhe disa çështje të tjera që do të krijonin një pasqyrë më të plotë. Që në fillim mund të konstatojmë në bazë të dhënave që janë prezantuar se menaxhimi i buxhetit nga institucionet tona ka shënuar një përmirësim të dukshëm në krahasim me periudhën e kaluar. Po ashtu ky raport, për herë të parë, ka pasqyruar edhe aspekte financiare të privatizimit, por jo edhe të AKM-së. Rritja e të hyrave për 4.3 dhe ulja e treguesit të shpenzimeve për 7.1% janë një shenjë inkurajues në një rën të derisa përballemi përsëri me deficitin për 68 milion në anën tjetër. Po ashtu edhe përqindja 97.9

e hyrave të grumbulluara janë shenjë e një buxheti stabil edhe pse gjithnjë mbetet në kuotën e një treguesi të varfërisë së skajshme. S'ka dyshim se mbetet të diskutohet paaftësia administrative komunale për grumbullimin e tatimeve që janë ende larg realizimit sipas planifikimit, pra mbetet të punohet në krijimin e një administrate të përgjegjshme në grumbullimin dhe shfrytëzimin me efektivitet të parave publike. Në anën tjetër, grantet nëpër komuna shumë të diskutueshme për kriteret, kryesisht shpenzohen për paga dhe mëditje. Kjo do të thotë se jemi larg asaj strategjie që taksapaguesit t'i kthehet ajo që i merret në shërbim dhe shërbesa ndaj qytetarëve me investime të nevojshme në favor të gjithë qytetarëve. Pa dyshim mbetet shumë për të bërë në drejtim të një menaxhimi të shëndetshëm të financave publike, për të cilin vërehet një angazhim më i shtuar i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, sidomos në këtë vit. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar Ora fjalën e ka Nazim Jashari.

**DEPUTETI NAZIM JASHARI** - Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryesues, të nderuar ministra. Është një ngjarje që zakonisht nëpër Kuvend kur diskutohet qoftë për miratimin e buxhetit dhe që ndodh zakonisht në fund të çdo viti kalendarik, qoftë kur diskutohet për mënyrën se si është shpenzuar buxheti. Fatkeqësisht në Kuvend kjo nuk është ngjarje, sepse qasja jonë ndaj parasë publike është e tillë çfarë unë si deputet ose grupi parlamentar të cilit i takoj, kemi dëshirë të ndryshojë dhe të jetë më shumë përgjegjësi, që nga ato para publike të kemi sa më shumë shërbime dhe të mira për qytetarët e Kosovës. Ajo nuk mund të ndodhë, sepse thjesht raporti i forcave në këtë Kuvend jo me seriozitet e bënë të pranueshëm dhe vetëm një frymë të mundshme të punës së këtij Kuvendi. A ka kuptim tash me këtë qasje, me këtë seriozitet që po e manifestojmë gjatë diskutimit për këtë problematikë, mendoj se ne duhet ta bëjmë punën tonë sidoqoftë, por kuptim kësaj pune nuk mund t'i gjejmë. Puna dhe defekti i parë i këtij procesi më duhet t'ju them është mosrespektimi i normave ligjore lidhur me procesin e buxhetit në Kosovë. Ligji për menaxhimin e financave publike thotë pikë për pikë: "31 marsi është data kur duhet të dorëzohet raporti". Raporti në Kuvend është dorëzuar me 12 prill, nuk është shumë, janë 12 ditë, por janë 12 ditë shkelje e afateve, janë 12 ditë të shkeljes së ligjit për të cilat në një shoqëri normale demokratike nuk do të ishte marrë ministri në përgjegjësi nga opozita, por do të ishte marrë në përgjegjësi nga partia e vet, por kjo te ne nuk ndodh. Po diskutojmë për mënyrën e shpenzimit të buxhetit për vitin 2005. Zonja dhe zotërinj, sipas nenit 37 të Ligjit për menaxhimin e financave publike thuhet pikë për pikë: "brenda 30 ditësh pas miratimit nga Kuvendi dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara ministri do ta publikojë buxhetin e vitit aktual fiskal", as në sajtin për Ekonomisë dhe Financave e as në sajtin e UNMIK online nuk është publikuar ende buxheti i vitit 2006. Pra ligji e thotë prerazi, kurse norma e ligjit nuk zbatohet. Prapë ne vazhdojmë thuaja se nuk është punë e madhe kjo siç po bëjmë zakonisht, thuaja se ne nuk kemi nevojë për ligje dhe as për norma të shkruara, po që se shoqëria njerëzore do të sillej siç sillemi ne, të jeni të sigurt se ende rrota nuk do të ishte zbuluar, pra ne po sillemi me komoditet, i cili për mua nuk është aspak premtues në vigjilje të promovimit ose shpalljes së Kosovës shtet me të drejta të barabarta në bashkësinë e kombeve. Sidoqoftë më mbetet një shpresë se kjo sjellje do të ndryshojë

dhe ky seriozitet do të rritet që edhe Kosova të fillojë të komunikojë me qytetarë të vetë dhe qytetarët e Kosovës me institucionet e veta, në mënyrë siç komunikohet çdo kund në botë dhe ku ligjet janë mënyra e vetme që i rregullojnë jetën dhe sjelljen dhe jo emocionet as dëshirat apo nevojat e çastit për zgjidhje të ndryshme. Si do që të jetë krejt këtë debat për këtë problematikë e bën të deplasuar pikërisht kjo qasje. Ne tash mund të futemi në shifra, mund të themi se janë 180 milion për këtë punë dhe atë punë kur në aspektin themelor fundamental nuk respektohen ligjet, kur në aspektin fundamental nuk ju përmbahemi normave që i kemi miratuar vetë. Krejt këto tjerat janë të pakuptimta, e humbin logjikën. Si do që të jetë nuk na shkruhet mirë, por dhashtë Zoti ta rritim këtë seriozitet. Më parë apeloj te deputetët e shumicës, sepse ata e kanë në dorë këtë proces dhe nuk e kemi ne, ata duhet ta rrisin seriozitetin e Qeverisë përpara se ne, ne jemi këtu vetëm për të tërhequr vërejtjet të cilat mund të jenë ndonjëherë edhe subjektive, por ata janë që duhet ta rrisin efikasitetin e qeverisjes, sepse tek e fundit ciklet zgjedhore po përsëriten shpesh edhe do të vijë një ditë kur fare lehtë mund të ndodhë që të kalojnë në opozitë dhe pastaj ata t'i bëjnë vërejtjet, kurse të tjerët do ta kenë për detyrë ta rrisin efikasitetin e qeverisjes. Është krejtësisht e pakuptimtë që buxhetin e vitit 2006 ende ne nuk e dimë, ne harxhojmë paranë publike dhe nuk e dimë se sipas cilave ndarje e shpenzojmë paranë publike për vitin 2006, nuk e dimë, e kemi miratuar në Kuvend një Projektligj. E kemi miratuar me shumicën e votave, mirëpo ai ligj që do të ishte dashur që të publikohej nuk është publikuar ende, ne kemi periudhën e viteve paraprake kur e dimë saktë se para shpalljes ligji është ndryshuar dhe për shkak të situatës specifike në të cilën ndodhet Kosova dhe sipas atyre ndryshimeve janë vazhduar edhe shpenzimet, aktualisht nuk e kemi këtë. Ministri sigurisht do të na jap sqarim për këtë arsye, por vetë toleromi i kësaj që jemi në muajin e 6 tash dhe ai ligj nuk është shpallur flet për vete. Mendoj se raporti që na është dhënë është një raport tejet i përgjithshëm, ne në komision kemi diskutuar në parim për këtë, kryetari i komisionit e tha që është miratuar njëzërit. Më duhet ta përgënjeshtroj, nuk është miratuar as nuk është votuar fare për të. Të jemi të sinqertë, kemi diskutuar thellësisht në parim nuk kemi mundur që ta shtrojmë gjerë e gjatë dhe të diskutojmë për të së paku një ndoshta nuk kam qenë aty, ka të tjerë që mund të ma verifikojnë, zakonisht jam i pranishëm, por vetëm nëse kam qenë me leje në udhëtim, por sidoqoftë nuk është e vërtetë që ka pasur unanimitet në komision, me vetë faktin se dikush nuk ka qenë i pranishëm. Unanimiteti ndërtohet vetëm kur janë të gjithë aty edhe kur nuk ka zëra të ndryshëm edhe pse dyshoj shumë që z. Koci ka qenë unanimitet sepse vetë shefi i tij paraprakisht i sugjeroj këtij Kuvendi se si të sillet ndaj këtij raporti. Të nderuar kolegë deputetë e shoh se sipas këtyre përshkrimeve, këtyre shifrave që na janë sjellë kemi reduktim të shpenzimeve, mallrave dhe të shërbimeve nga viti 2004 në vitin 2005 që u tha këtu më se 40 milion, kemi reduktim të shpenzimeve kapitale që është fatkeqësi nga viti 2004 në vitin 2005 krejt kjo është për shkak të arsyes së deficitit buxhetor që po futemi që 2 vjet, por mendoj se është mirë të ketë reduktime, është mirë të ketë zvogëlim shpenzimesh, është mirë të sillemi më me nikoqirllëk ndaj parasë publike, mirëpo nuk është mirë që t'i shkurtojmë shpenzimet aty ku nuk duhet të shkurtohen. Unë pata rastin të shkoja në një udhëtim zyrtar me koordinatoren e Paktit të Stabilitetit për Kosovë, zyrtari i Kosovës, kryeministri paraprak ia kishte shkurtuar telefonin roming dhe njeriu i cili në një farë mënyre është përfaqësues ynë i vetëm në komunikimin institucional me botën nuk ka telefon roming për të komunikuar me partnerët e tij. Kjo është për mua e pakuptimtë, duhet t'i shkurtojmë shpenzime, por jo të

shkurtojme shpenzimet aty ku e zvogëlojmë efikasitetin e punës. Kjo është për më tepër kur e kemi parasysh një rrethanë që nëpër ministri në të gjitha nivelet kemi gjithfarë burokratësh, që jo që shfrytëzojnë romingun, por shpenzojnë për telefona sasi marramendëse të parave dhe për këtë nuk i japin askujt llogari. Shpresojmë shumë që kjo Qeveri e cila e ka një kryeministër të ri, i cili ende nuk i ka bërë 100 ditë që të mund të merremi me te, për një shkak të një parimi fundamental të demokracisë. Shpresojmë shumë që do të fillojë gradualisht të mendoj se si të ndryshojë mënyra e vjeljes së të hyrave publike, sepse në këtë mënyrë të të vjelave të të hyrave publike ne po e shohim që buxheti i Konsoliduar i Kosovës vazhdimisht nuk u përgjigjet kërkesave të Kosovës për nevojat elementare, por e shohim që shpenzimet kapitale, investimet publike në Kosovë janë reduktuar në 20% të shumës së këtij buxheti, kurse e kemi shumë të qartë që pa investime publike as edhe një shoqëri e vetme, e cila është ndodhur në këtë gjendje që ndodhet Kosova nuk ka mundur të dalë nga kriza. Pra, parakusht fundamental që të mund të lëvizim përpjetë drejt rritjes sado të vogël ekonomike do të duhej të ishte rritja e investimeve publike dhe kjo nuk mund të ndodhë deri sa e kemi një buxhet i cili vazhdimisht shkon në reduktim. Urgjentisht kërkohet nga kjo Ministri dhe nga kjo Qeveri që të bëjë ndryshim në mënyrën e vjeljes së të hyrave, sepse të gjithë jemi dëshmitarë, nuk jemi dëshmitarë të drejtpërdrejtë që në Kosovë ka evazion të hatashëm fiskal, doganat tona janë dogana sikur djathi zviceran, kalon gjithçka dhe jam më se i bindur që një shumë e madhe futet nëpër xhepat e zyrtarëve të ndryshëm nëpër të gjitha nivelet e Qeverisë.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit z. deputet. Nga Grupi Parlamentar 6+ nuk ka të paraqitur. Nga Grupi për Integritet është paraqitur deputeti Ferid Agani.

**DEPUTETI FERID AGANI** – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti të paraqitur para nesh, i cili është i sanksionuar dhe i obliguar edhe me ligj. Grupi Parlamentar për Integritet e konsideron se ka mund të jetë më komplet, ka mund të ketë një komponent edhe më të theksuar analitik në bazë të çkafit ne kishim mund si deputet të nxjerrim përfundime më gjithëpërfshirëse për efektivitetin e menaxhimit financiar të buxhetit në vitin 2005. Për t'u larguar nga vlerësimet e përgjithshme të cilat i dhanë parafolësit, kisha pasur dëshirë që të jenë pak më konkret dhe me qëllim parandalues që të mos përsëriten gabimet e vitit 2005 për buxhetin e vitit 2007 dhe praktikisht edhe buxheti i vitit 2006 lëngon nga të njëjtat të meta, isha përqendruar në organizatën buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe kisha tërhequr vërejtjen në disa pika. Mënyra e shfrytëzimit të buxhetit të vitit 2005 është vërtet shumë i qartë i lëshimeve të mëdha në procesin e përpilimit të buxhetit për sektorin e shëndetësisë. Konsideroj se në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave mungon ndjeshmëria për specifikat e sektorit të shëndetësisë dhe në një mënyrë parimet të cilat vlejné për sektorët e tjerë të jetës shoqërore bëhen përpjekje të përgjysmohen edhe për sektorin e shëndetësisë dhe në këtë mënyrë shkaktohen vështirësi shumë të theksuara në funksionimin e shërbimeve brenda këtij sektori. Konkretisht, synimi i përgjithshëm, siç e përmendi edhe parafolësi i shtimit të investimeve kapitale ka vlejtur dhe është zbatuar edhe me rastin e caktimit të prioriteteve nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2005. Për këto qëllime është ndarë një shumë mjaft e madhe e të hollave, por shihet se prej këtyre

mjeteve janë shpenzuar vetëm 43.8% d.m.th 3.728.000 euro kanë ngelur të pashfrytëzuara nga kategoria për investime kapitale në buxhetin për sektorin e shëndetësisë i cili lëngon nga mungesa e madhe e mjeteve financiare. Njëkohësisht, d.m.th në këtë situatë kur kemi suficit në këtë kategori buxhetore, njëkohësisht kemi punëtorët shëndetësorë të cilët kujdestarojnë dhe nuk paguhen për punën e tyre, nuk ....do se kjo është kategori ligjore, t'ju përkujtoj se neni 27.3 i Ligjit për shëndetësi që është ligj që duhet të vlejë për të gjitha ministrinë, mendoj se kujdesi shëndetësor sigurohet gjatë 24 orëve pa ndërprerje ,duke organizuar punën në ndërresa dhe në sistemin e kujdestarive. Kjo punë nuk parashihet për pagesë nga kategoria e pagave dhe e mëditjeve nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Njëkohësisht e kemi suficitin në kategorinë për investime kapitale, d.m.th ekziston një konflikt i qartë i cili në terren në institucionet shëndetësore rezulton me vështirësi të mëdha. Në anën tjetër e kemi mungesën e interesimit për zhvillimin e burimeve njerëzore, p.sh. në vitin 2006 ndodh të zvogëlohet buxheti i paraparë për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe numri i specializantëve do të zvogëlohet nga 660 në 330, d.m.th ne po investojmë në diçka që do të jetë vetëm një objekt i thatë dhe në të cilin askush nuk do të punojë .Konkretisht e kemi rastin e 4 shtëpive për integrim me nga 10 shtretër, ku do të mund të vendoseshin të sëmuret kronikë psikiatrikë që po na shëtitin rrugëve të qyteteve tona më të mëdha dhe këto 4 shtëpi për integrim janë të ndërtuara, janë të gatshme për funksionim, ekziston kuadri i trajnuar për to, por nuk ka paga dhe mëditje për t'i aktivizuar këto shërbime dhe njëkohësisht e kemi suficitin në kategorinë e investimeve kapitale për 3.700.000 €. Unë mendoj se në një mënyrë kjo të mos na përsëritet. Lus Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave që me të vërtetë të ngrihet në shkallën më të lartë të përgjegjësisë lidhur me këto probleme. Këto janë probleme që janë duke u përsëritur nga viti në vit dhe unë mendoj se kjo nuk bënë të ndodhë në buxhetin e vitit 2007. Duhet të nxjerrim mësim nga gabimet dhe të mos përsëriten këto, të bëhet redistribuimi i mjeteve të pakta financiare të cilat ekzistojnë dhe në këtë mënyrë të mundësohet konsolidimi i shërbimeve shëndetësore. Investimet kapitale në sektorin e shëndetësisë janë padyshim të nevojshme, por ne kemi situatën kur kemi investuar në shërbimet onkologjike dhe në shërbimet për diagnostikime kardiovaskulare, të cilat edhe sot e kësaj dite ende nuk po mund të aktivizohen mu për shkak të mungesës së investimeve në ata sektorë ku janë në pyetje resurset njerëzore. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Në radhë është deputetja Naxhije Doçi

**DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI** – Faleminderit z. kryesues. Të nderuar ministra, i nderuari zëvendësministër, të nderuar deputetë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Si anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa në kuadër të Parlamentit do t'i jap disa vlerësime për raportin e vitit 2005 e këto janë disa karakteristika të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2005. Shpenzimet buxhetore në vitin 2005 kanë ndodhur duke respektuar ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe rregulloren e buxhetit, të gjitha shpenzimet buxhetore janë aprovuar në harmoni të plotë me këto dy dokumente që autorizojnë shpenzimet buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2005 kanë arritur shumë rreth 696 milion euro, duke mos përfshirë shpenzimet nga grantet dhe financimet e ndryshme që paraqet 93.5% të



ndarjeve të tërësishme vjetore, kurse niveli i realizimit të shpenzimeve në vitin 2004 ishte rreth 80% e realizimit të planit. Karakteristikë për shpenzimet e vitit 2005 është se ato ishin për 7.1% më të ulëta krahasuar me vitin 2004, ku përkundër transferim të disa përgjegjësive në fushat e ndryshme nga UNMIK-u te IPVQ-të shpenzimet ishin më të vogla megjithë aktivitetet e rritura. Shpenzimet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë 194.6 euro ose 28.0% të shpenzimeve të përgjithshme që krahasuar me planin vjetor për këtë kategori ato janë realizuar me 97.9% për deri sa krahasuar me vitin 2004 kjo kategori e shpenzimeve është më e lartë për 5.3%. Kjo ngritje e shpenzimeve ka ndodhur kryesisht për shkak të rritjes së pagave në arsim për 7 €, krijimit të ministrive të reja dhe bartjes të disa përgjegjësive nga policia e UNMIK-ut tek SHPK-ja. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë 142.8 milion € ose 20.5% e shpenzimeve të përgjithshme apo 90.6% e realizimit të planit vjetor për deri sa krahasuar me vitin e kaluar janë më të vogla për 24.2%. Ky ngushtimi i shpenzimeve në mallra dhe shërbime ka ndodhur për arsye se Qeveria e Kosovës në kushtet e buxhetit të kufizuar ka shkurtuar planin e shpenzimeve së paku 10% nga viti 2004 në vitin 2005. Në të gjitha organizatat buxhetore duke mos përfshirë vetëm ministrinë e reja. Shpenzimet në kategorinë e subvencionit dhe transferët janë 191.8 € ose 27.6% ose 99.1% e realizimit të planit vjetor që krahasuar me vitin paraprak 2004 janë më të larta për 3.6%. Kjo rritje e kësaj kategorie ka ndodhur kryesisht për shkak të rritjes së numrit të pensionistëve dhe të skemës tjetër sociale. Vitin e kaluar është dhënë një hua për KEK-un dhe Aeroportin në shumë prej 22 milion euro. Shpenzimet kapitale nga 165.6 milion euro të ndara në vitin 2005 janë shpenzuar 144.9 milion euro ose 87.5% e planit. Në vitin 2004 nga 328 milion të ndara janë shpenzuar 187.4 milion euro nga kjo shihet se shpenzimet kapitale në vitin 2005 krahasuar me vitin 2004 kanë një shkallë shumë më të lartë të realizimit të planit, përkundër që në temat nominal kishim një zbritje të shpenzimeve për faktin që në vitin 2005 nuk kemi pasur bartje të mjeteve nga vitet paraprake. Në fund do të kisha rekomanduar Qeverinë që me anë të programeve kursyese të ketë një përkujdesje më të shtuar të shpenzimeve të parave publike, sepse ato me megjithatë ato e duan një sistemim edhe pak më të mirë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit z. deputete. Për fjalë është paraqitur deputeti Demir Limaj.

**DEPUTETI DEMIR LIMAJ** – I nderuar z. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë.

Në bazë të analizës që i kemi bërë raportit vjetor të buxhetit shihet qartë se është një shfrytëzim i egër i buxhetit të krijuar nga taksapaguesit, përkatësisht qytetarët tanë. Nuk do mend të shihet nga ata që duan të shohin se kemi shpenzime të cilat i tejkalojnë përmasat normale të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Të nderuar, unë dua të ndalem vetëm në disa çështje shumë konkrete që mendoj dhe konsideroj se për qytetarët tanë janë shumë të nevojshme që të kenë njohuri si menaxhohet, përkatësisht si keqpërdoret paraja jonë publike. Dua të ndalem te shpenzimet e telefonit. I nderuar z. ministër i Financave, ju si ministër në kuadër të Ministrisë suaj harxhoni telefon 439.000 euro, që do të thotë afër gjysmë milioni vetëm shpenzime të telefonit që i keni në kuadër të Ministrisë suaj, kurse Ministria e Shërbimeve Publike ka shpenzuar për vitin 2005 vetëm 259.479 euro rreth 300.000 euro dhe unë kolegut tim, gjegjësisht shefit tim të Grupit

Parlamentar Jakup Krasniqit i them që po të ishte në ndërgjegjen dhe në nivelin e ngritjes morale dhe të përgjegjësisë së ministrave , së pari do të duhej t'i zvogëlonin shpenzimet dhe do të ishin shumë të vetëdijshëm e të përgjegjshëm për këto shpenzime që i kanë bërë në buxhetin vjetor nga paraja e qytetarëve tanë ,që i kanë keqpërdorur egërsisht. I nderuar shefi im të mos ju vijë keq se këtu shihen qartë pozicionet si keqpërdoren mjetet e buxhetit tonë të konsoliduar të grumbulluara nga taksapaguesit tanë.

Vetëm për automjete keni shpenzuar më se 5 milion euro. A e keni parasysh gjendjen e rëndë sociale të qytetarëve tanë? Mendoj se jo ,sepse vetëm për automjete të shpenzohen 5 milion kjo është e pakuptimtë dhe skandaloze. Për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, që së bashku me shpenzimet për mëditje jashtë vendit dhe për mëditje, brenda vendit, kapin shumën mbi 1 milion e 400.000 euro. Mendoj se ky është kulmi i të gjitha keqpërdorimeve që janë bërë për vitin 2005 dhe po vazhdon edhe më 2006, kurse në emër të qirasë keni shpenzim mbi 2 milion e 15.000 euro. I nderuar z. ministër për çfarë qiraje bëhet fjalë? A mendoni ju z. se ne me 2 milion euro do ta ndërtonim një objekt dhe më nuk do të kishim nevojë që për zyra të paguanim qira. Duke përfunduar me këto pak fjalë kërkoj nga institucionet tona, përkatësisht nga kryeministri dhe Qeveria dhe nga ministri i Financave të jenë të përgjegjshëm, sepse ,para së gjithash kanë përgjegjësi morale dhe politike para qytetarëve të vendit. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI – Fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli**

**DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI - Faleminderit z. kryesues.** Sistemi tatimor në Kosovë duhet të mbështetet në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të promovojë barazinë si horizontale po ashtu edhe vertikale që do të thotë tatimpaguesit të paguajnë në procesin e shkallës së realizimit, në mënyrë adekuate. Sistemi tatimor duhet të sigurojë stabilitet buxhetor dhe fiskal. Normat aktuale tatimore në Kosovë janë relativisht të ulëta, të thjeshta dhe të qëndrueshme. Sistemi tatimor në Kosovë është i ri në përgjithësi dhe është në fazën finale të konsolidimit dhe të aplikimit të tatimeve. Administrata Tatimore , së bashku me tatimin doganor të Kosovës, paraqesin dy institucionet kryesore përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve janë duke punuar në ngritjen e efikasitetit dhe të shkallës së monitorimit sipas metoda edukative – këshilluese, duke tentuar gjithnjë të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes së tatimpaguesve. Të hyrat buxhetore të realizuara gjatë vitit 2005 kanë qenë në vlerë prej 628 milion, që krahasuar me vitin paraprak 2004 ato janë rritur për 4.3%. Karakteristikë e të hyrave buxhetore të Kosovës është që edhe më tutje pjesa më e madhe e tyre realizohet nga tatimet që aplikohen në kufi, afër 67% , të gjitha të hyrave e realizuara. Bazuar në të dhënat përfundimtare të vitit 2005 si dhe në krahasimin e tyre me vitet e mëhershme ,mund të vërejmë që është arritur një stabilitet i nivelit të të hyrave dhe një ngritje e shkallës së menaxhimit të tyre. Për të hyrat e mbledhura brenda vendit Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për mbledhjen e tyre .por, siç e dimë, se është një institucion që ka filluar të punojë që nga viti 2000 dhe krahasuar me vendet e tjera llogaritet se është administrata më e re në Evropë. Gjatë vitit 2005 të hyrat e mbledhura nga tatimet që mbledhen brenda në vend kanë qenë në vlerë prej 129 milion eurosh, që krahasuar me vitin 2004 kanë shënuar një rritje prej 13,3% dhe kjo rritje mund të llogaritet si një element i ngritjes së efikasitetit në

mbledhjen e tatimeve dhe nivelin e kontrollit të tatimpaguesve Përkundër kësaj rritjeje të të hyrave të mbledhura brenda vendit është shumë herët të pritët që tatimet e mbledhura në vend të zëvendësohen me të hyrat që mbledhen në kufi. Gjatë vitit 2005 kemi pasur disa ndryshime sa i përket legjislacionit tatimor, që kanë ndikuar edhe në ndryshimin e formës së aplikimit të tatimeve. Në veçanti 2 lloje të tatimeve, siç janë - tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në korporatat të cilat kanë filluar të zbatohen si tatim gjithëpërfshirës. Deri më tani tatimi në të ardhura personale është mbledhur vetëm nga individët, ndërsa që nga 1 janari 2005 ky tatim është zgjeruar edhe në tatimi gjithëpërfshirës, në bizneset e vogla individuale dhe në ato të mëdha individuale. Deri më tani në Kosovë është mbledhur shumica nga të hyrat e mbledhura në kufi edhe pse kjo varësi i ka filluar të bjerë. Varësia e tillë është e lartë krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe pjesërisht reflekton jo bilancin e madh të jashtëm në ekonomi të Kosovës. Të hyrat e mbledhura në kufi përbëjnë 90% të të hyrave të përgjithshme të mbledhura në vitin 2000, mirëpo kjo normë tash ka shënuar rënie 70% në vitin 2004, duke vazhduar në 67% në vitin 2005. Edhe pse të hyrat në kufi kanë shënuar rënie sa i përket pjesëmarrjes në gjithsej të hyra, ato janë rritur prej vitit në vit. Gjithsej të hyra në kufi gjatë vitit 2005 kanë qenë në vlerë prej 434 milion euro, që krahasuar me vitin 2004 vërehet një nivel pothuajse i njëjtë i mbledhjes së këtyre të hyrave. Krahasimi i vitit 2005 me vitin 2004 nuk është aq gjithëpërfshirës për faktin që kemi pasur disa ndryshime në legjislacionin tatimor gjatë këtyre viteve, të cilat janë reflektuar edhe në nivel të mbledhjes së të hyrave në kufi. Në kuadër të ndryshimeve kisha përmendur Rregulloren 2004/13, e cila ka filluar të aplikohet në qershor të vitit 2004 që liron një numër të konsiderueshëm të pajisjeve kapitale të lëndës së parë nga obligimi i pagesës dhe i taksës doganore, pastaj Rregullorja 2004/35, e liron një numër të konsiderueshëm të produkteve nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar në kufi e që ka filluar të aplikohet në tetorin e vitit 2004. Gjithashtu, kemi edhe ndryshime, të cilat janë bërë në fillim të vitit 2005, p.sh. ndryshimi i Rregullores mbi akcizën në vetura, akcizën në mazut dhe akcizën në importimin e cigareve. Të gjitha këto ndryshime kanë pasur ndikim edhe në trendin e të hyrave buxhetore gjatë këtyre dy vjetëve. Si kategori e veçantë e të hyrave buxhetore paraqiten edhe të hyrat jo tatimore, të cilat gjatë viteve të kaluara kanë pasur trend relativisht stabil me një rritje të lehtë. Gjatë vitit 2005 të hyrat jo tatimore kanë qenë në vlerë prej 74 milion eurosh e që krahasuar me një vit më parë (2004), kanë shënuar rritje për 9%, e cila mund të shpjegohet edhe me disa fakte që kanë të bëjnë me aplikimin e taksave të caktuara gjatë vitit 2005, të cilat nuk janë aplikuar qëparë si dhe me rritjen e shkallës së arkëtimit të tatimit në pronë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit z. deputet. Për fjalë është paraqitur deputetja Safete Hadërgjonaj

**DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ** - Zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Mua më vjen keq që sot raportin buxhetor ose pasqyrën financiare për vitin 2005, kur po i diskutojmë, nuk është kryeministri këtu. Është dashur që të jetë në mënyrë që të shohë si ka punuar Kabineti i tij qeveritar dhe shumë pak ministra, d.m.th vetëm 3 ministra i kemi prezent, kurse ne debatojmë në lidhje me raportin financiar të vitit 2005. Kjo është një papërgjegjësi. Sa për sqarim desha të them se këtë raport financiar nuk e ka miratuar Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ne kemi debatuar dhe kemi rekomanduar që të

shkojë në Kryesi dhe të debatohet në Kuvendin e Kosovës për këtë ekziston edhe stenogrami.

Në Raportin e Buxhetit 2005 jam ndalur në fushat që mbulon Ministria e Postë Telekomunikacionit.

Dhe që në fillim do të dëshiroja t'ia bëjë një pyetje ministrit Qemajl Ahmeti::

Çka ka bërë ai si ministër që të ketë informacione për shpenzimin e mjeteve në Aeroport, Hekurudhë e Postë?

Sipas një informacioni shihet se:

Posta, Telekomunikacioni dhe Hekurudhat e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje për të instaluar fibrat optike përgjatë binarëve të hekurudhave të Kosovës.

Projekti parashihet të kushtojë 5 milion dhe thuhet se do të financohet nga PTK-ja

Ndërsa, sipas informacioneve që disponojmë thuhet se nga Fondi Rezervë, Hekurudhave u janë ndarë 350.000 E, për instalimin e rrjetit të kablllove optike

Pyetja ime është „Kush e financon shtrirjen e kabllit optik në Hekurudhë?“

Unë pyes ministrin Shatri, si është e mundur që për të njëjtën punë dy herë të ndahen mjete?

Në Raportin e Buxhetit 2005 thuhet se janë ndarë 22 milion E për KEK-un dhe për Aeroportin, d.m.th. 3.2% të Buxhetit të 2005.

**E pyes inistrin Shatri:**

**A ka informacione se mbi çfarë baze i janë ndarë Aeroportit 13.7 milion E, vitin e kaluar si mjete shtesë?**

Dhe këtë pyetje e shtroj për faktin se:

Në një intervistë të zyrtarëve të lartë të buxhetit, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, në lidhje me mjetet shtesë të ndara nga Buxheti i Kosovës, gjejmë 13.7 milion E, ishin shprehur se:

„Deklarata financiare e Aeroportit zbulon se Aeroporti është një organizatë profitabile që ka gati 10 milionë E, para të gatshme dhe është vështirë të kuptohet se pse nevojiten fonde shtesë.

Dhe ata shpreheshin atëherë se do të duhej të zhvillohet një auditim i menaxhimit financiar në Aeroport, shtua që ;

Aeroporti nuk ka pasur nevojë urgjente për para, sepse ato nuk janë shfrytëzuar me kohë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka kërkuar që ato mjete t'i kthehen Buxhetit të Kosovës dhe të shpërndahen për destinacione të tjera.

**Zoti ministër Shatri, mbi çfarë baze ju keni bërë ndarjet e mjeteve, çka u bë me ato 13.7 milion E të ndara për Aeroportin.?**

Dëshiroj ta ripërsëris pyetjen time të cilën e pata shtruar në një seancë të Kuvendit kur pata diskutuar për Aeroportin,

**se ju zoti Ahmeti, si ministër dhe Ministria të cilën ju drejtoni, a posedoni një raport kthyes, në të cilin do të shihet se ku janë harxhuar, apo për çka janë shpenzuar mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Hekurudhat dhe për Aeroportin?**

Sipas disa informacioneve që disponojmë shihet se vetëm për rrethojën e Aeroportit (që është kusht për t'u licencuar në IKO)

Tenderi ka qenë i hapur qe dy vjet, por tash është anuluar. Për rrethojë thuhet se janë ndarë 4 milionë e gjysmë E.

Për Projektin për përcaktimin e pagave të punëtorëve thuhet se janë ndarë 200.000 E.

Ky projekt thuhet se i është dhënë një firme të huaj.

Projekti është bërë, por ai nuk është zbatuar.

Edhe pse projekti është bërë, stafi udhëheqës vendor përkundër kësaj, vetë ka bërë përshkrimin e vendeve të punës të punëtorëve.

Pra 200.000 E shkuan kot së koti.

Sipas informacioneve që disponojmë thuhet se paga mesatare në Aeroportin e Prishtinës është 1.200-1.400 E. Po të bëhet një përlllogaritje me numrin e të zënëve me punë në Aeroport, që është 620 punëtorë, atëherë shihet se 700.000 E harxhohen për paga të punëtorëve të Aeroportit.

Sipas raportit të OIOS thuhet se stafi menaxhues i Aeroportit të Prishtinës ka „bërë keqpërdorimin e fondeve publike“.

Hetimet dyvjeçare, në Aeroportin e Prishtinës, të kryera nga Zyra e Shërbimit të Brendshëm për Hetime të Kombeve të Bashkuara OIOS, në bashkëpunim me hetuesit e Bashkimit Evropian, kanë gjetur se „mashttrimet dhe keqmenaxhimi po rriten dhe se korrupcioni është sistematik“ në Aeroportin e Prishtinës.

Sipas këtij hulumtimi, arsyetimi më i shpesht i përgjegjësve të Aeroportit për abstenim nga masat kundër shkelësve ka qenë pohimi se në kohën kur ato kanë ndodhur nuk ka pasur ligje dhe mekanizma kontrolli. Në Aeroportin e Prishtinës për një kohë të gjatë ka munguar një sistem i llogaridhënës dhe kontrollit të brendshëm. Gjatë disa viteve janë

bërë shkelje sistematike të ligjit duke bërë që korrupsioni në këtë kompani publike të arrijë shkallë të pakontrollueshme

Për keqmenaxhimin e parasë publike flet edhe fakti se

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit ka bërë shpenzime vetëm për telefona mbi 30 mijë E.

Sa i përket Telefonisë mobile mbështes atë që tha shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Krasniqi, se për shkak të neglizhencës së Ministrisë së Postë Telekomunikacionit dhe ART-së në vitin 2005 nuk u arkëtuat në Buxhetin e konsoliduar 6 milion e 500.000 E.

Sa i përket Fondit të Privatizimit, shihet se nuk janë bërë ndarjet e mjeteve nga ky fond ashtu, siç është premtuar, psh.:

AKM-ja dhe Ndërmarrja „Ballkan“ e Therandës, nuk kanë përmbushur asnjë obligim ndaj punëtorëve. Punëtorët nuk kanë marrë 20% nga privatizimi, dy paga dhe 5300 E, për të cilin punëtorët posedojnë vendimet e plotëfuqishme.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryesues, të nderuar anëtarë të Kabientit qeveritar, kolegë të nderuar dhe të pranishëm të tjerë.

Ministria për Ekonomi dhe Financa „në pajtueshmëri me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë ka paraqitur para nesh raportin përfundimtar të buxhetit të cilin pas shikimit dhe analizimit e përkrasi për miratim. Andaj, duke shqyrtuar këtë raport përfundimtar të buxhetit të Kosovës për vitin 2005 në raport me atë të planifikuar dhe atë të realizuar në këtë periudhë, rezulton ata që dëshirojnë ta vlerësojnë se ka rritje të të hyrave çka është një paralajmërim i mirë dhe pozitiv për ekonominë tonë si dhe një gatishmëri e një forcimi të ekonomisë dhe menaxhimit të mirë të mjeteve finaciare. Mirëpo brengos fakti se të hyrat kryesore janë nga tatimet kufitare ku bëjnë pjesë TVSH-ja, akciza, taksat doganore etj. Në një aspekt flet për shkallë të ulët të ekonomisë së Kosovës dhe në veçanti për mungesën e të hyrave nga ekonomia prodhuese, e cila mjerisht edhe nuk ekziston. Të hyrat nga komunat janë shumë të ulta, kjo flet për një efikasitet dhe organizim joprofesional dhe adekuat të komunave ose planifikim të të hyrave të paarsyeshme apo mosaftësia për të përmbushur të hyrat e përcaktuara nga vetë këto njësi buxhetore. Vlerësoj se, në kuadër të subvencioneve dhe të transfereve, si kategori të shpenzimeve nuk ka pasur shpërndarje të drejtë, sepse p.sh. komuna e Mitrovicës ka shumë probleme të theksuara, është datur të rritet fondi i subvencioneve dhe i transfereve për të ndihmuar këtë qytet dhe kategoritë e qytetarëve për të stimuluar në veçanti edhe nga këndi politik, ngase për qytetarët e pjesës Veriore që lëshojnë shtëpitë, është pengesë e madhe pamundësia e financimit të tyre edhe në aspektin politik etj. Qytetarët që janë refugjatë në qytetin e Mitrovicës nuk ndihmohen nga nivelet. Do të kishte qenë mirë që këta të kenë një subvencion. Tre, procesi i rindërtimit të shtëpive të djegur të shqiptarëve në pjesën Veriore as që ka filluar në

mungesë të mjeteve dhe të përkrahjes të të gjitha niveleve dhe nën 4. projektet e ndërtimit të rrugëve të pjesës Veriore të qytetit dhe të fshatrave, janë pengesë për kthimin e shqiptarëve në trojet dhe në hapsirat e tyre gjeografike dhe se ky problem tani merr karakter jo vetëm politik, por edhe të kuptimit të ndarjes së rajonit, gjegjësisht të Mitrovicës. Ky raport paraqet gjendjen e konsoliduar financiare dhe është një informatë e mirë mbi situatën financiare dhe një specifikacion sipas shpenzimeve të organiztave buxhetore, por kjo nuk do të thotë se nuk ka nevojë që fondet e përbashkëta buxhetor të planifikohet për ndarje në bazë të prioriteteve si i ceka më lartë momentale dhe në veçanti të mundësujë që organizatat buxhetore që nuk kanë shfrytëzuar mjetet t'u merren dhe t'u dedikohen për nevojat me interes të përgjithshëm në ndonjë prioritet tjetër. Njëherit përkrahi të gjithë ata qytetarë që kërkojnë që mjetet e paguara në emër të rrugëve të cilat inkasohen me rastin e regjistrimit të automjeteve të formohet fondi për rrugë, që do të realizohet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në tërësi në Kosovë. Për të pasur një shpenzim real dhe të drejtë të buxhetit të Kosovës është më se e nevojshme zbatimimi i ligjeve ekzistuese si dhe krijimi i bazës ligjore, parimore dhe rigorizitet në organizimin dhe shfrytëzimin e buxhetit, duke dhënë llogari për shpenzimet e arsyeshme apo të paarsyeshme të çdo centi, duke filluar që nga telefoni, karborantete, rryma, automjetet, investimet, udhëtimet zyrtare, fakturimi si dhe format e tjera të ndarjes së këtyre mjeteve. Një dukuri e punësimit pa konkurs dhe pa arsytim vërehet në ngarkesën e buxhetit ose uljen e pagesave të të punësuarëve me çka jo vetëm se krijohen parregullsi dhe padrejtësi, por edhe pakënaqësi dhe destimulim për punë dhe mund të sjellin deri te pakënaqësitë sociale. Në këtë drejtim është e arsyeshme të vlersohet dhe të bëhet një kontrollim i sistemit bankar dhe i mjeteve të gatshme në banka, hipotekat e pambuluara dhe kreditë e pabazuara. Edhe një herë vlerësoj se është më se e arsyeshme të ngritet dhe të zgjidhet problemi i fondit të privatizimit në veçanti i mjeteve për të cilat ende nuk kemi mendimin përfundimtar të ekspertëve, të ministrive apo edhe nga Bashkësia Ndërkombëtare. Vlerësoj se për fondin e donacioneve ndërkombëtare do të duhej të gjendej një mënyrë që të përcaktohen hyrja dhe realizimi, sepse pikërisht këtu po ndodhin procese të pakontrolluara dhe të padrejta, kurse ne si Ministri duhet të kemi mundësi qasjeje edhe në këtë. Ju falënderoj.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit z. Kelmendi. Për fjalë është paraqitur deputeti Gani Koci.

**DEPUTETI GANI KOCI** - Faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Raportin e shpenzimeve buxhetore për vitin fiskal 2005, të cilin po e shqyrtojmë sot, do të mund ta quanim të plotë dhe të saktë sikur para vetës ,së bashku të, ta kishim edhe pasqyrën analitike të detajizuar dhe të arsytuar për çdo cent të shpenzuar nga paraja publike, në secilën linjë buxhetore. Ne kemi pritur që ky raport të përmbajë të dhënat sa para të buxhetit të Kosovës janë derdhur në fondin e zonjës Meri për thirrjet që janë bërë nga qeveritarë dhe administrata në numrin e saj të telefonit dhe në fondet e tjera të ngjashme me atë të falltorës Meri që përditë reklamohet në televizione publike dhe private pa leje për analitikën e shpenzimeve kapitale dhe të linjës së mallërave dhe të shërbimeve, por edhe të telefonave të secilit ministër veç e veç, kur dihet se nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2005 jo më pak se 3 milion e 700.000 euro kanë shkuar vetëm për shpenzime telefonike. Ky raport nuk i i përmbush kriteret e raportimit buxhetor

të përcaktuara qartë për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Neni 41 i këtij ligji saktë përcakton si duhet të bëhet raporti dhe çka duhet të përmbajë . Gati në asnjë rast nuk është punuar në përputhje me këto dispozita ligjore. Pa dashur të shpjegoj shkeljet e raportimit në secilin rast unë do të ndalem vetëm shkurtimisht te shpenzimet e rastit nga fondi rezerv i ministrit. Neni 41 që e kemi një letër sot nga ministri këtu si plotësim i këtij raporti që e kemi kërkuar gjatë shqyrtimit në Koisionin për Buxhet dhe deri më tani nuk na ka ardhur, prandaj nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë pjesë e këtij raportimi. E kemi gjetë në tavolinë të punës kur kemi ardhur sot këtu dhe pa dashur të shpjegoj shkeljet dua të ndalem te shpenzimet e rastit. Neni 41.4 nënpika (h) ,përveç tjerash, thotë se raporti duhet të përmbajë detajet, po e theksoj detajet e shpenzimeve për përvetësimet dhe për shpenzimet e rastit ,siç përshkruhen në nenin 26. Z. ministër ju e dini se edhe në Komisionin për Buxhet e kemi shqyrtuar këtë raport, kemi kërkuar të na sillni materialin shtesë dhe të detajizuar lidhur me këtë çështje, të cilën e ka përkrahur edhe komisioni, sepse nuk e ka miratuar raportin, por e ka përkrahur kërkesën që të silltet materiali shtesë dhe së bashku me këtë raport të shqyrtohet në Kuvend dhe Kuvendi ta miratojë. Ky ka qenë sqarimi që e shtroi edhe z. Jashari dhe të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit. Po të shikohet aneksi 7 i këtij raporti, fondi rezerv i juaj me rishikim ka qenë mbi 4 milion, tabela në këtë aneks tregon shuma të caktuara të përvetësimeve, por nuk tregon vendimet për ndarje të tilla dhe arsyeshmërinë e këtyre përvetësimeve. Në këtë tabelë shihen dy rubrika të ndarjeve për kryeministrin, njëra si shpenzime të jashtme për shumën 250 mijë euro dhe ndarja tjetër me titullin kompensim i mjeteve për çështje të jashtme në shumë prej 50 mijë euro.

Do të dëshironim shumë që ministri të na shpjegonte edhe për një rën ndarje edhe për tjetrën dhe t'i arsyetonte ndarjet e tilla, se ku kanë shkuar ,pse kanë shkuar, kujt i janë dhënë, pse janë dhënë?

Po në këtë aneks janë futur edhe 1 milion euro për Zyrën e kryetarit, për të cilat asnjëherë nuk është raportuar saktë edhe pse është kërkuar në shumë raste, por në asnjë rast nuk keni ndërmarrë veprime ligjore për shkeljen e Ligjit të menaxhimit të financave publike lidhur me mënyrën e bartjes së kësaj shume një herë nga Ministria e Shërbimeve Publike me nënshkrimin dhe me autorizimin tuaj dhe pas ngritjes së kësaj çështjeje në Kuvend dhe ndërhyrjes së z. Petersen dhe të mediave natyrisht kinse ka ndodhur kthimi i tyre dhe është bërë ndarja e serishme nga fondi juaj.

Ju këtë ndarje e keni futur në ndarjen e shpenzimeve kapitale, ndërsa Zyra e kryetarit, si shumë, e ka futur në linjën buxhetore të mallrave dhe shërbimeve. Raporti i fundit i auditorit gjeneral për Zyrën e kryetarit ka dëshmuar qartë shkeljet, keqpërdorimin dhe menaxhimin e parasë qytetarëve të cilat shkelje ne i kemi potencuar, por asnjëherë nuk keni dashur të dëgjoni. Sipas këtij raportit të auditorit gjykatat do të duhej të vepronin me urgjencë ndaj gjithë përgjegjësve kudo çofshin ata.

Çështja e dytë lidhur me këtë raport ka të bëjë me AKM-ën, është mirë që këtij raportit për herë të parë i shtohen edhe të hyra dhe shpenzimet e AKM-ës. Do të dëshiroja të di nga z. ministër se çka ka ndërmarrë për të siguruar që AKM-ja t'i përgjigjet plotësisht Kuvendit dhe meqë gati një e treta e buxhetit të Kosovës shpenzohet në organizata me kompetencë të rezervuar. Cila është qasja e juaj në mbikëqyrjen e përfaqësimeve dhe të



shpenzimeve të kësaj pjese të buxhetit të Kosovës?. As për këtë agjencinë buxhetore sikur edhe për asnjë tjetër nuk ka analizë të shpenzimeve, sidomos për pjesën e mallrave dhe të shërbimeve, ku keq menaxhimi dhe keqpërdorimi i financave publike është evident.

Po të shikohet ky raport nuk ka ndonjë dallim as në strukturën e të hyrave dhe as në atë të shpenzimeve nga raporte e tjera. Prandaj e vetmja gjë që mund të thuhet dhe që duhet të kërkohej është si dhe sa ka ndikuar mënyra e tillë e planifikimit dhe e shpenzimit të parasë publike në rrjedhat e përgjithshme ekonomike për vitin fiskal në fjalë.

Në qoftë se sukseset e Qeverisë maten sa të hyra ka pasur dhe sa i ka shpenzuar, vërtet raporti na del shumë i suksesshëm, se përafërsisht është plotësuar kjo, madje është tejkaluar se është shpenzuar më shumë sesa është planifikuar, por sukcesi matet si është shfrytëzuar kjo para, si janë shfrytëzuar këto mjete?

Qeveria nuk mund të mburret me përqindjen gjëja të sukseseve me grumbullimin e të hyrave publike, kur dihet mirëfilli se nga një suficit buxhetor i viteve të kaluara është futur në një deficit buxhetor, mbulimi i të cilit do të jetë shumë i vështirë, në mënyrën e planifikimit dhe të shpenzimit të parasë publike pa shenjë të rritjes së përgjithshme ekonomike. A do të mund ta përballojë Qeveria futjen e vazhdueshme në deficit buxhetor?

Ju e keni parë raportin e fundit të UENDIPI-së, REINVESTIT, USAID-it etj. të cilët tërheqin vërejtjet në këto çështje, rritja e çmimeve në krahasim me periudhën e kaluar në vitin 2005, rënia e eksportit për 17% në krahasim me vitin 2004, politika kreditore plotësisht e gabueshme që sjellë deri te problemet financiare, procesi i privatizimit dhe bllokimi i fondeve, loja e tërheqjes së ofertuesve të parë për ta zbritur çmimin e shitjes, rritja e vazhdueshme e papunësisë.

Dua të them se kontingjenti i papunësisë në Kosovë brenda një viti shtohen 1000 vetë.

Sukseset e çdo qeverie maten me mënyrën e planifikimit dhe të harxhimit të parasë publike dhe nëse është kështu, atëherë kjo qeveri deri më tani është treguar plotësisht e pasuksesshme dhe jo vetëm kaq. Raportet e fundit të auditimit kanë treguar tashmë se kjo qeveri jo vetëm që është e paafte për t'i menaxhuar financat publike, por është zhytur thellë në vjedhjen a parasë publike dhe në korrupsion.

Ne si deputetë kemi pasur edhe një raport të organit të Rregullatorit të Prokurimit Publik, përveç tjerash në atë raport theksohet se ka pasur shkelje drastike të Ligjit mbi Prokurimin publik, se nuk janë respektuar procedurat e prokurimit publik, kriteret për zgjedhjen e përfituesve dhe se lidhur me këto shkelje nuk është ndërmarrë dhe nuk po ndërmerret asgjë. Te ne, siç u tha edhe nga shumë diskutues të tjerë, nuk funksionon sistemi i drejtësisë.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit z. deputet Për fjalë është paraqitur deputetja dhe ministre e Shërbimeve Publike, Melihate Tërmkollli.

MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI –Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë.

Të them të drejtën nuk e pata ndërmend të diskutoja rreth kësaj pike të rendit të ditës, por e pashë që u përmend nga një deputet i PDK-ës Ministria e Shërbimeve Publike, me gjasë se PDK-ja ka dhimbje me SHP që s'po mundet në asnjë mënyrë ta shërojë, do t'i them dy – tri fjalë që për hir të realitetit edhe asaj që është e vërtetë.

Për të nxjerrë konstatim duhet të ketë një bazë krahasuese dhe natyrisht unë nuk them që ky raport, i cili është paraqitur, është më i mirë ose është përdorur më së miri, është shpenzuar më së miri etj. etj.

Mirëpo për të parë se ku jemi edhe ku kemi qenë në fakt duhet të shohim ku kemi qenë. Unë do të jep vetëm disa informacione për Ministrinë e Shërbimeve Publike për shpenzimet në vitin 2004 dhe vitin 2005 dhe do t'ju lus shumë që përfundimisht t'i ndalini informimet ose dezinformimet e plota të qytetarëve të institucioneve e të tjera.

Për shpenzimet e telefonit në vitin 2004, kur ministër ka qenë z. Krasniqi, janë shpenzuar 315.616 euro, në vitin 2005 janë shpenzuar 241.790 euro, ndryshimi është 73.826 euro, që do të thotë ky është kursim vetëm për shpenzimet e telefonit.

Për avans dhe udhëtimet zyrtare janë shpenzuar 165.000 euro në vitin 2004, janë 95.000 euro në vitin 2005, ndryshimi është 70.000 euro, janë kursime edhe 70.000 euro të tjera. Ky mund të jetë nëntëmujori ndoshta jo viti i plotë, por këto janë të dhënat.

Shpenzimet për karburant në vitin 2004 janë 511.283 euro, në vitin 2005 janë 358.000 euro, 152.464 euro janë kursime.

Blerja e mobiljeve 67.799 euro janë në vitin 2004, kurse 20.803 euro janë në vitin 2005 si dhe 46.996 euro janë kursime.

Riparimet e veturave për faktin që nuk janë blerë asnjë veturë e re, në vitin 2004 janë 86.534, në vitin 2005 janë 124.000 euro, sepse kanë nisur të vjetrohen, por MSHP-ja nuk ka blerë vetura të reja.

Pajisjet e teknologjisë informatike janë 1.816.706 euro për vitin 2004, kurse 222.728 për vitin 2005 dhe 1.593.000 është ndryshimi, është gjithsej 2.963.885 janë në vitin 2004, 1.063.000 në vitin 2005, ndryshimi 1.900.000 euro kursime. Ju lus shumë, po e them prapë se ka vend edhe më tutje edhe Qeveria në përgjithësi edhe ministrinë veç e veç që të bëjnë kursime, por kritikën që vijnë nga ata që kanë bërë shpenzime marramendëse gjatë gjithë periudhës së qeverisjes së atyre janë absurde. Unë e kam thënë edhe në një medium informativ, që hajni bërtet gjithë herë thotë këqyre hajnin, nëse e keni gjetur vetën ju në këto s'kam çka ju bëj, ia pafshi hairin. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Replikë apo diskutim ?Jakup Krasniqi- replikë.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Ky është manipulim me shifra, kam bindje të plotë. Dua të merrem vetëm me teknologjinë informative. Në kohën time ka qenë Departamenti për Teknologji Informatike që ka bërë shërbime për gjithë institucionet e Kosovës dhe jo vetëm për Ministrinë e Shërbimeve Publike. Tash është koha kur kemi

konsolidimin e teknologjisë informatike në institucionet e Kosovës dhe natyrisht që kjo shumë nuk do të duhej të ishte si në vitet 2004, 2003 edhe në vitet në vazhdim, së pari.

Së dyti, sa i përket krahasimit që bëhet me mobilitet, ndërtesa e Ministrisë, por dhe shërbimet tjera që kanë qenë në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike, kanë qenë në konsolidim dhe është një vërtetë e madhe që nuk ka pasur nevojë në vitin 2005 as në vitin 2004 dhe në vitin kur janë konsoliduar institucionet dhe kjo përsëri është manipulim me shumën dhe shifrat.

Në vitet e mëhershme ka pasur një përdorim të shumtë të telefonive edhe nga administrata ndërkombëtare, që ka qenë në Kosovë. Në kohën time janë ndërprerë shumë telefona që kanë poseduar edhe administratorët e brendshëm edhe të jashtëm dhe natyrisht që në atë kohë ka pasur shumë, por ky është keqpërdorim i mjeteve.

Për vitet 2003 dhe 2004 janë raportet e auditorit gjeneral dhe ato do të duhej të ishin bërë publike. Pse s'i kanë bërë publike më herët por sot manipulojnë me shifra, mendoj se përsëri është keqpërdorim i kësaj foltore. Ne, jo rastësisht, kemi kërkuar që ky parlament të formojë komision hetimor për të hetuar gjithçka që është keqpërdorur edhe në mandatin e kaluar dhe në këtë mandat. Megjithatë Parlamenti nuk ka qenë dhe nuk ka votuar formimin e komisionit hetimor. Ne nuk u frikësohemi hetimeve, për të vërtetuar kush ka manipuluar dhe kush vazhdon ta vjedhë buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Unë jam ballëhapur me atë, por ata që duhet të japin përgjegjësi para ligjit nuk kanë të drejtë ta hedhin akuzën tjetërkund. Janë organet përgjegjëse dhe sot ne nuk po diskutojmë raportin e vitit 2004 as për raportin e vitit 2003, por jemi duke debatuar për raportin e vitit 2005, dhe për këtë të gjithë ata që kanë keqpërdorur mjetet duhet të japin përgjegjësi edhe para Parlamentit, por edhe përgjegjësi morale dhe përgjegjësi para drejtësisë.

Unë si ish -ministër në Ministrinë e Shërbimeve Publike, për gjithë periudhën time që kam qenë aty, nëse edhe një dëshmi vërtetohet se unë e kam manipuluar ose kam keqpërdorur diçka në atë Ministri me firmën time, në çdo kohë dhe çdoherë jam i gatshëm të jap përgjegjësi edhe para Parlamentit edhe para qytetarëve dhe para të gjithëve.

Prandaj edhe një herë po them sot kjo foltore është keqpërdorur nga ata që nuk do të duhej të ishin këtu.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit. Propozoj 15 minuta pauzë. Në qoftë se doni vazhdojmë. Dikush më herët kërkoi pauzë mund ta vazhdojmë. Nuk doni pauzë?, Okej. Atëherë për fjalë është paraqitur Bajrush Xhemajli.

**DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI** – Faleminderit z. kryesues, përshëndetje për të gjithë. Z. ministër, sipas raportit që na keni afuar dhe sipas fjalës hyrëse që e patët ju, këtu asgjë nuk mund të konstatohet apo të konkludohet për atë se si janë shpenzuar të hyrat.

Këtu mund të shihet vetëm se sa dhe ku janë ndarë dhe sa janë harxhuar nëpër organizatat buxhetore, pra mungesa totale e transparencës në raport nuk lejon të shihet asgjë reale. Ju thatë se i keni thënë Komisionit për Buxhet që mund të vini dhe t'i shikoni materialet që ju nevojiten.

Unë ashtu si dhe ministres Tërnkolli ju them se materialet vijnë këtu, shifrat bien këtu, imellat i kemi të gjithë, postat i kemi të gjithë. Me një komandë mund të vinin të gjitha ato materiale e ju sot na thuani që mund t'i merrni me një kohë më pastaj. Mua po më nevojiten sot, jo sot por 10 ditë më parë të vijë, të konstatoj dhe ta them atë që kam për ta thanë ty këtu, e jo pas 10 ditësh të m'i japësh, Nëse vijmë ne 120 deputetë dhe presim në radhë për materialet e tua. Këtu duhet të jesh pak më serioz në këto gjëra, që çka thua krejt ato që më interesojnë mua për dy fusha shumë të rëndësishme-energjetikën dhe minierat. Pra po t'i lexoj krejt, edhe pastaj konstatojmë kush mund të argumentojë, qoftë prej këtu apo prej auditorit më të gjerë:

Në faqen 38 shkruan ndarjet buxhetore KEK dhe aeroport 22 milion, as s'i ke ndarë prej KEK-ut edhe Aeroportit cilat janë ,sa të KEK-ut e sa të Aeroportit. Llogarite ,as këtë s'e ke bërë e lere më si janë menaxhuar krejt këto, e dihet .

Në faqet 39 e ke Ministria e Energjetikes, thotë janë ndarë 2 milion dhe janë shpenzuar 1 milion e 964 mijë gati krejt i ka harxhuar, në rregull është kjo, kaq thotë ,tjetër nuk thotë asgjë Mua më intereson zotëri Çeku sa për telefon, sa për karburante qysh u tha këtu në mënyrë marramendëse qysh janë harxhuar mua këto më interesojnë që janë ndarë e unë i di edhe kur është bërë buxheti se edhe unë jam deputet edhe në mandatin e kaluar sikur ke qenë edhe ti, e di qysh janë ndarë krejt ato buxheti deri tash.Pra s'ka nevojë të m'i tregosh hiq në fund të fundit. Mua më intereson ta di t' i specifikojë kush ku ka harxhuar, pastaj e ki edhe një faqe që thotë diçka, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit i ka dhënë 80 milion e gjysmë edhe i ka harxhuar të gjitha. Edhe e ki Komisioni i Pavarur për Media dhe Minerale ,i ke 1 milion e 965 mijë edhe aq i ka harxhuar ama pikë për pikë, deri me një euro.

Tjetër send nuk ke. çka kompletohet prej saj, çka po më duhet ky raport, unë nuk di në këtë raport faktikisht e kam ditë, edhe pa e prua hiq. Do me thanë këtu duhet vërtetë specifikohen edhe e keni obligim këtë nuk po e kërkoj çka s'duhet me kërkuar, por çka kërkohet, fundi i fundit për këto flasin edhe rezultatet. Po e marrim në fushën ku mua më intereson, pra për minierat. Dihet se deri tash janë dhënë nja 60 milion për Trepçën dhe thuhet se Trepçës këto ditë duhet t'i vihet dryni, sepse rezultati është zero. Trepça ishte duke punuar derisa u çlirua vendi, kurse tash pas 60 milionë investimesh , pse paratë janë shpenzuar papërgjegjësi. Mjafton vetëm të shkosh e t'i shohësh punëtorët sa të lekosur janë,kurse ne themi duam të krijojmë shtet. Këtu s'ka kurrfarë argumenti ,sipas të cilit do të tregohej mos,ndoshta janë menaxhuar mirë. Unë nuk po predikoj, po çdo shifër e lexova,pra të gjitha ato që i ke në raport për këto dy fusha që janë shumë të rëndësishme. Mirëpo edhe për të gjitha fushat e tjera ke ofruar të dhëna sa kanë hyrë dhe sa janë harxhuar, asgjë tjetër. Këtu vetëm mund të konstatojmë realisht , pati suficit a deficit, tjetër nuk mund të konstatohet ,sepse saldot janë, kaq kanë hyrë, kaq kanë dalë dhe në fund saldoja a është zero apo jo?

Unë nuk mendoj që këtu ka shifra të tjera. Mund të lexoj shifra sa të duash edhe jo prej këtij raporti tënd, por prej atëherë kur e kemi pasur raportin se ai raport është ende, pra ato të hyra, do me thënë janë ende. Këtu unë mendoj në një çështje, këtu nuk punon gjyqësia fare. Të gjitha ato auditime që janë publikuar, në qoftë nëpërmjet shtypit edhe faktikisht drejtësi nuk ka, as prokurori, as gjyqësi, as burgje se po të funksiononin këtu shumë kush do të gjendej prapa grillave dhe sigurisht në mënyrë meritore. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Xhemali. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra të nderuar kolegë deputetë. Po diskutojmë një temë vërtet të rëndësishme, por ndoshta në atë ndjenjën për të parë se çka në të vërtetë e mund të shërbejë si bazë e mirë për hapa të mëtejshme, pra një përvojë e arritur deri më tani në kuptim të menaxhimit të financave publike në përgjithësi, që pjesa përbërëse mund të jetë edhe ky raport ose si është emërtuar pasqyrë financiare.

Unë mendoj që pasqyra ose ky raport financiar u ofrohet vërtet kritereve dhe standardeve të raportimit financiar. Së shpejti do ta kemi edhe Ligjin për raportimet financiare këtu në Kuvendin e Kosovës dhe do të kemi mundësi ta përmbushim atë edhe me kërkesat bazë, me kërkesa të tjera shtesë, që do të mundësojnë një raportin sa më transparent financiar në të ardhmen në Kuvendin e Kosovës.

Në këtë raport, në të vërtetë shihen dy-tre komponentë financiarë ose pasqyrë financiare. Shihet qartë se kemi reduktim shpenzimesh, kemi ngritje të të hyrave, por po ashtu kemi rënie të të hyrave të autoriteteve komunale të cilat duhet të jenë bazë për pjesën më të madhe të mbulimit të buxhetit bashkë me të hyrat vendore, krahas të hyrave në kufi. Këtu duhet parë arsytet çka është kjo, çka duhet bërë me qëllim të arritjes së asaj pjese e të hyrave që në i themi nevojë e përmbushjes së buxhetit dhe nevojë e ngritjes të një qëndrueshmërie buxhetore, të një stabilitetit financiar në përgjithësi në vend.

Këtë e kemi diskutuar disa herë edhe në komuna, e kemi diskutuar edhe në Komisionin për Buxhet dhe këtu duhet të fokusoheni më shumë. Komponenti tjetër, shpenzimet: është e vërtetë se brenda strukturës së shpenzimeve kemi një analizë e cila duhet edhe më tepër të përpunohet, por është e vërtetë se kemi rënie të shpenzimeve, në strukturën e përgjithshme të këtyre komponentëve kemi një rënie të shpenzimeve e cila na bënë me dije sado kudo se është menduar ta bëjmë një reduktim të shpenzimeve me të cilin do të kursej dhe komponentët e tjerë do të vihen në funksion.

Dhe aspekti tjetër, çka po bëjmë në këtë moment me ndërmarrjet publike? Këtë e kemi diskutuar edhe më parë se a mund ta vëmë në funksion këtë buxhet që e kemi në duke pasur parasysh që ndërmarrjet publike duhet të jenë ndërmarrje që duhet të ndihmojnë për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe jo në këtë rast vetëm të marrin nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe të mos raportojnë në Qeveri. Problemi është ky,

ato duhet të raportojnë në Qeveri, qoftë në Ministrinë e Financave, qoftë në Qeveri, qoftë në Kuvend, këtë temë zakonisht disa herë e kemi ngritur, por mungon kjo transparencë në përgjithësi në ndërmarrjet publike nëpërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e cila merr mjete nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Në të ardhmen duhet të bëhet dhe një hap tjetër. Të gjithëve na nevojitet një qasje më racionale në kuptim të planifikimit buxhetor dhe të planifikimit të shpenzimeve me qëllim të një transparence të plotë, që askush nuk do të kishte mundësi që njeri -tjetrit t'ia drejtonte gishtin dhe t'i thoshte: je kështu ose unë jam i mirë. Kjo do të na bënte të mundur që vërtet ato shpenzime që janë krijuar me analizë të përgjithshme të krijojnë bazë të mirë që të gjithë ta ngremë sigurinë në menaxhimin e suksesshëm të financave publike në përgjithësi. Është obligim ynë i përgjithshëm dhe jam i bindur se është objektiv dhe qëndrim i secilit prej nesh, pra edhe angazhim i institucioneve tona. Kjo do të bënte të mundur që edhe taksapaguesit tanë sikur edhe deri më tani, natyrisht do të kenë atë besimin e plotë në institucionet e vendit për çka na jemi këtu. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

**DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ** – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra.

Unë do të jem shumë i shkurtër, mirëpo do ta tërheq vëmendjen që gjithmonë kur bisedohet në lidhje me ekonominë, më vjen keq se një numër shumë i madh i deputetëve, po më duket se janë duke bërë hartim me shkrim, d.m.th. janë jashtë profesionit. Edhe atë ditë kur është biseduar për privatizimin shumë pak kanë qenë në temë, me të vërtetë, kur flitet, lë të flitet me një profesionalizëm. Mua më vinte mirë kur ndonjëherë këtu flitej për shëndetësinë dhe fjalën pothuajse gjithherë e merrin mjekët dhe nuk po e marrin ekonomistët, ndërsa kur flitet për ekonomi flasin letrarët e gjithë të tjerët dhe ku ta di unë edhe me profesione të tjera dhe shumë pak ia qëllojnë.

Unë dua të them, duhet të analizohen disa gjëra, të bëhet edhe një krahasim edhe i shpenzimeve dhe i të hyrave, pastaj të nxirret një konstatim si menaxhohet parja publike. Për këtë mund të themi se, pak më parë z. Jashari e tha shumë mirë se që një pjesëtar i Qeverisë nuk kishte telefon që të bisedonte me dikë, ndërsa këtu na dalin shuma të mëdha harxhimesh për telefon. Tash duhet të dimë a janë harxhuar pse ishte e nevojshme apo jo Nëse ndërmerr Qeveria vendos ta krijojë një Qeveri për nevoja të saj sigurisht se do të kishte zëra se qeveritarët po kërkojnë luks, ndërsa këndej po kritikohemi se po paguajmë qira. Do të thotë edhe kjo duhet të eliminohet. Unë dua të them vetëm se dëshiroj që nga pjesa rezervë, siç është AKM-ja, e cila është duke gëlltitur parë të mëdha të Kosovës të vijë edhe të raportojnë dhe e të jenë përgjegjës para Qeverisë, ndërsa ato ku janë pjesë e rezervuar nuk jemi të zotët të depërtojmë e atje harxhohen më se shumti para, ndërsa këtu përmendim shpenzimet e telefonit, shpenzimet e qirasë që me ato shifra gjithmonë edhe mund të manipulohet. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë.

Secili qytetar i Kosovës, duke filluar prej atij që sapo ka mësuar shkrim -lexim e deri te ai që mund të jetë në moshën më të shtyrë, po qe se i ofrohet një broshurë e tillë në formë të raportit për shpenzimet e buxhetit të Kosovës do ta bënte pyetjen sa janë materializuar këto shpenzime në interes të qytetarëve dhe sa ka përfituar ai si qytetar?. Me siguri do të përpiqeni të jepni përgjigje se është bërë për hir të institucioneve, për Kosovën, për pavarësinë e saj, porse të jeni të bindur, për qytetarët e Kosovës aspak.

Në këtë raport është i dhënë pasqyra e shpenzimeve të kabinetit qeveritar me resorët e tjerë në vartësi dhe asgjë më tepër, a thua qytetarët si taksapagues duhet të paguajnë taksat, të përmbushin obligimet ligjore për Kabinetin qeveritar apo që ato taksa t'u kthehen si shërbime për ta?.

Po jua shtroj një pyetje: në këtë kabinet qeveritar një nga ministrat garon me automobil zyrtarë me një vozitës të Ministrisë së tij dhe rrotullohet, fatbardhësia e tij aksidenti është se ministri shpëton pa lëndime të rënda. Mirëpo kjo Qeveri i kompenson shpenzimet e riparimit të asaj veture afër 30 mijë euro. Kush do t'i paguajë riparimet e veturave të qytetarëve që amortizohen çdo ditë rrugëve të Kosovës, për shkak të gropave.

Një krahasim i tillë të jep të kuptosh se buxheti i Kosovës shpenzohet për ngritjen e standardit të Kabinetit qeveritar. Kemi një të drejtë të themi edhe për ngritjen e standardit të disa deputetëve, porse ne heshtim kur kemi keqpërdorime, ne heshtim kur kemi raporte të bazuara dhe të faturuara se ku shkojnë parat e buxhetit të Kosovës. Unë nuk do ta zgjati më tepër, por do t'i them edhe kolegut para meje që foli, edhe një kolegu më parë që ka folur, ne në Kuvendin e Kosovës ,para se gjithash jemi deputetë, nuk jemi zgjedhur as si doktor shkencash, as si ekonomistë, as si juristë, as si profesorë, kemi ardhur si deputetë si politikanë, disa me stazh disa me stazh më të ri, dhe këtu flasim si deputetë dhe nuk është mirë që asnjëri ta vlerësojë tjetrin a di a s' di të flasë , secili mban përgjegjësi për fjalën e thënë publike. Mirëpo po ju them se për mua ky raport, apo kjo broshurë, është e pa pranueshme ,sepse është një kamuflim apo një manipulim edhe me ne që nuk jemi ekspertë të ekonomisë, por jemi këtu jemi në këto tavolina, po edhe me qytetarët e Kosovës që ndoshta sot e kanë gjetur kohë të dëgjojnë se çka do të raportojë Qeveria, çka do të flasë Parlamenti, çfarë vendime do të marrë lidhur me shpenzimet për vitin 2005.

Unë nuk do e zgjas më tepër, por vetëm do të kërkoj nga ju: ndalni shpenzimet e panevojshme për interes të qytetarëve të Kosovës, ofroni atyre shërbime për të cilat ata paguajnë taksa dhe kontribute, në të kundërtën zëvendësojeni njeri- tjetrin në këtë kabinet, sepse kështu nuk ecën më. Ju faleminderit

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputetja Hatixhe Hoxha

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z. Kryesues, të nderuar deputetë. Për raportin e buxhetit të vitit 2005 u ndala në fushën që mbulon Ministria e Post Telekomunikacionit dhe që në fillim dëshiroj t'ia bëj një pyetje ministrit Qemajl Ahmeti ,i cili sa po e shoh nuk qenka këtu: Çka ka bërë ai si ministër që të ketë informacione për shpenzimet e mjeteve në Aeroport,në hekurudhë e në postë?

Sipas një informacioni shihet se: Posta dhe Telekomunikacioni dhe hekurudhat e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje për t'i instaluar fibrat optike përgjatë binarëve të hekurudhave të Kosovës. Projekti parashihet të kushtojë diku 5 milion € dhe thuhet se do të financohet nga PTK-a.

Ndërsa ,sipas informacioneve që disponojnë thuhet se nga fondi rezervë hekurudhave iu ndanë 350 mijë € për instalimin e rrjetit të kablllove optike.

Pyetja ime është : Kush e financon shtrirjen e kablllos optike në hekurudhë?

Unë pyes Ministrinë Shatri - Si është e mundur për të njëjtën punë dy herë janë ndarë mjete. Në raportin e buxhetit 2005 thuhet se janë ndarë 22 milionë € për KEK-un dhe për Aeroportin, d.m.th. 3.2% të buxhetit të vitit 2005.

E pyes ministrin Shatri:

A ka informacione dhe mbi çfarë baze i janë ndarë Aeroportit 13.7 milion E, të cilat i janë ndarë vitin e kaluar si mjete shtesë?

Dhe këtë pyetje e shtroj për faktin se:

Në një intervistë të zyrtarëve të lartë të buxhetit, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, në lidhje me mjetet shtesë të ndara nga Buxheti i Kosovës, gjegjësisht 13.7 milion, ishin shprehur :

„Deklarata financiare e Aeroportit zbulon se Aeroporti është një organizatë profitabile që ka gati 10 milionë € para dhe është vështirë të kuptohet pse nevojiten fonde shtesë.

Ata shpreheshin atëherë se do të duhej të zhvillohet auditim i menaxhimit financiar në Aeroport dhe shtonin ;

Aeroporti nuk ka pasur nevojë urgjente për para dhe ato nuk janë shfrytëzuar me kohë ,prandaj Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka kërkuar që ato mjete t'i kthehen Buxhetit të Kosovës dhe të shpërndahen për destinacione të tjera.

Zoti ministër Shatri, mbi ç' bazë ju i keni ndarë mjete dhe çka u bë me ato 13.7 milion mjete , të ndara për Aeroportin?.

Dëshiroj ta ripërtëris pyetjen time të cilën e pata shtruar në një seancë të Kuvendit kur pata diskutuar për Aeroportin, për z. Ahmeti, si ministër në Ministrinë të cilën ju drejtoni, a posedoni raport kthyes, në të cilin do të shihej se ku janë harxhuar, apo për çka janë shpenzuar mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Hekurudhat dhe Aeroportin?



Sipas disa informacioneve që disponojmë shihet se vetëm për rrethojën e Aeroportit (që është kush për t'u licencuar Aeroporti i Prishtinës në IKO)

Tenderi ka qenë i hapur që dy vjet e tash është anuluar, vetëm për rrethojë thuhet se janë ndarë 4 milionë e gjysmë €.

Për projektin për përcaktimin e pagave të punëtorëve, thuhet se janë ndarë 200.000 E. Ky projekt thuhet se i është dhënë një firme të huaj.

Projekti është bërë, por ai nuk është zbatuar.

Edhe pse projekti është bërë, stafi udhëheqës vendor përkundër kësaj, vetë ka bërë përshkrimin e vendeve të punës të punëtorëve.

Pra 200.000 € shkuan kot së koti.

Sipas informacioneve që disponojmë thuhet se paga mesatare në Aeroportin e Prishtinës është 1.200-1.400 €. Dhe po të bëhet një përlllogaritje me numrin e të zënëve në punë në Aeroport, që është 620 punëtorë, atëherë shihet se 700.000 € harxhohen për paga të punëtorëve të Aeroportit.

Sipas raportit të OIOS thuhet se stafi i menaxhimit i Aeroportit të Prishtinës ka „bërë keqpërdorimin e fondeve publike”.

Hetimet dyvjeçare, në Aeroportin e Prishtinës, të kryera nga Zyra e Shërbimit të Brendshëm për Hetime të Kombeve të Bashkuara OIOS, në bashkëpunim me hetuesit e Bashkimit Evropian, kanë gjetur se "mashttrimet dhe keq menaxhimi po rriten dhe se korrupsioni është sistematik" në Aeroportin e Prishtinës.

Sipas raportit të OIOS thuhet se stafi i menaxhimit i Aeroportit të Prishtinës ka „bërë keqpërdorimin e fondeve publike”.

Sipas këtij hulumtimi, arsyetimi më i shpeshtë i përgjegjësve të Aeroportit për abstenim nga masat kundër shkelësve ka qenë pohimi se në kohën kur ato kanë ndodhur, nuk ka pasur ligje dhe mekanizma kontrolli. Në Aeroportin e Prishtinës për një kohë të gjatë ka munguar një sistem i llogaridhënies dhe kontrollit të brendshëm. Gjatë disa viteve janë bërë shkelje sistematike të ligjit duke bërë që korrupsioni në këtë kompani publike të arrijë shkallë të pakontrollueshme

Për keq menaxhimin e parasë publike flet edhe fakti se

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit ka bërë shpenzime vetëm për telefona mbi 30 mijë €.

Sa i përket Telefonisë mobile mbështes atë që tha shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Krasniqi, se për shkak të neglizhencës së Ministrisë së Postë Telekomunikacionit dhe ART-se në vitin 2005 nuk u arkëtuan në Buxhetin e konsoliduar 6 milion e 500.000 €.

Sa i përket Fondit të Privatizimit shihet se nuk janë bërë ndarjet e mjeteve nga ky fond ashtu siç është premtuar, p.sh.:

AKM ja dhe Ndërmarrja „Ballkan“ e Therandës, nuk kanë përmbushur asnjë obligim ndaj punëtorëve. Punëtorët nuk kanë marrë 20% nga privatizimi, dy paga dhe 5300 E, për të cilat punëtorët posedojnë vendimet e plotfuqishme; Ju faleminderit

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, diskutimet kanë përfunduar, z. ministër. Në qoftë se doni ta merrni fjalën për sqarime, urdhëroni.

MINISTRI HAKI SHATRI - Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë, meqenëse një pjesë e diskutimeve lidhen edhe me temat që nuk kanë të bëjnë shumë me raportin, fjalën e kam kryesisht për edukatën, për moralin, e gjëra të tjera të tilla që mësohen në shkollë e jo këtu.

Unë dua të them se edukata e moral duhet të vlejë për të gjithë .Pra, çka mendoj me këtë? Mendoj se është edukatë të mos dezinformohet opinioni, meqenëse fjala në këtë foltore tejkalon përmasat e kësaj sale dhe kalon deri tek opinioni i gjerë ,deri të të gjithë qytetarët e Kosovës, është shumë e moralshme që ata të mos dezinformohen, sepse punimet e kësaj seance i ndjek Televizioni Publik i Prishtinës. Prandaj më duhet të reagoj dhe kërkoj falje nga ata të cilët nuk kanë të bëjnë me këtë që po e them, por ata që e dinë ku e kanë fjalën le ta marrin ,sepse pikërisht për atë e kam fjalën: Çka po mendoj konkretisht.

Dua të them se në vërejtjet e z. Krasniqi që raporti është dërguar me tre muaj vonesë, nuk është e vërtetë. Për këtë dua ta informoj opinionin se raporti nga Ministria e Financave është dorëzuar me 31 mars 2003 ashtu si e paraqesin edhe dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike. Nuk do të bëj be këtu që është ashtu, sepse është edhe letra që është dorëzuar në Kuvend.

Kur bëhet shpërndarja e materialit për deputetët nuk është përgjegjësi e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe kur është futur në rend dite ky material nga ana e Kryesisë së Kuvendit edhe kjo është çështje e Kryesisë së Kuvendit.

Po ashtu dua ta informoj opinionin që raporti i auditorit ,në të cilin po mbështetemi pa ndërprerë, është raport definitiv për vitin 2004. Të gjitha shkeljet ose mos shkeljet u referohen shpenzimeve buxhetore të vitit 2004, dhe ju lutem të mos e manipulojmë opinionin me rezultate të cilat kanë të bëjnë me vitin 2004 dhe lënë të nënkuptohet sikur janë shkelje të vitit 2005.

Sa i përket transparencës ju lutem shihni Veb faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, shikoni raportet mujore që ia dërgojmë Kuvendit dhe ato periodike , të gjitha dokumentet e tjera, Përfaqësuesit Special e të tjerëve ua dërgojmë rregullisht sipas dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe për përgjegjësitë..

Mendoj që një pjesë e përgjigjes ka të bëjë edhe me z. Jashari. Nuk jemi vonuar 12 ditë. Asnjë ditë nuk jemi vonuar me raport, por është shpërndarë me vonesë nga Kuvendi. Më

fal, Kuvendi kur e shpërndan, Ministria e Financave s'ka përgjegjësi për atë. Dhe t'jua them edhe këtë, që po ashtu në të njëjtën kohë që është diskutuar raporti vjetor në Komisionin për Buxhetin dhe kemi dërguar edhe raportin tremujor për vitin 2006, pra për hir të informimit të opinionit nuk qëndron ajo që nuk dihet se çka bëhet edhe me buxhetin 2006, sepse ne jo vetëm në raporte periodike tremujore, por edhe mujore, i dërgojmë edhe në Kuvend.

Kam një përshtypje se një pjesë e madhe e diskutimeve janë përgatitur në vitin e kaluar ose të paktën ato i kam dëgjuar edhe me rastin e miratimit të buxhetit në dhjetor të vitit 2005.

Sa u përket shpenzimeve, them se ka mundësi të shihen jo vetëm sipas destinimeve, telefonat, veturat, lëndët djegëse etj, ka mundësi të shihen edhe personat se kush i ka bërë ato shpenzime. Për korrektësi z. Demiri i them që është e vërtetë që Ministria e Financave ka shpenzuar më së shumti për telefon 439 mijë €, nuk e pashë shifrën, por po besoj atë shumë që e tha, por dua të them që Ministria e Financave i ka 930 të punësuar, nga të cilët 600 inspektorë tatimorë. Të gjithë këta punojnë në terren dhe për të gjithë është e domosdoshme të kenë telefon për punën që kryejnë, sepse natyra e punës që kryejnë është e tillë që kërkon detyrimisht të ketë lidhje me telefon. Ju e dini që ata shpesh herë edhe mund të jenë të sulmuar.

Qiranë, nuk e kontestoj. Qeveria e ka shqyrtuar disa herë çështjen e vendosjes së institucioneve të veta, dhe kemi problem me vendosjen e ministrive, sepse një numër i ministrive janë të vendosura në objektet me qira nuk është faji as i përbërjes së mëhershme të Qeverisë, as i kësaj aktuale që ne nuk kemi objekte qeveritare ku të vendosemi, por dua të them se të gjitha kontratat për vendosje të institucioneve qeveritare, janë lidhur para se ta merrte mandatin Qeveria aktuale. Kurse çështja tjetër e shpenzimeve të karburanteve, ka të bëjë me furnizimin në bazë të një marrëveshjeje që është bërë ndërmjet Ministrisë së Shërbimeve Publike në vitin 2004. Ishte një vërejtje, sepse zonjusha Hadërgjonaj ka dhënë shumë elemente të cilat me keqardhje dua të them se asnjëri nuk qëndrojnë. Mendoj se ky është një lloj dezinformimi i stilit të veçantë, sepse ne kemi biseduar dhe kemi qenë prezentë në Komisionin për Buxhetin, mirëpo më duket se problemi qëndron te transmetimi publik i seancave. Ne kemi nevojë që të bëjmë një lloj të prezantimit të një natyre të veçantë dhe jo me korrektësi, ashtu si kemi qenë korrekt në punën e Komisionit për Buxhetin, për të cilën jam shumë mirënjohës, sepse ka qenë një punë shumë e frytshme dhe konstruktive.

Pjesa për buxhetin e ART-së ju lutem lexoni materialin. Është material dhe jo vetëm për ART-ën për të gjitha organizatat që sigurojnë të hyrat vetjake nuk më kujtohet fajja, por nuk është vështirë të gjendet materiali që jua kemi ofruar. Mëditjet paguhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe të gjithë ata që udhëtojnë zyrtarisht, qoftë nga pozita, qoftë nga opozita e dinë që mëditja të cilën e lejon Ministria e Financave, nuk mjafton as të paguhet fjetja në hotel. Për këtë arsye kërkoj korrektësi në qëndrim dhe mendoj se kuota e shpenzimeve për udhëtime zyrtare është përcaktuar në një akt të cilën e ka nxjerrë Qeveria në mandatin e kaluar. Nuk është ndryshuar, por për fat të keq kanë ndryshuar çmimet në vendet ku udhëtojnë njerëzit dhe them me përgjegjësi se këto

shpenzime duhet të adaptohen, sepse nevoja nuk i mbulon. Unë e kam pasur rastin dhe. Në delegacionin për bisedime kuota e lejuar e shpenzimeve për udhëtim zyrtar nuk e mbulon as fjetjen në hotel dhe atë në një hotel të kategorisë së mesme jo të kategorive me pesë yje.

Dinjteti, edukata dhe morali, vlejshëm për të gjithë dhe unë mendoj se ato që ndoshta po bëhen tepër, por nuk e ndjeva veten mirë edhe pse jam i sigurt se s'ka të bëjë me mua, por duhet të them ato duhet të vlejshëm për të gjithë. Kur e kemi fjalën për komunikim me opinionin, por edhe në këtë sallë të Kuvendit, qoftë komunikimi i drejtë për drejtë ose nëpërmjet mjeteve të transmetimit publik.

Z. Koci duhet të jemi korrektë. Ne e dimë që jemi në pozitë opozitë, por mendoj se korrektësinë e kemi pasur dhe e kemi lidhur me shpenzimet e rezervave të Ministrisë. Unë në Komisionin për Buxhet e kam pasur të njëjtin dokument që ua kam shpërndarë juve sot. I kam lexuar të gjitha ndarjet dhe numrat e vendimeve dhe datat. Jemi marrë vesh, keni kërkuar nga unë që për Kuvend t'ju sjell deputetëve këtë material dhe unë këtë punë e kam bërë. Nuk mendoj se ka nevojë për një studim më të thellë analitik, por në qoftë se doni mund t'ju lexoj tash, por nuk besoj se ka nevojë. Dua të them edhe diçka tjetër lidhur me shpenzimet në AKM. Ne jemi pajtuar këtu kur kemi folur në një seancë para një muaji në këtë Kuvend dhe kemi marrë vendim me të cilin jemi pajtuar të gjithë edhe Qeveria, që veprimtarinë e AKM-së duhet t'ia nënshtrojmë një auditivi të përgjegjshëm prej periudhës së pasluftës dhe presim që ky vendim të jetësohet dhe të marrim një raport të auditorit për shpenzimet që bën AKM-ja.

Dua t'ju them këtu që ministri i Financave, as Qeveria nuk kanë mundësi të ndërmarrin asgjë për ndryshimin e shpenzimeve në fuqitë e rezervuara. Ju të gjithë e dini që në atë pjesë kompetencat janë të rezervuara dhe me gjelozi ruhen dhe nuk na lejohej të kemi qasje atje.

Sa u përket disa shpenzimeve që bëhen në ndërmarrje publike PTK, Aeroporti e të tjera, po ashtu, këto menaxhohen nga AKM-ja, që kryesohet nga shefi i Shtyllës së Katërt dhe është ekskluzivisht pjesë e rezervuar. Qeveria ka 3 ministra në bordin e AKM-së, por kur vjen çështja të shpenzimet dhe të çështjet e tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave, ne jemi gjithmonë të mbivotuar dhe kjo ka qenë arsyeja pse edhe Qeveria është pajtuar me Kuvendin që AKM-së t'i bëhet një auditim, dhe pres që rezultatet e atij auditimi t'i diskutojmë në këtë Kuvend dhe të propozojmë masa.

Sot është diskutuar për raportin për shpenzimet buxhetore të vitit 2005. Mendoj që shpejtë do ta kemi raportin njëqind ditor të Qeverisë dhe mund të flasim për segmentet e tjera, sepse këtu shumë herë disa gjëra janë ngatërruar. Kjo mendoj që është përgjegjëse edhe ndaj zonjës Hoxha, e cila me të drejtë i ka diskutuar disa çështje në shpenzimet në PTK, por që nuk janë pjesë e detyrueshme e këtij raporti, sepse ajo menaxhohet nga AKM-ja dhe është ndërmarrje publike, nuk është organizatë buxhetore. Janë dhënë hua 22 milionë për KEK-un dhe për Aeroportin, 12 milion janë për Aeroportin, 10 milionë janë për KEK-un. Këto janë precizuar në buxhet të vitit 2005 për çfarë destinime janë dhënë? Ju informoj që Aeroporti ka filluar ta kthejë këtë hua në dhjetor të vitit 2005, i ka

kthyer një milion, pra sipas marrëveshjes në Qeveri këtë vit do t'i kthejë edhe 6 milion, kurse në vitin tjetër mbetet t'i kthejë edhe 5 milion të tjera. Në qoftë se dikujt i kam mbetur borxh ndonjë përgjigje, kërkoj falje dhe mund t'i jap rast herëve të tjera. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVTI HALITI** – Ju faleminderit z. ministër. Sipas Rregullores për replikë 2 minuta, janë paraqitur Jakup Krasniqi, Nazim Jashari, Safete Hadërgjonaj dhe Gani Koci. Z. ministër ju njoftoj se edhe ju e keni nga 1 minutë për çdonjërin. Fjalën e ka z. Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – Unë po dua t'i rikujtoj dhe në fakt ta rilexoj pjesën të cilën e citoi ministri: Unë kam thënë, sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, Ministria për Ekonomi dhe Financa është e obliguar të paraqesë raport vjetor financiar deri më 21 mars të vitit vijues, do të thotë deri më 1 mars të këtij viti. Në rastin tonë kjo po ndodh në fillim të muajit qershor 2006 dhe ne po debatojmë për këtë çështje në muajin qershor 2006. Nuk di ku e keni dorëzuar, nuk kam thënë asgjë, por ne po debatojmë raportin e vitit 2005 më 2 qershor 2006. Unë këtë e kam thënë e kjo është e vërtetë, se këtu jemi sot më 2 qershor, prandaj nuk është manipulim i opinionit, të tjerët po e manipulojnë opinionin, të tjerët po e mashtrojnë opinionin, të tjerët nuk po ia tregojnë të vërtetën, por edhe nga ministri tjetër, sidomos ministrja i ka manipuluar shifrat, se në kohë të duhur do të dalim me shifra të sakta edhe për të kaluarën edhe për vitin 2005, prandaj nuk është mirë që ministrat dhe Kabineti qeveritar të manipulojnë shifra, ta mashtrojnë opinionin për shkak të keqpërdorimeve që i kanë bërë dhe vazhdojnë t'i bëjnë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

**KRYESUESI XHAVTI HALITI** – Ju faleminderit! Një minutë z. ministër e keni,

**MINISTRI HAKI SHATRI** – Më vjen keq se nuk kam kartelë, se nuk isha dalë këtu, dhe unë vetëm thashë, tek opinioni përcillet sikur Ministria e Financave e ka dorëzuar me tre muaj vonesë raportin, ju lutem sipas ligjit Ministria e Financave duhet më 31 mars më së largu t'ia dorëzojë raportin Kuvendit. Në këtë punë e kemi bërë pikërisht me datën 31 mars, pra ia kemi dërguar materialin Kuvendit, se kur e vë në rend dite Kuvendi materialin, unë nuk kam kurrfarë përgjegjësie.

Lidhur me manipulimin e numrave, raporti ministri i Financave ia ka paraqitur Kuvendit, është dokument zyrtar dhe për çdo manipulim të dokumenti personalisht mbaj përgjegjësi, sepse edhe e kam nënshkruar dhe ju them që i përgjigjem çdo manipulimi të mundshëm nëse është bërë. Pra jam këtu me përgjegjësi që të garantoj se raporti është plotësisht i sigurt, i saktë dhe real. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVTI HALITI** – Ju faleminderit, për replikë është paraqitur deputetja dhe ministrja Tërmkolli.

**MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI** - Unë nuk do ta zgjas shumë. Këtu nuk ka ministreshë, ka ministra. Edhe z. Jakup Krasniqi i mungon edukata, fatkeqësisht, të mungon edukata elementare. Nuk ka këtu dezinformime, po jua jap edhe do informata

shtesë ,shumë shkurtë. Ministria e Shërbimeve Publike mbi bazë të raportit të auditimit për vitin 2004 , gati një vit që i ka paraqitur gjykatës, prokurorit, të gjitha të dhënat, të gjitha elementet dhe gjykata, prokuroria është shumë e vërtetë, këtu pajtohem nuk e ka bërë asnjë hap. Kam informata të pakonfirmuara deri në fund se ata janë të kërcënuar, kush i kërcënon e dini ju.

**KRYESUESI XHAVTI HALITI** – Ju faleminderit. Për kundër replikë është paraqitur z. Krasniqi, një minutë do ta keni z. Krasniqi

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI** – Unë edhe një herë po e them nuk e kam kërcënuar dhe nuk e kërcënoj kurrkund . Kërkoj, bile nga sistemi i drejtësisë që nëse ka edhe një fakt të vetëm se unë e kam keqpërdorur edhe në 10 € buxhetin e konsoliduar të Kosovës, jam i gatshëm t'i përgjigjem këtij organi, por fjala e parafolësit ose e parafolëses është edhe një dëshmi tjetër se kjo i manipulon shifrat,i manipulon faktet. Po të kishte fakte auditori gjeneral do të mbusheshin gazetatat edhe për keqpërdorimet që janë bërë në vitet 2004 dhe 2003, por ato po mbushen me keqpërdorime që po bëhen nga Kabineti qeveritar në vitet 2005 dhe 2006. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Për replikë është paraqitur Nazim Jashari dy minuta i keni.

**DEPUTETI NAZIM JASHARI** – Të faleminderit shumë z. kryesues, të nderuar deputetë, të nderuar kolegë, të nderuar ministra.

Çështja që u problematizua nga ana e ministrit nuk e mendoj që është çështje më e rëndësishme,që do të duhej të problematizohej edhe pse nuk është me rëndësi vonesa. Kur e thashë vonesën ,nuk e thashë të pabazuar ,e thashë të bazuar. E kemi këtu një akt që ka ardhur në këtë Kuvend dhe është protokolluar më 12.4. 2006, data e protokollimit është kjo, por, çka është, më me rëndësi është aty edhe një vulë përcjellëse, e cila flet kur është protokolluar në Qeveri dhe është e njëjta datë, z. ministër. Pra, në qoftë se është protokolluar në të njëjtën datë në Kuvend dhe në të njëjtën datë në Zyrën e kryeministrit ,numri i protokollit 02c 1225 dt. 12.4. 2006 flet që kjo nuk ka ardhur në Kuvend më 31 mars, si është paraparë me ligj,. Pra në Qeveri është protokolluar në zyre të kryeministrit më 12.4.2006, të njëjtën ditë ka ardhur në Kuvend. Kjo sa i përket kësaj saktësie. Vetëm për saktësi aspektet e tjera mendoj se flasin vetë për veten. Mendoj që raporti si raport është ky që është. Ne jemi këta që jemi, do ta miratojmë edhe kësaj radhe, nuk është problem, por efektiviteti i punës së Qeverisë të matet me buxhetin, buxheti po na shkon si po na shkon, mirëqenie nuk ka, ishalla bëhet më mirë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit, z. ministër. Nuk keni përgjigje , dy minuta i ka Safete Hadergjonaj.

**DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ** – Ju faleminderit z. kryesues. Mua më vjen shumë keq për ministrin kur thotë se asnjë element i thënë nga unë nuk qëndron, kur edhe vetë ministri e di shumë mirë se të gjitha qëndrojnë. Unë them të gjitha qëndrojnë edhe në lidhje me të hyrat edhe në lidhje me shpenzimet. Nëse janë të qëndrueshme këto

të dhëna në material të cilin e kam ,por ti thua që janë materiale shumë të mira, atëherë të gjitha ato që unë i kam thënë, janë në këto materiale dhe janë plotësisht të qëndrueshme.

Sa u përket kësaj çështjeje dhe atyre që u diskutuan, nuk dua të ndalem në raportin e vitit 2005, sepse edhe ministri edhe anëtarët e Kryesisë e dinë pse nuk kanë ardhur në Kuvend, sepse raporti ka ardhur me rrugë individuale n nga ministri drejtpërsëdrejti te kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa e jo nëpërmjet Qeverisë në Kuvend. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me raportin tremujor, ku ministri në rrugë individuale ia ka dërguar kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Zyra për çështje juridike e Kuvendit i ka penguar analizën dhe shqyrtimin e raportit tremujor po flas me kompetencë sipas asaj që më kanë thënë Zyra për çështje juridike në kuadër të Kuvendit,sepse raporti tremujor nuk është miratuar nga Qeveria pasi nuk kishte ardhur në Kuvend . Kështu konsideroj se të gjithë e dimë nenin 40 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe për përgjegjësitë,prandaj nuk është shqyrtuar. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVTI HALITI – Ju faleminderit. Për replikë është paraqitur deputeti Gani Koci, dy minuta

DEPUTETI GANI KOCI – Pajtohem me konstatimin e ministrit se nuk duhet të manipulohen shifrat, me faktet dhe të dhënat . Vërtetë nuk jam i prirur të manipuloj, por jam i prirur t'i besojë asaj që shkruan. Mënyra e komunikimit ndërinstytucional ndihet shumë mirë, prandaj qëndron kjo vulë katrore me numër të protokollit , bile në libër të protokollit shënohet edhe ora kur është dorëzuar dhe një kopje i jepet atij që e ka dorëzuar. Ky ka ardhur më 12.4.2006, jo më 31. Më duket qenkan j 12 ditë vonesë ose shkelje të ligjit si e tha kolegu atje. Sa i përket mënyrës të raportimit e këtë e përcakton mirë ligji. Nuk e kemi respektuar as për pjesën për të cilën kam folur, ç'është arsyeja e atyre ndarjeve, ku kam shkuar në mënyrë të detajizuar dhe pse? Unë nuk e di që kanë shkuar 250 mijë te kryeministri një herë dhe herën tjetër 50 mijë, nuk e di pse, a për fjetje në hotel, a për telefon a për këshillime të jashtme, unë nuk e di .Nuk e keni përcaktuar këtu, ndërsa sa i përket çështjes së auditimit unë po i besoj këtij raporti shumë, pse ka kaq të hyra dhe kaq të dala, por sukseasi i menaxhimit nuk matet vetëm me të hyra dhe me të dala, por me vëllimin e punës së kryer me ato mjete që konstatohen si të dala dhe çka është kryer në vitin 2005. Fatmirësisht Zyra e auditorit gjeneral që ka filluar auditimin së pari në Presidencë për vitin 2005 ,gjithnjë po flas, se raportin e auditimit për 2004 e kemi analizuar dhe e kemi shqyrtuar dhe e dimë ku janë shkeljet e ku nuk janë, ka filluar kjo zyre të na japë raporte të veçanta për secilën organizatë buxhetore në institucionet qeveritare në të cilat shihet mirë se a e keni keqmenaxhuar buxhetin e Kosovës apo e keni administruar mirë buxhetin e Kosovës? A e keni vjedhur buxhetin e Kosovës, apo çka keni bërë me të?.

KRYESUESI XHAVTI HALITI – Ju faleminderit z. Koci. Z. ministër s'keni asgjë. Për fjalë është paraqitur z. Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së

DEPUTETI ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryesues. Debati i sotëm për buxhetin fatmirësisht demonstroi që si institucione demokratike dhe si Kuvend kemi ardhur në atë

nivel që të merremi me buxhet të debatojmë dhe bëjmë përpjekje maksimale që buxheti i Kosovës të jetë sa më i lartë që të shpenzohet sa më mirë dhe në interes të qytetarëve të Kosovës dhe gjatë këtij procesi të ketë transparencë të plotë institucionale. Natyrisht edhe gjatë këtij debati, si dhe në vendet e tjera, individë të ndryshëm e formulojnë në mënyra të ndryshme dhe e shpenzojnë energjinë e vet në mënyrën se si ata mendojnë, por mendojnë se është obligim i gjithë neve që ajo energji të shpenzohet në kuadër të një kulture parlamentare dhe të të Rregullores.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet rekomandimin e Komisionit të Buxhetit dhe të Financa dhe fjalën hyrëse në fillim të kësaj seance e cila demonstroi se në buxhetin e Kosovës nuk ka tejkalime buxhetore. Si grup parlamentar kërkojmë nga Ministria dhe Qeveria në tërësi një angazhim të shtuar në mbledhje të taksave dhe në ndërrimin e raportit të themelimit të buxhetit në mes të asaj që arrihet në doganë të asaj që vilet nga tatime në përgjithësi.

Si pozitë nga ministri kërkojmë që gjitha analizat të cilat i kërkon opozita me kohë dhe në mënyrë transparente t' i ofroni. Në ditën e votimit të Qeverisë kemi garantuar korrektësi dhe transparencë institucionale dhe i kemi të gjitha arsyet që t' i qëndrojmë atij vendimi politik. Z. kryesues, si grup parlamentar, kërkojmë që pas këtij përfundimi të debatit të merrni vendim në kuadër të Rregullores së punës. Ne jemi të gatshëm ta votojmë këtë buxhet. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Në përputhje me Rregulloren dhe me kërkesën e Ministrisë së Financave, me kërkesën e Grupit Parlamentar e hedh në votim miratimin e raportit të Ministrisë së Ekonomisë e të Financave. Lus deputetët të bëhen gati për votim. Teknika ju lutem të bëheni gati për votim.

Votojmë tash:

Në sallë janë 69 deputetë, do të thotë ka forum për të votuar.

Për.....52;

Kundër..... 21.

Konstatoj që raporti i Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave është miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Ju faleminderit.

Mirë u pafshim në seancat e ardhshme.